
NJËSH I
FERIZAJT
HAFIZ YMER SHEMSIU
MUHAMED MUHARREMI
& GENTIAN JETISHI
#1Ferizaj

#1Ferizaj
Hafiz Ymer Shemsiu

NJËSHI I FERIZAJT

‘HAFIZ YMER SHEMSIU’

MUHAMED MUHARREMI &
GENTIAN JETISHI

Autorë:

Muhamed Muharremi &

Gentian Jetishi

Ballina dhe faqosja

Xheneta Jetishi

OPYRIGHT © 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, shpërndahet ose transmetohet në çfarëdo forme ose mjeti, duke përshirë fotokopjimin, regjistrimin ose mjetet e tjera elektronike ose mekanike, pa lejen paraprake me shkrim të autorit, përveç rasteve kur citimet e shkurtra përdoren në recensime kritike ose qëllime jo-komerciale të lejueshme nga ligji.

#1Ferizaj
Hafiz Ymer Shemsiu

NJËSHI I FERIZAJT

'HAFIZ YMERI SHEMSIU'

MUHAMED MUHARREMI &
GENTIAN JETISHI

Ferizaj, 2025

"**Lamtumirë, o populli im**!
Për ty dhashë atë që mund ta jepja:
pasurinë, **familjen**, **veten**. **Për ty do të vijnë ditë më të mira**″.

PËRMBAJTJA

Prolog – Kur një njeri bëhet epokë - 8

Kapitulli I – Biografia

Biografia e Hafiz Ymer Shemsiut - 15
Arsimimi dhe formimi fetar - 33
Shkollimi si autodidakt - 34
Hifzi – Memorizimi i Kuranit - 36
Akademia ushtarake dhe ndikimi i saj - 37
Edukimi gjatë gjithë jetës - 38
Poligloti dhe njohës i shumë gjuhëve - 38
Kultura e përgjithshme dhe dijet enciklopedike - 40
Vlerësime nga studiuesit shqiptarë - 46

Kapitulli II – Arsim, Shkencë dhe Shkollë Shqipe

Arsim, shkencë dhe shkolla shqipe - 61
Mejtepet dhe Medresetë në shërbim të kombit - 71
Shkollat shqipe në Ferizaj - 74
Dy shkolla të hapura nga Hafiz Ymeri - 92
Studiues të huaj për shkollat e tij - 96
Sistemi arsimor origjinal dhe vizioni pedagogjik - 101
Kurrikula e gjerë dhe bashkëkohore – 103

Kapitulli III – 'Bardi i Kosovës' – Kotributi për art dhe kutlurë

Hafiz Ymeri – "Bardi i Kosovës": Kontributi në art dhe kulturë - 111
Letërsia dhe religjioni në veprën e tij - 113
Autori i parë i Ferizajt – 114
Poema "Nazim Gafurri" – vepra kulmore e periudhës ndërmjet luftërave - 117
Muzika rapsodike dhe ajo spirituale – 127
Instrumentist, valltar dhe nxitës i artit popullor - 143
Bashkëpunimi ndërkulturor dhe vizioni estetik - 148

Kapitulli IV – Ideolog i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare

Ideolog i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare - 153
Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (1918) - 157
Partia Politike Shqiptare "Bashkimi" / "Xhemijeti" (1919) - 160
Organizata "Drita" – Rinia përparimtare shqiptare (1937) - 162
Lidhja e Dytë e Prizrenit (1943) - 164
Lufta kundër aleancës nazifashiste (1941–1944) - 167
Mbrojtja e Kosovës Lindore (1941) - 169
Lufta e Ferizajt (1944) - 170

Kapitulli V – Shkollari dhe Teologu Shembull

Shkollari dhe Teologu Shembull – 175
Angazhimi si imam dhe ligjërues - 181
Edukimi gjithëpërfshirës përmes fesë – 184
Kujdesi për Kuranin si amanet dhe mision – 186
Vdekja e Hafiz Ymerit – martiri i ditës së lirisë -188

Veprat letrare dhe artistike

Poema 'Nazim Gafurri' – 195
Atdhe i dashtun – 217
Ramë bre vlla ti nuk je dek! – 219
Bylbyl i vetëm – 222
Jemi ardhun – 223
Nga "Ani na t'i lutemi Perëndisë" – 226
Mos e lë fale Namazin – 228
'Ve Duha ajet ku a knu' – 230
Qyr Hafuz qi rri në Sazli – 231

Pasthënie – Ai që fliste me kohën dhe përtej saj - 237
Lista e imazheve - 239
Literatura dhe burimet - 246

KOHËSHTRIRJE

Hafiz Ymer Shemsiu (1895 – 1945)

1895 – Lindur në Prishtinë.

1915 – Fillon angazhimin si mësimdhënës dhe imam në Mejtepin e Ferizajt, të themeluar nga daja i tij, Haxhi Pllana.

1915 – Hapë shkolla shqipe në mejtepin e fshatit Sazli, në fshatin që Hafiz Ymeri shërben si imam dhe mësimdhënës.

1930 – Shkruan poemën madhore "Nazim Gafurri", e cila bëhet një ndër veprat më të njohura historike dhe letrare të tij.

1934 – Hap shkollën shqipe në mejtepin e fshatit Talinoc, ku mëson fëmijë të moshave të ndryshme dhe kontribuon në edukimin e tyre për çështjet fetare dhe kombëtare.

1941–1944 – Angazhohet në lëvizje kombëtare për mbrojtjen e Kosovës kundër pushtimit bullgar dhe nazifashist. Reziston ndaj ndërhyrjes komuniste dhe mbron idealet e Shqipërisë etnike.

1944 – Përndiqet nga regjimi komunist për aktivitetin e tij kombëtar dhe tërhiqet në ilegalitet.

Mars 1945 – Përkeqësohet shëndeti i tij për shkak të kushteve të vështira të jetesës dhe përndjekjes nga regjimi.

Maj 1945 – Vdes në fshatin Sazli në moshën 50-vjeçare, duke lënë pas një trashëgimi të thellë në fushën e arsimit dhe rezistencës kombëtare.

PROLOG

Kur një njeri bëhet epokë

Në fshatin Sazli, në një shtëpi me dysheme druri dhe mure të heshtura, në pranverën e zymtë të vitit 1945, një dritë e madhe u shua… por nuk u shua. Ajo thjesht ndryshoi formë.

Hafiz Ymeri Shemsiu, i njohur si "Njëshi i Ferizajt", mbylli sytë jo për të ikur, por për t'u bërë rrënjë në tokën e një kombi që e deshi aq thellë, sa edhe vetë frymën e tij e ktheu në flijim.

Ai nuk ishte veçse një hoxhë. As vetëm një mësues, as vetëm një poet, as vetëm një burrë që fliste shumë gjuhë dhe memorizonte Kuranin si melodi qiellore. Ai ishte më shumë. Ai ishte një degë që u rrënjos në shpirtin e popullit dhe çeli në kohët më të errëta, për t'i thënë dritës se ende kishte vend.

Në netët e errëta, kur pushteti digjte librat dhe mbyllte dyert e shkollave, Hafiz Ymeri ndizte dritë me zë. "Mos u trembni," u thoshte nxënësve. "Shkronjat janë më të forta se hekurat."
Në mëngjeset e ftohta të Ferizajt, me çallmën mbi ballë dhe librat nën krah, ai ecte si një ushtar pa armë, por me fjalë që vrisnin harresën.

E kishte varrosur dhimbjen thellë — fëmijët e tij, të vegjël, që shkuan në amshim pa thënë as 'baba'; ditët e urisë dhe të burgut; humbjet e mëdha që i shndërroi në poezi, në këngë, në lutje.

Ai nuk pati luksin të vdiste. Sepse njerëzit që kthehen në frymë nuk vdesin.

Në çdo gur të vjetër të Ferizajt, në çdo mëngjes të fshatrave të Kosovës, në çdo alfabet të shqipes që u ruajt nga flaka e pushtuesve, është pak nga ai. Në një vend ku shumë u përkulën, ai qëndroi si mal.

Ky libër nuk është vetëm kujtim. Është ritakim. Është një përkulje përpara një burri që i dha kombit të tij më shumë se jetën: i dha një amanet.

Të mos harrojmë. Të mos harrohemi.

Hafiz Ymeri ishte më shumë se një personalitet lokal i njohur si "Njëshi i Ferizajt". Ai përfaqëson një nga figurat më të formuara intelektualisht të kohës së tij, jo vetëm në Ferizaj, por në të gjitha trojet shqiptare. Si anëtar i elitës kombëtare, Hafiz Ymeri mbetet një burim frymëzimi për brezat e kaluar, të tashëm dhe të ardhshëm, duke ofruar një histori të jashtëzakonshme që përçon mësime të vlefshme për intelektualët dhe të gjithë shqiptarët.

Figura e tij, në kushte të tjera, do të duhej të zinte vendin e saj të merituar në çdo hapësirë publike shqiptare, duke pasqyruar rëndësinë e një njeriu të këtij kalibri. Shkollat, universitetet, institutet arsimore dhe kulturore, si dhe qendrat e edukimit, do të duhej të përfshinin në kurrikulat e tyre studimin e jetës dhe veprës së tij, e institucione të emërtoheshin me emrin e Hafiz Ymerit. Ai ishte një personalitet unik, që veproi në rrethana të vështira, në një qytet që po formohej dhe rritej paralelisht me të. Hafiz Ymeri ishte një figurë që, përmes dijes dhe kontributit të tij, ngriti Ferizajn në nivele të reja intelektuale dhe kulturore mbarëshqiptare.

Përfytyroni atë, një burrë i veshur me elegancë, me çallmë tradicionale, që udhëton me tren nga Ferizaj drejt Prishtinës dhe Shkupit, me libra nën krah, në kërkim të dijes. Derisa pushtuesit i mungonin nivelet e arsimimit dhe kulturës, Hafiz Ymeri shkëlqente me njohurinë e disa

gjuhëve të huaja dhe leximin e burimeve nga Lindja dhe Perëndimi. Ai dha kontribut të madh në përmirësimin e shoqërisë ferizajase, duke u përkushtuar deri në fund të jetës së tij për arsimin dhe edukimin.

Njohur si një nga tridhjetë figurat më të rëndësishme shqiptare të shekullit XX, Hafiz Ymeri e pozicionoi Ferizajn në hartën e intelektualëve të kohës. Vepra e tij e njohur, poema "Nazim Gafurri", është një prej krijimeve më të spikatura letrare dhe historiografike të Kosovës së periudhës mes dy luftërave botërore.

Ai ishte gjithashtu një nga të parët që hapi shkolla shqipe në Ferizaj, për të cilën edhe u burgos. Hafiz Ymeri njihet për demokratizimin e arsimit pranë xhamive, duke krijuar mundësi të barabarta për arsimimin e vajzave dhe djemve. Metodologjia e tij bashkëkohore e mësimdhënies vazhdon të mbetet model për institucionet arsimore të sotme. Nxënësit e tij, të formuar me drejtësi dhe përkushtim, do të bëheshin mësimdhënës dhe administratorë të ardhshëm të organizimeve shtetërore.

Hafiz Ymeri ishte një nga zërat më të fortë në lëvizjet kombëtare shqiptare të kohës, duke luajtur rol kyç në Komitetin "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës". Ai gjithashtu ishte aktiv në shumë organizata të tjera kombëtare, si Partia e parë Shqiptare 'Bashkimi' dhe organizata "Drita" dhe në Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Me përkushtim të plotë, ai punonte për edukimin e shqiptarëve të Ferizajt dhe për forcimin e identitetit të tyre kombëtar.

Kur shpërngulja e shqiptarëve nga atdheu ishte e stimuluar nga pushtuesit, Hafiz Ymeri ishte një ndër ata që përpiqej të ndalonte këtë lëvizje masive, duke u angazhuar në mbrojtjen e popullit të tij. Ai gjithashtu mori pjesë aktivisht në luftën për mbrojtjen e trojeve shqiptare, duke luftuar krah për krah me figurat më të shquara të kohës, si Mulla Idriz Gjilani dhe Mulla Vesel Guta, kundër pushtuesve nazifashistë dhe më pas kundër komunistëve.

E ardhmja mund të sjellë njohjen e plotë të Hafiz Ymerit si një model për intelektualët shqiptarë, një figurë që do të respektohet dhe vlerësohet nga të gjithë. Hafiz Ymeri, i cili mund të kishte jetuar një jetë më të qetë, zgjodhi të përballej me sfidat e një periudhe të vështirë historike dhe të kontribuonte me gjithë fuqinë e tij për të mirën e kombit.

Kapitulli 7

Biografia e Hafiz Ymer Shemsedinit

Nëse rrënjët e një qytetërimi maten me jetët e njerëzve që e formësojnë atë, atëherë Hafiz Ymer Shemsiu është një ndër ato rrënjë të thella që kanë ushqyer shpirtin e një kombi.

Ymer (Shemsedin) Sylejmani lindi në vitin 1895, në lagjen e Muhaxhirëve në Prishtinë, në një kohë kur errësira politike po përpiqej të mbyste dritën e një gjuhe, një kombi dhe një shprese. Familja e tij ishte ndër mijëra të shpërngulurit nga Prokuplja e Toplicës, të dëbuar me dhunë nga trojet e veta. Në këtë përçarje të dhimbshme, fillon historia e një fëmije që do të bëhej burrë me zemër të madhe dhe mendje të ndritur.

Por jeta nuk ia kurseu dhimbjen. Në moshën tetëvjeçare, Ymeri humbi babanë e tij, Hoxhë Shemsedinin – një dijetar i respektuar që kishte falur namaz përkrah Sulltanit në Stamboll. Tri vite më pas, edhe gjyshi i tij u shua. Jetim në një botë të paqëndrueshme, ai u zhvendos në Ferizaj, në fshatin Sazli, nën kujdesin e dajës së tij, Haxhi Pllana – një figurë po aq madhështore sa edhe vetë Ymeri do të bëhej më vonë.

Ferizaj nuk e kishte ende as strukturën urbane e as shpirtin që ka sot, por Haxhi Pllana kishte vizionin për ta bërë atë djep të dijes. Ishte ai që ia zgjati dorën Ymerit të vogël, jo vetëm për ta mbrojtur, por për ta edukuar – me libra, me dije, me dritë.

Në rrugën e dijes, Hafiz Ymeri e nisi udhëtimin në Prishtinë dhe Shkup, por ishte jeta që e bëri mësuesin e vërtetë të tij. Ai nuk i përfundoi kurrë institucionet formale, sepse rrethanat historike nuk e lanë, por ai u bë një nga autodidaktët më të mëdhenj të kombit. Ai që mësoi në errësirë, për të shpërndarë dritë.

Titullin "Hafiz" – për memorizimin e tërë Kuranit – e mbrojti në mënyrë solemne në Xhaminë e Boshnjakëve të Ferizajt. Ajo ditë nuk ishte thjesht një ceremoni fetare, por një ngjarje kulturore e qytetit. Një popull që jetonte nën zgjedhë, duartrokiste një njeri që ruante kujtesën hyjnore.

Ai nuk ndaloi kurrë së mësuari. Zotëronte më shumë se gjashtë gjuhë – nga arabishtja dhe turqishtja, te gjermanishtja, frëngjishtja, italishtja dhe gjuhët sllave.

Lexonte filozofi dhe histori botërore me të njëjtin pasion siç lexonte fjalën e Zotit. Për të, dijet ishin një det pa brigje.

Po Hafiz Ymeri nuk ishte vetëm një studiues i qetë. Ishte edhe luftëtar. Ishte edhe poet. Ishte edhe mësues që sfidoi ndalimet e Jugosllavisë për të hapur shkolla shqipe. Ai i mësonte fëmijët e fshatit të shkruanin e lexonin shqip, kur një fjalë shqipe mund të të çonte në burg.

Pati dhimbje personale që do e kishin thyer çdo njeri tjetër. Fëmijët e tij vdiqën njëri pas tjetrit, disa vetëm pak muajsh. Por ai nuk u thye. Birësoi. Mësoi. U kujdes. Fali. Dha. Në vend që ta përthithte dhimbja, ai ia ktheu botës në dashuri.

Përgjatë jetës së tij, u bë frymëzim për intelektualë, bashkëluftëtar i Mulla Idriz Gjilanit, këshilltar i organizatës "Drita", bashkëpunëtor i patriotëve të kohës, dhe sidomos – njeriu që i dha Ferizajt një identitet intelektual e kombëtar.

Ai jetoi vetëm 50 vjet. Por ato vite ishin një epokë më vete. Dhe kjo epokë fillon me një fëmijë jetim, që s'kishte asgjë – përveç vullnetit për të mësuar.

Nëse historia është një pasqyrë, atëherë figura e Hafiz Ymer Shemsiut është ajo rreze e fortë që i jep dritë gjithë pasqyrës. Dhe kjo është vetëm fillimi i rrëfimit të tij.

Hafiz Ymeri, emri i plotë Ymer (Shemsedin) Sylejmani, lindi në vitin 1895 në Prishtinë, në lagjen e Muhaxhirëve. Nuk disponohen të dhëna të sakta për datën e saktë të lindjes, por burimet biografike e vendosin vitin 1895 si momentin e lindjes së tij.

Origjina e familjes së tij gjendet në Prokuplje, rajoni i Toplicës, nga ku kjo familje u shpërngul në Prishtinë si pasojë e dëbimit masiv të shqiptarëve nga forcat serbe. Ata u vendosën në Lagjen e Muhaxhirëve të Prishtinës, siç dokumentohet nga studiuesit Muhamet Pirraku (1992) dhe Ramiz Zekaj (2007).



Figura 1 - Harta e Prokupjes dhe vija drejt Ferizajt

Kohështrirje

1895 - Viti i lindjes së Hafiz Ymeri Shemsiu

1903 – Viti i vdekjes së babai të Hafiz Ymerit – Hoxhë Shemsedin Sylejmanit

1906 – Viti i vdekjes së gjyshit të Hafiz Ymerit, Mustafë Sylejmani, dhe viti i shpërnguljes së Hafiz Ymerit në Ferizaj, në fshatin Sazli!

1915 – Viti i hapjes së shkollës shqipe – Mejtepit në Sazli nga Hafiz Ymeri nga Hafiz Ymer Shemsiu

1934 – Viti i hapjes së shkollës shqipe - Mejtepit në Sazli nga Hafiz Ymer Shemsiu

Studiuesi Mexhid Yvejsi përshkruan më gjerësisht rrënjët familjare të Hafiz Ymerit, duke përmendur gjyshin e tij Mustafë Sylejmani dhe vëllezërit e tij, Ibrahim, Ismail dhe Osman, të cilët gjithashtu emigruan nga Prokuplja në

Kosovë (Yvejsi, 2010). Një punim më i thelluar rreth figurës së Hafiz Ymerit u krye nga Muhamet Pirraku, i cili i kushtoi më shumë se një dekadë studimeve rreth kësaj figure. Babai i Hafiz Ymerit, Hoxhë Shemsedin Sylejmani, ishte imam në një nga xhamitë e Prishtinës (Kraja, 2016). Hoxhë Semsedni së bashku me mikun e tij Haxhi Pllana ishin dy nga teologët që kanë ligjëruar e drejtuar namaz në xhami pas të cilëve është falur Sulltani. Ata dy kur janë kthyer në Kosovë, janë kthyer me një karvan të mbushur me dhurata e shpërblime të çmueshme!

Për me tepër gjysi dhe babai i Hafiz Ymerit ishin aq i pasur, sa zotronin në pronësi tyre ato që sot njihen si Lagjia Lakrishte, Dragodan dhe pjesën më të madhe të qytetit të Prishtinës!

Hoxha Shemsedini njihej për predikimet e tij të fuqishme dhe për rolin e tij si mësues i fesë në mejtepin ku shërbente. Muhamet Pirraku përmend se Hoxhë Shemsedini, si dhe djali i tij Ymeri, ishin të njohur për titullin Hafiz, të cilin e fitojnë ata që mësojnë të gjithë tekstin e Kuranit përmendësh. Hoxhë Shemsedini ndërroi jetë në vitin 1903, kur Hafiz Ymeri ishte vetëm tetë vjeç. Tre vite më vonë, në vitin 1906, vdiq edhe gjyshi i Hafiz Ymerit, Mustafë Sylejmani, të cilin e njihnin si "Ustah Mutishi" (Pirraku, 1992).

Pas mbetjes jetim, Hafiz Ymeri kaloi pjesën tjetër të jetës së tij në Ferizaj, ku u kujdes për të daja i tij, Ahmet

(Bajram) Pllana, i njohur si Haxhi Pllana, një prej personaliteteve më me ndikim në qytet. Haxhi Pllana kujdesej për motrën e tij, Myqeremen, nënën e Hafiz Ymerit, si dhe për fëmijët e saj derisa ata u rritën dhe u martuan. Një fenomen interesant që shpesh vihet re është se individët që mbeten jetimë arrijnë shpesh të bëhen më të suksesshëm sesa ata që mbështeten nga familja.

Në një moshë të re, Hafiz Ymeri u përball me vështirësi të mëdha emocionale, të ngjashme me ato të fëmijëve të tjerë jetimë. Kush e di sa herë rrugët e fshatit Sazli janë përshkuar nga lotët e mallëngjimit të tij e të motrës e vëllezërve. Këto përvoja të trishta, të shoqëruara me pikëllim të thellë, i formësuan personalitetin dhe ndikuan në forcimin e tij shpirtëror.

Përkëdhelja e kokës së një jetimi konsiderohet si një akt përkushtimi fetar në Islam, dhe ngrohtësia që Hafiz Ymeri dhe motrat e vëllezërit e tij mund të kenë ndjerë nga daja i tyre, Haxhi Pllana, përfaqëson një model të këtij përkushtimi. Vetëdija humane e Haxhi Pllanës ishte formuar nga kultura dhe dijet e tij fetare, duke i ofruar familjes mbështetje dhe dashuri të thellë. Në kulturën shqiptare, jetimët kanë pasur gjithmonë një trajtim të veçantë dhe janë konsideruar si kategoria më e brishtë që meritonte mëshirë dhe mbështetje. Dhe si gjithmonë, ata që janë rritur si jetimë kanë ditur t'i kthejnë të mirën shoqërisë, siç është shembulli i Hafiz Ymerit.

MUSTAFË SYLEJMANI Gjyshi i Hafiz Ymerit	IBRAHIM SYLEJMANI	ISMAIL SYLEJMANI	OSMAN SYLEJMANI

SHEMSEDIN SYLEJMANI	**MYQERREME PLLANA**
Babai i Hafiz Ymerit	Nëna e Hafiz Ymerit

MUSTAFË SYLEJMANI (Vëllai Hafiz Ymerit)
Fëmijët: Aliriza, Jusuf, Shefkije, Fevzie, Nezaqete
(Familjarët e bacës Mustafë tani kanë mbiemrin Hashani)

MYMIN SYLEJNANI (Vëllai i Hafiz Ymerit)
Fëmijët: Rasim, Rukije, Naxhije, Shukrije, Hajrije, Emaze, Xhemile
(Familjarët e bacës Mumin kanë mbiemrin Mustafa)

ESMA SYLEJMANI (Motra e Hafiz Ymerit)
Fmijët: Fahrije, Kadrije, Sadije dhe Tefiku

YMER SHEMSEDINI (SYLEJMANI) *(Hafiz Ymeri)*

HANUMSHAHE CERRABEGU (*Bashkëshortja e parë)*
Të tre fëmijët e lindur, jetuan veç muaj dhe kualua në Përjetësi!

FATIME QORRI *(Bashkëshortja e fundit)*

FAIK SHEMSEDINI	*Djali i vëllait të HafizYmerit, djali i Mustafë Sylejmanit, të cilin e kishte kujdesur – adoptuar Hafiz Ymeri*
JUSUF SHEMSEDINI	*Fëmija i bashkëshortes së Hafiz Ymerit, të cilin e kishte adoptuar Hafiz Ymeri*

Figura 2: Trungu familjar Hafiz Ymeri Shemsiut

Nën mentorimin e Haxhi Pllanës, Hafiz Ymeri formoi një qasje dhe kulturë që ndikoi në angazhimin e tij publik dhe në ndërtimin e personalitetit të tij të fuqishëm.

Në jetën e tij personale, Hafiz Ymeri ishte i martuar me Hanumshahe Cerrabregu nga Bregu i Zi i Lipjanit, motra e Shaban Cerrabregut, një personalitet fetar i kohës. Fatkeqësisht, të tri fëmijët e tyre vdiqën pak muaj pas lindjes. Më vonë, Hafiz Ymeri u martua me Fatime Çorri nga Prishtina, e njohur gjithashtu si "Aba Fatime".

Ajo ishte një grua e veçantë, me moral të lartë dhe njohuri të thella, dhe Hafiz Ymeri pranoi të birësonte djalin e saj, Jusufin, të cilin e rriti si të tijin. Pavarësisht përpjekjeve të tyre për të pasur një fëmijë të përbashkët, ata humbën një djalë pas një viti nga lindja e tij. Megjithatë, dashuria dhe përkushtimi i Hafiz Ymerit ndaj Jusufit vazhdoi të jetë i palëkundur.

Gjatë hulumtimit për këtë libër, kemi pasur rastin të bisedojmë me djalin e Jusufit, bacën Hasan (Jusuf) Shemsedinin, i cili së bashku me vëllezërit e tij mbajnë mbiemrin e Hafiz Ymerit, duke vazhduar trashëgiminë e këtij gjiganti të Ferizajt.

Muhamet Pirraku (1992) gjithashtu përmend se Hafiz Ymeri kishte birësuar edhe djalin e vëllait të tij, Faik (Mustafë) Sylejmanin (1917 – 1974).

Figura 3: Esma Ymeri - Statovci (motra e Hafiz Ymerti) me bashkëshortin e saj Hafiz Mulla Sejdi Vesel Statovci!

Motra e Hafiz Ymerit, Esma Shemsedin Sylejmani, ishte e martuar me Hafiz Mulla Sejdi Vesel Statovci, një pedagog i njohur i asaj kohe (1889 – 1953).Hafiz Ymeri, me origjinën e tij nga një familje intelektuale dhe e përkushtuar, mbeti jetim në moshë të vogël, por mori një edukim të shkëlqyer dhe formoi një personalitet të fuqishëm, duke ndikuar në zhvillimin e tij si një figurë e madhe dhe e rëndësishme për shoqërinë.

Kush ishte mentori i i Hafiz Ymeri– Haxhi Pllana: Shkollari që zgjodhi Ferizajn (1848–1943)

Ahmet Bajram Pllana, i njohur si Haxhi Pllana, ishte një nga figurat më të mëdha që Ferizaj ka njohur ndonjëherë. Si daja dhe kujdestari i Hafiz Ymerit, ai luajti një rol kyç në edukimin dhe formimin e tij. Haxhi Pllana, përveçse një edukator i shquar, është njohur për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në arsim dhe për mbrojtjen e vlerave kombëtare dhe fetare të shqiptarëve të rajonit. Haxhi Pllana lindi në fshatin Pllanë, në komunën e Prokuplës.

Figura 4: Haxhi Ahmet (Bajram) Pllana

Pas shpërnguljeve masive të shqiptarëve nga trojet e tyre gjatë periudhës 1877-1878, të shkaktuara nga politika aneksuese e Serbisë, familja e Haxhi Pllanës u vendos fillimisht në fshatin Sazli dhe më pas në qytetin e Ferizajt (Retkoceri & Marevci, 2007).

Studimet e haxhi Pllanës në Xhaminë Fatih, Stamboll

Haxhi Pllana kreu studimet e tij në Qendrën Arsimore të Xhamisë Fatih në Stamboll, një nga institucionet më të respektuara të asaj kohe, ku zhvilloheshin studime në fusha të ndryshme si teologjia, drejtësia, mjekësia, astronomia, fizika dhe matematika.

Qendra ishte ndërtuar në shekullin e XV dhe ishte një vatër e dijes për shumë figura të rëndësishme shqiptare që edukuan breza të rinj në trojet shqiptare.

Studimet në Universitetin e Al-Az'har, Kajro

Përveç studimeve në Stamboll, Haxhi Pllana studioi gjithashtu në Universitetin Al-Az'har në Kajro, një nga universitetet më të vjetra dhe më të respektuara në botë. Ky universitet ka luajtur një rol kyç në edukimin e elitave intelektuale islame. Në kohën e Haxhi Pllanës, Al-Az'har kishte një reputacion të krahasueshëm me atë të universiteteve të mëdha si Harvard. Kush e di, mbase në të ardhmen universitetet tona do të kenë një prestigj të ngjashëm!

Imam në Xhaminë Sulltan Ahmet, Stamboll

Pas përfundimit të Medresesë në Stamboll, Haxhi Pllana u bë një nga ylematë (dijetarët) më të njohur të kohës, duke shërbyer si imam në Xhaminë Sulltan Ahmet. Ai u nderua nga vetë Sulltan Abdul Hamiti II, i cili e dekoroi me titullin "Taxh" për kontributin e tij. Kur vizitoni Aja Sofinë, mund të kujtoni se përballë saj, në Xhaminë Sulltan Ahmet, predikonte dhe drejtonte lutjet shqiptari i Ferizajt, Haxhi Pllana (Hyseni-Goga, 2014).

Kthimi në Ferizaj dhe shërbimi në xhaminë e madhe

Pas kthimit nga Stambolli, Haxhi Pllana fillimisht shërbeu në Xhaminë e Vogël të Ferizajt, e njohur gjithashtu si Xhamia e Boshnjakut. Megjithatë, më vonë ai mori rolin e imamllëkut edhe në atë që sot njihet si Xhamia e Madhe e Ferizajt, një qendër e rëndësishme fetare dhe kulturore e qytetit. Pikërisht afër kësaj xhamie, në vitin 1909, Haxhi Pllana hapi një shkollë shqipe, duke kontribuar në ngritjen e arsimit kombëtar në rajon. Përmes këtij institucioni arsimor, ai edukoi gjenerata të reja dhe luajti një rol kyç në përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe në Ferizaj dhe më gjerë .

Hapja e Shkollës Shqipe në Ferizaj

Në vitin 1909, Haxhi Pllana hapi një shkollë shqipe në Ferizaj, duke vendosur themelet e arsimit shqip në rajon (Hashani, 1998; Retkoceri & Marevci, 2007). Studiuesi

Muhamet Pirraku thekson se ekzistonin disa medrese në Kosovë gjatë kësaj periudhe, dhe medreseja e Ferizajt, e themeluar nga Haxhi Pllana, ishte një nga institucionet më të rëndësishme arsimore në qytet.

Figura 5: Xhami e madhe dhe mejtepi i xhamisë së madhe mbi të cilin mejtep do ndërtohet më vonë Kisha Ortodokse Serbe. Kjo është fotografi e vitit 1903 e bërë nga Baron Franz Nopcsa

Ai mbahet mend jo vetëm për dijen e tij të thellë, por edhe për aftësinë e tij për të ligjëruar dhe komunikuar me njerëzit. "Të moshuarit e kujtojnë si një hoxhë të madh, jo vetëm për diturinë e tij, por edhe për aftësinë e tij për të trajtuar problemet e kohës" (Retkoceri & Marevci, 2007).

Puna për të ndaluar shpërnguljet e Shqiptarëve

Një nga aspektet më të rëndësishme të aktivitetit të Haxhi Pllanës ishte përpjekja e tij për të ndaluar shpërnguljet masive të shqiptarëve drejt Turqisë. Ai ndihmoi në ndalimin e migrimit të shumë qytetarëve duke ndërtuar shtëpi dhe duke i shitur ato me çmime të përballueshme, vetëm për të penguar shpërnguljet (Retkoceri & Marevci, 2007).

Një anekdotë interesante që përshkruhet nga familjarët e tij, si baca Mahmut Mahmuti, tregon se Haxhi Pllana përdorte një pyetje të thjeshtë për t'i bërë njerëzit të mendonin dy herë për t'u regjistruar si turq për të migruar në Turqi: "A dini turqisht?" Kur përgjigja ishte "Jo!", ai u thoshte: "Ju jeni shqiptarë, nuk e dini turqishten, si mund të jeni turq?" Ai arrii të bindte ferizajas të qëndronin në atdheun e tyre.

Bamirësia e haxhi Pllanës

Përveç veprimtarisë së tij fetare dhe arsimore, Haxhi Pllana ishte një bamirës i njohur. Ai nisi një traditë të veçantë duke ofruar iftar për agjëruesit kalimtarë në xhaminë ku shërbente.

Kjo traditë vazhdoi edhe pas vdekjes së tij, duke lënë një trashëgimi të fuqishme në shoqëri (Retkoceri & Marevci, 2007).

Ndërtimi i kishës serbe në oborrin e xhamisë dhe burgosja e haxhi Pllanës

Një nga ngjarjet më të njohura që përfshinë Haxhi Pllanën ishte ndërtimi i Kishës Ortodokse Serbe në oborrin e Xhamisë së Madhe në Ferizaj, një akt që simbolizonte dominimin serb në rajon. Gjatë kohës kur serbët kërkuan leje për ndërtimin e kishës, Haxhi Pllana ndodhej në burg. Studiuesit kanë debatuar për rrethanat e ndërtimit të kishës, por është e qartë se leja për ndërtimin e kishës nuk varej nga një imam shqiptar (Hyseni-Goga, 2014).

Figura 6: Fotografi e vitit 1930, sa kohë që Kisha Ortodokse Serbe ende po ndërtohej në oborrin e xhamisë së madhe (mbi themelet e mejtepit te xhamisë), ku ndodhet edhe sot!

Qemal Retkoceri dhe Ruzhdi Marevci, në monografinë e tyre "Shkollat në Komunën e Ferizajt", e përshkruajnë

Haxhi Pllanën si një figurë me ndikim të madh dhe një patriot që luftoi për të ngritur arsimin dhe vlerat kombëtare në kohë të vështira (Retkoceri & Marevci, 2007).

Haxhi Pllana vdiq më 15 maj 1943 dhe u varros në Ferizaj, duke lënë pas një trashëgimi të pashlyeshme si një nga figurat më të rëndësishme të qytetit.

Ekzistojnë edhe mendime se leja për ndërtim të një kishe iu është dhënë serbëve për një lokacion tjetër. Ndonëse ka edhe mendime se ky nënshkrim u bë duke e mashtruar imamin e nderuar pasi që marrëveshja ishte ndryshe.

Truallin për ndërtimin e kishës ua liroi por jo në vendin ku tash gjendet, mirëpo teksti veç u ndryshua nga pushtetarët dhe me dhunë u ndërtua në vendin që tashmë veç ekziston kisha, dmth në oborrin e xhamisë. (Retkoceri & Marevci 2007).Studiuesit Qemal Retkoceri dhe Ruzhdi Marevci në librin monografik 'Shkollat në Komunën e Ferizajt' kur përmendin figurën e haxhi Pllanës, rrëfimin e tyre përfundojnë si vijon:

''***Le të jetë krenar Ferizaj me rrethinë që e patë edhe një hoxhë, poet, dijetar, trim e atdhetar të tillë që bëri të pamundurën vetëm e vetëm për të ngritur arsimin dhe diturinë aq të nevojshme te ky populll dhe që ngriti vlerat tona fetare e atdhetare nëpër kohë të rrezikshme.***'' (Retkoceri & Marevci 2007).

Figura 7: Ferizaj, viti 1920



Figura 8: : Ferizaj, viti 1920

Arsimimi i Hafiz Ymerit

Hafiz Ymer Shemsiu filloi mësimet e tij të para në Prishtinë, por për shkak të vdekjes së prindërve, shkollimi i tij u ndërpre për një kohë, derisa përkujdesjen për të e mori daja i tij, Ahmet Bajram Pllana, në Ferizaj. Falë përkrahjes së këtij të fundit, Hafiz Ymeri vijoi shkollimin në Medresenë e Prishtinës dhe më pas në Medresenë e Shkupit (Salihu, 1987; Zekaj, 2007; Yvejsi, 2010), edhe pse nuk i përfundoi plotësisht këto institucione.

Figura 9: Prishtina, viti 1900



Figura 10: Shkupi, viti 1900

Shkollimi si autodidakt

Për shkak të rrethanave të kohës, pjesën tjetër të arsimimit e vijoi si autodidakt. Siç përmend Ramiz Zekaj (2007): "Për arsye madhore, ai nuk arriti t'i përfundojë ato. Formimin fetar dhe intelektual të tij ai e vazhdoi në rrugë autodidakte." Hafiz Ymeri është shembulli i një historie suksesi për të gjithë ata që kanë arritur të shkëlqejnë përmes edukimit autodidakt. Përveçse ekspert në teologji, ai u bë një njohës i thellë i politikës kombëtare dhe globale, një linguist dhe letrar i shquar, si dhe një poliglot. Nuk është e tepruar të thuhet se Hafiz Ymeri mund të jetë një nga artistët më të kompletuar që Ferizaj ka njohur ndonjëherë.

Kontributi i tij për kauzën kombëtare, fillimisht përmes edukimit dhe arsimit shqip, më pas përmes artit dhe kulturës, si dhe pjesëmarrja e tij aktive në luftën çlirimtare, përbëjnë veçori unike që pak personalitete të kohës së tij i gëzonin.

"Krahas dajës së tij, Haxhi Pllanës, për mësues të vetin Hafiz Ymeri konsideronte Haxhi Mulla Ahmet Mardoçin e Prishtinës, një patriot dhe pedagog i shquar i Medresesë 'Alauddin'," e cila u dogj nga pushtuesit serbë në vitin 1929 (Pirraku, 1992).

Figura 11: Ferizaj, viti 1900

Memorizimi i Kuranit – Hifzi

Shumë nga figurat e mëdha shqiptare me kontribut të fuqishëm kombëtar u frymëzuan dhe edukuan nëpërmjet programeve fetare të kohës. Ndër këta figura, njohja dhe dashuria për Kuranin ishte e përbashkët. Hafiz Ymeri, si një nga këta personalitete, u bë hafiz, duke fituar titullin që jepet për ata që memorizojnë Kuranin e shenjtë përmendësh. Ky titull i nderuar i dha emrin që e shoqëroi gjatë gjithë jetës: Hafiz Ymeri.

Figura 12: Xhamia e vogël 'Xhamia e Boshnjakut' - Ferizaj (S'ka njohuri për vitin e fotografisë)

Ai e mbrojti publikisht titullin në Xhaminë e Boshnjakëve në Ferizaj, para një komisioni të dijetarëve të njohur të Kuranit. "Kur e mësoi Kuranin përmendësh, titullin e nderuar Hafiz e mbrojti publikisht në Xhaminë e Boshnjakëve, para komisionit përkatës" (Yvejsi, 2010). Ky proces ishte një instrument i kohës për të verifikuar njohuritë e plota të Kuranit dhe mbamendjen e tij të saktë, një arritje që, sipas besimit, mund të realizohej vetëm nga ata që ishin të zgjedhur nga Zoti.

Sipas profesor Musa Krajës, "Hafiz Shemsedini karakterizohej nga një vullnet titanik për studime, kryesisht si autodidakt, me objektiva të qarta personale për të arritur nivelin e hafizit" (Kraja, 2016). Titullin e mbrojti publikisht në Xhaminë e Boshnjakëve, siç përmendin edhe studiuesit Ramiz Zekaj dhe Pirraku (Zekaj, 2007; Pirraku, 1992).

Akademia ushtarake

Një prej arritjeve më të rëndësishme të Hafiz Ymerit ishte përfundimi i Akademisë Ushtarake në Itali (Hetemi & Mustafi, 2013). Duke qenë poliglot dhe njohës i disa gjuhëve, përfshirë italishten, studimet e tij në këtë akademi ushtarake i janë lehtësuar. Më vonë, njohuritë e fituara nga Akademia Ushtarake i përdori në mbështetje të kauzës shqiptare, veçanërisht gjatë luftës për çlirimin e Kosovës Lindore, ku ai dhe shumë hoxhallarë të Ferizajt morën pjesë aktive.

Edukimi gjatë gjithë jetës

Hafiz Ymeri nuk u ndal kurrë së zgjeruari njohuritë e tij. Përveç njohurive të thella në teologji, ai ishte një intelektual i gjithanshëm, me njohuri të thella në linguistikë, letërsi, filozofi, shkenca ekzakte dhe shoqërore. Ai ishte gjithashtu i angazhuar në studimin e politikave globale dhe zhvillimeve të përgjithshme, që e ndihmuan të formojë një vizion të gjerë mbi çështjet kombëtare. Librat dhe revistat shkencore që i vinin rregullisht nga njerëz që udhëtonin në Lindje dhe Perëndim e mbajtën të informuar dhe të angazhuar intelektualisht gjatë gjithë jetës së tij.

Poligloti – njohës i shumë gjuhëve

Njohja e gjuhëve të huaja ishte një tjetër aspekt i jashtëzakonshëm i arsimimit të Hafiz Ymerit.

Një intelektual me një gamë të gjerë njohurish, ai zotëronte disa gjuhë të huaja, përfshirë:

- Gjuhën gjermane
- Gjuhën italiane
- Gjuhën frënge
- Gjuhën arabe
- Gjuhën turke
- Gjuhën perse
- Gjuhët sllave



"Me vullnet të patundur arriti të zotërojë disa gjuhë të huaja si: arabishten, persishten, turqishten, gjermanishten dhe serbishten" (Zekaj, 2007). Njohja e shumë gjuhëve jo vetëm që i mundësoi atij të zhvillonte një kulturë më të gjerë, por gjithashtu i dha aftësinë për të parë çështjet kombëtare në një kontekst global.

Gjuha gjermane ishte një nga gjuhët që ai mësoi në mënyrë të plotë, duke arritur nivelin e përkthyesit. Sipas

Pirrakut (1992), në Shkup, ai iu përkushtua mësimit të gjermanishtes dhe më vonë përkthente nga gjermanishtja në shqip dhe anasjelltas. Njohës i shkëlqyer i shqipes, ai u bë mësimdhënës i parë i gjuhës shqipe në Ferizaj, duke formuar kuadro të rinj në këtë gjuhë.

Në bazë të intervistave me dy nga nxënësit e mbetur të Hafiz Ymerit, ai kishte jetuar një periudhë në Itali, që me shumë gjasë ndihmoi në zhvillimin e njohurive të tij në gjuhët perëndimore. Përveç gjermanishtes dhe italishtes, Hafiz Ymeri zotëronte edhe frëngjishten, arabishten, turqishten, persishten dhe gjuhët sllave, duke e bërë atë një nga poliglotët më të njohur të kohës së tij.

Kultura e përgjithshme

Art dhe Letërsi

Hafiz Ymeri ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në art dhe letërsi, duke u bërë autori i parë i njohur i Ferizajt.

Disa nga veprat e tij nuk janë të dokumentuara si krijime të tij, pasi shpeshherë ato janë trashëguar ose botuar nën autorësi të tjerë.

Kjo ndodhi sepse Hafiz Ymeri nuk e konsideronte të rëndësishme që krijimtaria e tij të njihej si e tij, duke u përqendruar më shumë në prodhimin e artit si instrument për edukim dhe formimin e personalitetit të

komunitetit. Një nga veprat e tij më të njohura është poema "**Nazim Gafurri**", e cila vlerësohet si një nga krijimet më të spikatura letrare-historiografike të periudhës mes dy luftërave botërore.

Letërsi dhe Histori e Rilindjes Kombëtare

Nën udhëzimin dhe orientimin e dajës së tij, Haxhi Pllana, Hafiz Ymeri u lidh me qarqet patriotike të Rilindjes Kombëtare dhe mësoi shkrim-leximin shqip sipas alfabetit të Manastirit. Ai gjithashtu u njoh me letërsinë dhe literaturën e periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare (Pirraku, 1992), duke u formuar si një intelektual i përkushtuar për çështjen kombëtare.

Filozofi

Njohuritë e Hafiz Ymerit nuk kufizoheshin vetëm në teologji dhe letërsi, por ai kishte gjithashtu një formim të thellë në filozofi dhe logjikë, të cilat janë thelbësore në studimet fetare islame sipas studiuesit Ramiz Zekajt (2007).

"Krahas zotërimit të këtyre gjuhëve, ai u thellua në studimet letrare, e në mënyrë të veçantë në studimet filozofike, duke formuar kështu fizionominë e një intelektuali të mirëfilltë islam." Ky formim e bëri atë një figurë intelektuale të kompletuar dhe të respektuar.

Historia botërore

Hafiz Ymeri ishte një "akademik i kohës" me një njohuri të jashtëzakonshme për historinë botërore. Duke lexuar literaturë nga Lindja dhe Perëndimi, ai zhvilloi një kulturë të gjerë dhe një perceptim global mbi zhvillimet historike dhe politike. "Hafiz Ymeri njihte historinë botërore shumë mirë" (Retkoceri & Marevci, 2007), gjë që e ndihmoi të përpunojë dhe të ndërveprojë në favor të çështjes shqiptare në zhvillimet ballkanike dhe globale.

Rrjeti i intelektualëve dhe patriotëve shqiptar

Hafiz Ymeri i përkiste elites intelektuale dhe të partitëve aktiv shqiptar. Ndikim më të fuqishëm te Hafiz Ymeri shtroi daja dhe mentori i tij Haxhi Ahmet Pllana. Por Hafiz Ymeri në faza dhe angazhime të ndryshme do bije të ndërveproj ndër të tjera dhe me disa figura të shquara si: Hasna Prishtina dhe bashkepuntor te tij, Mulla Idriz Gjilani, Ferat Bej Draga, Prof. Shaban Vata, Prof. Sylë Idrizi, Mulla Vesel Guta, Adem Guta, Halit Ibishi, Adem Gllavica, Abdullah Musliu, Rexhep Krasniqi, Vesel Pagarusha, Rizah Strellci, Mulla Arif Shala, Mulla Ahmet Markoçi e të tjerë!

Krahas ndikimit të fuqishëm dhe direkt nga daja – shkollari Haxhi Pllana i Ferizajt, Hafizi është formuar dhe nga intelektualët e tjerë të kohës. Prof Kraja pamend se ndikimin e drejtpërdrejtë që ka pasur edhe nga ‘’kontakti i vazhdueshëm me Haxhi Mulla Ahmet

Markoçin e Prishtinës, atdhetar, pedagog i shquar i Medresesë.'' (Musa Kraja, 2016). Gati çdo kund ku përmendet Hafiz Ymeri përmendet edhe Mulla Vesel Guta si dy nga ferizajasit më me peshë të kohës së tyre, e dy së bashku më vonë si luftëtar e bashkëpunëtor të Mulla Idriz Gjilanit, pastaj me Ferat Dragën e plejadës së intelektualëve të periudhës së jetës së Hafiz Ymerit.

''Realisht nga prilli i vitit 1937 pedagogu e krijuesi letrar Hafiz Ymer Shemsiu ishte njëri ndër këshilltarët krijues të Organizatës së Rinisë Përparimtare Drita të Kosovës me qendër në Arllat të Drenicës. Ishte në lidhje të drejtpërdrejta për veprim me kryetarin e ORP Drita, Mulla Rexhep Krasniqin, me Mësuesin shëtitës, Vejsel Pagarushën, me Mulla Arif Shalën, këshilltarin e Dritës, me studentin Halit Ibishi, e përmes tij me gjithë studentët kombëtar që studionin në Shkup, mandej me Adem Gllavicën dhe me anëtarët e Shoqërisë Kulturore Politike BESA në Zagreb. Kishte lidhje të forta me personelin e Konsullatës së Shqipërisë në Shkup dhe prej andej sillte libra shqip – tituj shkollor, letrar, e historiografike në gjuhën shqipe. Ishte një institucion, një det i pafund, një margaritar. (Pirraku, 1992), (Kraja, 2016).

''Midis këtyre hoxhallarëve, që bënë emër në historinë e Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës, përpos komandantit të përgjithshëm të vullnetarëve për Nënprefekturën e Gjilanit, Mulla Idrisit, ishin edhe Mulla Ramadan Ahmeti, ish-kryetar i bashkësisë komunale të Dobërçanit, kurban i shqiptarizmit, Mulla Ymer Shemsedini, poet i

viteve '30-ta e mualim; Mulla Vejsel Xhelaludin Guta, pedagog mejtepesh, poet e ideolog i Lëvizjes për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, autor i himnit luftarak 'Shqiptarë':

''Dorë për dore të gjithë m'u rrokë
Si madeni qi asht n'tokë,
Kur t'i mëshojmë me shumë kyvet
Vendi s'luen veç gaca qetë…!

'Veprimtarinë arsimore-pedagogjike e filloi në mejtepin e Ferizajit, pranë dajës, Haxhi Pllanës, ku do të mbajë mësime, ndërsa vetë përgatitej për hafiz''. (Mexhid Yvejsi, 2010). Në këtë mejtep – shkollë mësimdhënës kanë qenë edhe hoxhallarët Sylë Idrizi dhe Shaban Vata (Goga,2014),

Bashkëpunim me Mulla Vesel Guta – patrioti i Lidhjes së Prizrenit!

Mulla Vesel Guta ka qenë një nga hoxhallarët, mësimdhënësit, atdhetar dhe poetët e parë dhe më të mëdhenj të Ferizaj. (1905-1986)



Figura 13: Mulla Vesel Guta - forografi e marrë nga libri i tij 'Perëndia më frymëzoi'

Ai ishte i lindur në fshatin Zaskok, rrethi i Ferizajt, në vitin 1905. Ka përfunduar Medresenë 'Mehmet Pasha'

në Prizren. Ka punuar si profesor në Medresenë 'Mehmet Pasha' dhe si mësimdhënës i njohurive për fenë në xhaminë e fshatit Vojnoc të Shtimes!

Mejtepi i 'Mulla Veselit' në fshatin Vojnoc ishte zyrë përfaqësuese e Komitetit të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për Nënprefekturën e Ferizajt

Në xhaminë e Vojnocit krahas njohurive fetare, ai edukoi gjenerata të shumta për t'i shërbyer kauzës shqiptare. Në këtë xhami vijoi punën deri në vitin 1945 kur atë e mbyllën bullgarët.

Ka vdekur në vitin 1986. Ai është autor i librit 'Perëndia më frymëzoi' që janë përmbledhje të poezive dhe këndimeve fetare të shkruara nga ai, por të përmbledhura nga studiues pas vdekjes së tij.

Puna

Hafiz Ymeri ishte një figurë me kontribut të shumëfishtë në fusha të ndryshme. "Ymer Shemsiu është një figurë poliedrike. Ai ishte imam, poet, luftëtar, veprimtar, mësues" (Zekaj, 2007). Studiuesi Mexhid Yvejsi e përshkruan atë si "hoxhë, mësues, atdhetar, pedagog, poet, shkrimtar, rapsod, këngëtar, valltar" (Yvejsi, 2010). Ky përshkrim pasqyron gamën e gjerë të talenteve dhe aftësive të Hafiz Ymerit, i cili kontribuoi në formimin dhe zhvillimin e komunitetit të tij në shumë aspekte, duke përfshirë edhe artin, kulturën dhe arsimin.

Studiuesit për Hafiz Ymerin

Njohja dhe verësimi i Hafiz Ymer Shemsiut në qarqet akademike dhe intelektuale

Hafiz Ymer Shemsiu ka lënë gjurmë të thella jo vetëm në historiografinë shqiptare, por edhe në studimet ndërkombëtare për çështjet shqiptare në shekullin XX. Figura e tij është vlerësuar dhe përmendur nga studiues të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj, të cilët e kanë njohur rëndësinë e tij në fushat e arsimit, kulturës, fesë dhe politikës kombëtare. Ai konsiderohet si një nga figurat kyçe të shqiptarëve të shekullit XX, duke qenë një simbol i rezistencës, edukimit dhe përkushtimit ndaj kombit. Për këtë arsye, ai shpeshherë është quajtur "Ideolog i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare". Një nga studiuesit më të shquar që ka trajtuar figurën e Hafiz Ymerit është prof. Muhamet Pirraku, i cili ka hulumtuar thellësisht mbi jetën dhe veprën e tij. Studimet e Pirrakut, që datojnë që nga vitet 1980, përfshijnë intervista të drejtpërdrejta me familjarë, bashkëpunëtorë dhe ish-nxënës të Hafiz Ymerit. Një nga veprat më të njohura të tij është botimi i vitit 1992 në revistën "Dituria Islame", ku Hafiz Ymeri përshkruhet si "Bardi i Kosovës" i viteve '20 dhe '30, duke i kushtuar figura të jashtëzakonshme rezistencës shqiptare.

Prof. Muhamet Pirraku thekson se Hafiz Ymeri ishte një personalitet që punoi me përkushtim për mbrojtjen e Shqipërisë etnike, pa u joshur nga ideologjitë sllave apo

ato që synonin copëtimin dhe shkombëtarizimin e trojeve shqiptare. Për të, mbrojtja e fesë islame ishte një akt kombëtar, ndërsa përpjekjet e tij për ruajtjen e gjuhës shqipe ishin të një rëndësie të madhe kombëtare. Ai mbeti një simbol i luftës për liri dhe të drejtat e shqiptarëve të Kosovës.

Studiuesit shqiptar për Hafiz Ymer Shemsiun

Dr. Musa Kraja

"Hafiz Ymeri vazhdonte të punonte me përkushtim për Shqipërinë e plotë dhe nuk u josh asnjëherë ndaj synimeve ideologjike sllave e të tjera, aq shumë të interesuara për copëtimin dhe shkombëtarizimin shqiptar. Ai kishte për ideal Shqipërinë etnike dhe nuk u pajtua asnjëherë me lëshimet as koncesionet ideologjike."

"Hafiz Ymeri i Kosovës është një nga ata personalitete të shquara shqiptare që shkriu në një mbrojtjen e fesë islame, mbrojtjen e gjuhës shqipe, luftën për liri, luftën kundër denacionalizimit të Kosovës, dhe propagandën e veprimtarinë kundër shpërnguljes së shqiptarëve."

Dr. Musa Kraja ka qenë një doktor i shkencave pedagogjike dhe profesor universitar i njohur për kontributin e tij në fushën e arsimit dhe pedagogjisë në Shqipëri. Ai ka publikuar vepra të shumta dhe është nderuar me titullin Mësues i Merituar.

Dr. Ramiz Zekaj

"Hafiz Ymer Shemsiun studiuesit e quajtën 'Bard i Kosovës'. 'Bardi i Kosovës' e sfidoi policinë serbe duke u mësuar shqip nxënësve dhe popullit, duke shkruar shqip dhe duke shtypur shqip."

Dr. Ramiz Zekaj është një studiues i orientalizmit dhe ligjit islam. Ai është themelues i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam dhe drejton departamentin shkencor të revistës Universi.

Dr. Muhamed Pirraku

"Hafiz Ymeri ishte frymëzues i Lëvizjes Popullore për ruajtjen e kufijve etnikë të Shqipërisë."

"Ta mbrosh fenë islame, për kohën e poetit, ishte luftë për kombin shqiptar; ta mbrosh gjuhën shqipe ishte heroizëm kombëtar; të përpiqesh për lirinë, ta ndihmosh Rezistencën Shqiptare kundër denacionalizimit të Kosovës; kundër shpërnguljes së shqiptarëve ishte luftë patriotike dhe ishte sakrificë dhe heroizëm kombëtar."

Prof. Muhamet Pirraku ishte një historian dhe publicist shqiptar, i cili ka qenë këshilltar shkencor në Institutin Albanologjik të Kosovës. Studimet e tij mbi Hafiz Ymer Shemsiun janë ndër më të thelluarat, përfshirë botimet e vitit 1992 në revistën Dituria Islame.

Dr. Sadik Mehmeti

"Ymer Shemsiu krahas Vejsel Xhelaludin Guta nga Ferizaj dhe shumë të tjerë janë autorë të njohur veprash fetare, didaktike dhe atdhetare, disa prej të cilave të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab, në radhë të parë për nevoja të nxënësve dhe studentëve, e pastaj edhe të masës së gjerë të komunitetit mysliman."

Dr. Sadik Mehmeti është doktor i shkencave të historisë dhe bashkëpunëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Ai ka publikuar disa studime mbi figurat fetare dhe kombëtare shqiptare, duke theksuar rolin e tyre në arsimin dhe atdhetarizmin shqiptar.

Mexhid Yvejsi

"Hafiz Ymer Shemsiu ishte hoxhë, mësues, atdhetar, pedagog, poet, shkrimtar, rapsod, këngëtar, valltar."

Mexhid Yvejsi një studiues dhe autor i mbi 25 librave, përfshir përkthime dhe shkrime të gjinisë letrare dhe historike. Ai ka studiua gjerësisht për Hafiz Ymer Shemsiun, duke nxjerrë në pah kontributi e tij të shumëanshëm

Albin Kurti

"Hafiz Ymer Shemsiun krahas Hasan Masuricës, përveçse dijetarë të fushave të ndryshme, luftuan me armë në dorë kundër pushtuesve bullgarë e kundër atyre serbë gjatë Luftës së Parë Botërore."

Albin Kurti është një politikan dhe aktivist shqiptar, aktualisht kryeministër i Kosovës dhe një nga figurat më të rëndësishme të Lëvizjes Vetëvendosje. Në urimin e Bajramit të vitit 2017, ai përmendi kontributin e Hafiz Ymerit në luftën për çlirimin e Kosovës.

Roald Hysa

"Hafiz Ymeri renditet ndër 30 figurat më të shquara myslimane me kontribute të ndjeshme në shoqërinë shqiptare."

Roald Hysa është një studiues nga Tirana, i njohur për punën e tij në fushën e mendimit dhe qytetërimit islam. Ai e renditi Hafiz Ymerin në mesin e figurave më të shquara myslimane që kanë kontribuar ndjeshëm në shoqërinë shqiptare.

Ramadan Shkodra

"Hafiz Ymeri ishte për një Shqipëri etnike. Ai mori pjesë aktive për realizimin e kësaj ideje, duke ngjallur armiqësinë e pushtetit serb ndaj tij."

Ramadan Shkodra është një studiues nga Prishtina, i cili ka hulumtuar për rolin e Hafiz Ymerit në çështjet kombëtare dhe fetare shqiptare.

Abdullah Musliu

"Poet shumë i zgjuet dhe u konsideronte si myderriz, fatkeqësisht sikur të ishte ky në një shtet të madh sigurisht kishte me arritë te Mehmet Akifi."

Abdullah Musliu ishte një intelektual nga Ferizaj, i njohur për rolin e tij në komunitetin lokal dhe për shkrimet e tij në formën e ditarëve historikë.

Dr. Mehdi Hyseni

"Hafiz Ymer Shemsiu ishte një nga personalitetet e shquara kombëtare, fetare dhe atdhetare."

Dr. Mehdi Hyseni është doktor i marrëdhënieve politike ndërkombëtare dhe bashkëpunëtor i Institutit të Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Boston, SHBA.

Dr. Fahrush Rexhepi

"Në mesin e 300 hoxhallarëve shqiptarë që i shërbyen kauzës shqiptare, ishin edhe: Mulla Iljaz Broja, Mulla Ibrahim Polaci, Hafiz Imer Shemsiu dhe të tjerë."

Dr. Fahrush Rexhepi është një teolog dhe historian shqiptar, i njohur për punën e tij mbi hoxhallarët shqiptarë jashtë Shqipërisë londineze.

Dr. Rexhep Suma

"Hafiz Ymer Shemsiu renditet përkrah figurave të shquara të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke përfshirë Mulla Isuf Kraja, Hafiz Ali Riza Ulqinaku, Rexhep Voka dhe të tjerë."

Prof. Rexhep Suma është një studiues i njohur shqiptar me doktorata në masmedia dhe shkenca fetare. Ai ka publikuar disa libra dhe artikuj mbi personalitetet kombëtare shqiptare.

Hajrullah Koliqi

"Hafiz Shemsedni bashkëpunoi me Mulla Rexhep Krasniqin, me mësuesin shëtitës Vesel Pagarusha, me Mulla Rexhep Shalën etj., në disa drejtime të dobishme atdhetare e mes tjerash për gjuhën shqipe."

Hajrullah Koliqi është një pedagog dhe historian i arsimit, pjesë e komunitetit shqiptar në Mal të Zi, dhe autor i disa veprave akademike.

Ibrahim Grainca – Cërnilla

"Hafiz Ymeri thoshte atëherë se po të shkonte edhe gjaku deri në gju, vendin tonë nuk duhet ta lëshonim''. Këto fjalë të tij më kanë mbetur në mendje. Kur më prekin në shpirt malli e mërzia, jetoj sikur një pemë pa gjethe: ajo që nuk thahet e as nuk rritet, por hije nuk e ka e nuk mund të rrijë kush nën hijen e saj.

Ibrahim Grainca patrioti dhe aktivistë i kauzë shqiptare. Pjesë e organizimeve të NDSh-ës n rajonin e Ferizajt. I burgosuar për vite të tëra nga serbët. Në burg mësoi shkrimin dhe leximin shqip, nga cila njohuri rrodhi dhe shkrimi i ditarit voluminoz, të cilën e kanë përpunuar studiesit dhe botuar në si libër 'Deri në vdekje për atdhe (Kujtime). Në këtë libër ka përmendur disa herë figurën e Hafiz Ymerit.

Isa Baftiaj

"Hafiz Ymeri bëri një punë shumë të rëndësishme për hapjen e një shkolle në gjuhën shqipe në Sazli dhe Talinoc."

Isa Baftija është një autor nga Ferizaj, i cili ka bërë mastër në gjuhë dhe letërsi shqipe dhe ka shkruar disa libra mbi autorët dhe figurat historike nga rajoni i Ferizajt.

Qemajl Retkoceri & Ruzhdi Marevci

"Për shkak të veprimtarisë atdhetare, Hafiz Imeri është ndjekur dhe përndjekur vazhdimisht."

"Hafiz Imeri ua mësonte shkrim-leximin nxënësve edhe në gjuhën shqipe. Ky veprim ishte i ndaluar nga sistemi i atëhershëm."

Qemal Retkoceri dhe Ruzhdi Marevci janë pedagogë dhe studiues nga Ferizaj, të njohur për kontributin e tyre në studimin e arsimit dhe historisë lokale.

Raziah Strellci

"T'falem nderës Hafuz i jonë, gjithë rinisë i ke ndihmue, gjithë kur folshim për gjuhë tonë, fjalët tona i ke forcue."

Raziah Strellci ishte një atdhetar dhe rapsodist, i cili përmes poezisë së tij shprehu përkushtimin për lirinë kombëtare shqiptare.

Zejnullah Dërguti

''Hafiz Ymeri ishte një ndër intelektualët e rrallë që kombinonte binomin fe dhe atdhe. Ai i vuri themelet e mendimit islam në komunitetin, xhematin e Ferizajt. Emri i tij lidhet ngusht me gjitha zhvillimet e fesë ndërmjet dy luftërave botërore dhe më gjerë. Ishte hoxhë, poet, studiues, ligjërues dhe patriot n kuptimin plotë të fjalës.

Zejnullah Dërguti është hoxhë, djalë i hoxhës Izet Dërguti me nj kontribut 40 vjeçar në shërbim të Këshillit të Bashkësisë Islame i Ferizajt, si sekretar, imam dhe figure kryesore në proceset e BIK-ut në ish-Jugosllavi dhe pas çlirimit të Kosovës. Doli në pension në vitin 2014, ndërsa angazhimin në shërbim të kauzës islame herë pas here e vijon edhe sot!

Dr. Muhamet Shatri

" Hafiz Ymeri u zgjodh anëtar i Komitetit Qarkor të Ferizajt dhe organizoi mobilizimin e vullnetarëve për mbrojtjen e trevave etnike të rrezikuara nga ripushtimi serbo-komunist".

Historian i shquar shqiptar. Ish kryetar i Shoqatës panshqiptare 'Trojet e Abrërit' . Autor i librave dhe studimeve të shumta të historisë shqiptare!

Ramadan Shkodra

- *"Hafiz Ymeri ishte për një Shqipëri etnike. Ai mori pjesë aktive për realizimin e kësaj ideje, duke ngjallur armiqësinë e pushtetit serb ndaj tij."*

Ramadan Shkodra është një studiues nga Prishtina, i cili ka hulumtuar për rolin e Hafiz Ymerit në çështjet kombëtare dhe fetare.

Tefik Ajvazi - Mjaku

- *''Profesor Ymer ... me përgatitje fetare ishte dhe atdhetar i njohur, sepse shumë mësime i mbante edhe në gjuhën shqipe''*

Tefik Ajvazi Mjaku është studiues, arsimtar dhe autor nga Ferizaj, i njohur për kontributin në historinë dhe arsimin shqiptar. Ka botuar monografi për kulturën, arsimin dhe figurat e shquara në Kosovë.

Qëndrimet e studiuesve të huaj për Hafiz Ymer Shemsiun

Robert Elsie

"Hafiz Ymer Shemsiu (1893-1945), imam në Talinoc, që hapi një shkollë shqipe në Sazli dhe Talinoc dhe nga tridhjetë vjershat fetare të çmuara të të cilit kemi vetëm tri."

Robert Elsie ishte një studiues gjerman-kanadez, i specializuar në letërsinë dhe folklorin shqiptar, dhe është autor i shumë veprave që fokusohen në kulturën shqiptare.

Harry T. Norris

"Hafiz Ymer Shemsiu ishte një nga personalitetet kryesore që kontribuoi në edukimin shqiptar dhe në mbrojtjen e identitetit kombëtar."

Harry T. Norris është një studiues dhe edukator britanik, i njohur për studimet e tij mbi Islamin në Ballkan dhe marrëdhëniet ndërmjet botës arabe dhe evropiane.

Dr. Bünyamin Çağlayan

- *"Hafiz Ymer Shemsiu përmendet si një nga poetët e shekullit të XX."*

Dr. Bünyamin Çağlayan është një studiues nga Turqia, i njohur për punën e tij në disa universitete të Turqisë dhe Shqipërisë. Ai ka shkruar për Hafiz Ymer Shemsiun si një nga poetët e njohur shqiptarë të shekullit XX.

Këto thënie dhe qëndrime nga studiues shqiptarë dhe të huaj tregojnë për rolin e jashtëzakonshëm të Hafiz Ymer Shemsiut si një udhëheqës kombëtar, edukator dhe

figurë intelektuale. Ai nuk ishte vetëm një figurë fetare, por një intelektual dhe patriot që ndikoi thellësisht në zhvillimin e gjuhës, kulturës dhe rezistencës shqiptare. Qëndrimet e përmendura pasqyrojnë gamën e gjerë të kontributit të tij në fusha të ndryshme, nga arsimi dhe letërsia, te lufta për liri dhe identitet kombëtar.

Kapitulli 07

Arsim, shkencë dhe shkollë shqipe

Arsimimi shqip

Shqipja e lashtë dhe evolucioni i saj drejt një alfabeti të unifikuar

Gjuha shqipe përbën një nga gjuhët më të vjetra të familjes indo-evropiane, me rrënjë të thella historike në rajonin që dikur përfshinte Ilirinë, tani një pjesë e saj Ilirie njihet si Gadishulli Ballkanik. Ndërsa shqipja si gjuhë flitej përherë nga populli i kësaj treve, shkronjëzimi i saj ka kaluar nëpër etapa të ndryshme, të cilat janë përcaktuar nga rrethanat historike dhe ndikimet kulturore të kohës. Gjuha që shkruajmë sot, me alfabetin latin që përdorim për të shkruar shqip, ka një datë më të re, e lidhur me vendimet e Kongresit të Manastirit të vitit 1908. Ky kongres, i mbajtur për të unifikuar alfabetin e gjuhës shqipe, nuk duhet të ngatërrohet

Kohështrirje

879 –Poemë e vogël në gjuhën shqipe
1398 - Mësime shqip në Xhaminë e Berishajve 'Xhamia e Shqiptarëve' në Greme – Ferizaj
1411 – Shkolla shqipe 'Medreseja Isa Beut' në Shkup
1872 – Alfabet dhe abetare shqip nga Hasan Tahsini
1887 - Mësonjëtora e pare shqipe në Korçë
1903 – Shkolla shqipe ''Medreseja e Ferizajt''
1908 – Kongresi i Manastirit – Unifikimi i alfabetit dhe shkronjave të sotme shqipe
1909 – Normalja e Elbasanit
1915 - Shkolla e Hafiz Ymerit në Sazli
1934 - Shkolla e Hafiz Ymerit në Talinoc të Muhaxhirëve
1941 - Shkolla publike 'Ismail Qemajli' (Tefik

me historinë më të gjerë të shkrimit të shqipes. Shqiptarët e kanë shkruar gjuhën e tyre që prej kohëve të lashta, por me alfabete të ndryshme si grek, latin, arab dhe cirilik, varësisht nga konteksti historik dhe politik i kohës.

Kongresi i Manastirit – 1908: Lindja e alfabetit Latin të shqipes

Nga 14 deri më 22 nëntor 1908, u mbajt Kongresi i Manastirit, një konferencë historike e organizuar nga akademikë dhe intelektualë shqiptarë me qëllimin e përbashkimit të shqiptarëve rreth një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe. Pas diskutimeve të thelluara, u vendos që alfabeti latin të ishte alfabeti zyrtar i shqipes, i cili është përdorur që atëherë. Ky vendim ishte një hap historik drejt standardizimit të gjuhës sonë kombëtare.

Normalja e Elbasanit – 1909: Institucioni që përgatiti kuadrot e para për mësimdhënësit e gjuhës shqipe

Me vendosjen e alfabetit latin, u bë i domosdoshëm përgatitja e kuadrove të reja që do të mund të mësonin gjuhën shqipe sipas alfabetit të ri. Në këtë kuadër, më 1 dhjetor 1909, u hap Normalja e Elbasanit, e para shkollë kombëtare pedagogjike në Shqipëri. Ky institucion u themelua në bazë të vendimeve të Kongresit Kombëtar të Elbasanit të mbajtur nga 2 deri më 8 shtator të atij viti. Me rreth 140 nxënës të ardhur nga Shqipëria dhe trevat e tjera

shqiptare, përfshirë Kosovën dhe Çamërinë, Normalja u bë bërthama e përgatitjes së mësuesve të rinj që do të shpërndanin arsimin shqip në mbarë viset shqiptare.

Shkollat shqipe dhe tradita e tyre e lashtë

Shkollat shqipe nuk u krijuan vetëm pas Kongresit të Manastirit. Arsimimi në gjuhën shqipe ka ekzistuar që nga kohët më të hershme, duke reflektuar zhvillimet arsimore të popujve të tjerë evropianë. Shqiptarët nuk ishin të izoluar nga përparimet e arsimit të organizuar, dhe varësisht nga konteksti historik dhe ndikimet perandorake, ata mund të kenë pasur mundësi për zhvillimin e arsimit të tyre.

Dëshmia e hershme e shkrimit shqip në forma të ndryshme ekziston, pavarësisht nga presioni i pushtuesve të ndryshëm për të penguar këtë zhvillim. Është e gabuar të kufizohet historia e arsimit shqip si e ndaluar vetëm gjatë periudhës së Perandorisë Osmane, dhe të ndërlidhet arsimi shqip vetëm me strukturat kishtare. Arsimi shqip, përmes xhamive, medreseve dhe institucioneve të tjera fetare, ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar shqiptar, dhe përpjekjet për të demonizuar këtë arsim janë jo shkencore dhe dëmtojnë kauzën kombëtare.

Historikisht, janë përmendur shembuj të shkrimeve shqip që datojnë shumë më parë se dokumentet e njohura. Një dorëshkrim i vitit 879 përmban një poemë të

vogël në gjuhën shqipe. Për më tepër, në mesjetë, ekzistonte Universiteti i Durrësit, i themeluar në vitin 1380 nga murgjit e urdhrit dominikan, edhe pse nuk ka prova të qarta që arsimi aty zhvillohej në gjuhën shqipe.

Roli i udhëheqësve fetarë myslimanë në edukimin shqip

Revista Zani i Naltë, në vitet e 30-ta të shekullit XX, përmendi rolin e udhëheqësve fetarë myslimanë në çështjet kombëtare shqiptare. Kjo revistë theksoi rëndësinë e faktit që shkrimtarët myslimanë, pavarësisht alfabetit të përdorur, shkruan shqip, duke kontribuar në edukimin kombëtar të popullit shqiptar. Artikulli nënvizonte se alfabeti i përdorur nuk ishte i rëndësishëm, për sa kohë që gjuha e shkruar ishte shqip.

Mësonjëtorja e Korçës – Shkolla e parë kombëtare e gjuhës shqipe

Një nga shkollat më të rëndësishme në historinë e arsimit shqip është Mësonjëtorja e Korçës, e hapur më 7 mars 1887, plot 21 vite para Kongresit të Manastirit. Kjo shkollë, e hapur në periudhën e fundme të Perandorisë Osmane, e përdori alfabetin e Stambollit për të mësuar shqipen. Librat dhe revistat shqip botoheshin në Stamboll që nga viti 1879, dhe zyrtarët shqiptarë osmanë ishin ngarkuar me përpilimin e alfabetit të shqipes. Vendimi i qeverisë osmane për krijimin e këtij alfabeti u mirëprit nga Sulltan Abdulhamidi II, i cili madje shprehu dëshirën për të mësuar shqipen me këtë alfabet.

Historia e arsimit shqip është shumë e pasur dhe e ndërlikuar. Ajo përfshin një gamë të gjerë institucionesh dhe përpjekjesh që nga mësonjëtorët e hershme deri tek Normalja e Elbasanit dhe përpjekjet e intelektualëve për unifikimin e alfabetit të shqipes. Të gjitha këto përpjekje janë dëshmi e përkushtimit të shqiptarëve për ruajtjen dhe përhapjen e gjuhës së tyre në kohë të vështira historike.

Figura 14: Gazeta Besa - Bashkim e botuar në gjuhën shqipe në vitin 1908 në Stamboll - Turqi!

Abetaret dhe alfabetet shqipe para Kongresit të Manastirit

Para se të mbahej Kongresi i Manastirit në vitin 1908, ku u vendos përdorimi i alfabetit latin për gjuhën shqipe, ekzistonin disa abetare dhe alfabete të hartuara nga shkollarë shqiptarë, kryesisht të besimit islam, të cilët i përdornin për të zhvilluar arsimin në gjuhën shqipe. Këto përpjekje pasqyrojnë një traditë të gjatë të arsimimit në gjuhën shqipe, shumë përpara se të unifikohej alfabeti i sotëm. Studiues të ndryshëm kanë dokumentuar disa nga këto abetare dhe alfabete, edhe pse padyshim ekzistojnë dhe të tjera që ende nuk janë zbuluar ose dokumentuar plotësisht. Ja disa prej tyre:

1. **Alfabeti i gjuhës shqipe i Hoxhë Hasan Tahsinit (1811-1881)**
   Hoxhë Hasan Tahsini ishte një nga ideologët kryesorë të **Rilindjes Kombëtare Shqiptare**. Në vitin 1872, ai hartoi një alfabet të ri për gjuhën shqipe dhe u shpreh se:
   "Nëse doni të bëhemi komb i qytetëruar, i arsimuar sikurse kombet e tjera të Evropës, duhet të shkruajmë gjuhën dhe të krijojmë letërsinë tonë kombëtare."
2. **Abetarja shqip me germa arabe e Daut Boriçit (1825-1896)**
   Daut Boriçi, një shkollar i njohur i periudhës, hartoi një abetare në gjuhën shqipe me germa arabe, që përdorej kryesisht në kontekstin e arsimit fetar dhe shkollave të medreseve.

3. **Abetarja shqip me germa arabe e Hafiz Ali Ulqinakut (1853-1913)**
   Hafiz Ali Ulqinaku ishte një personalitet fetar dhe arsimtar që kontribuoi në përhapjen e gjuhës shqipe përmes abetares së tij, të shkruar me germa arabe.
4. **Abetarja shqip me germa latine e Said Najdenit (1864-1903)**
   Një tjetër kontribut i rëndësishëm ishte abetarja e Said Najdenit, e cila përdorte germa latine dhe që përfaqësonte një përpjekje drejt standardizimit të shqipes përpara Kongresit të Manastirit.
5. **Abetarja shqip me germa latine e Hafiz Ali Korçës (1874-1957)**
   Hafiz Ali Korça, i njohur për veprimtarinë e tij si arsimtar dhe intelektual, gjithashtu hartoi një abetare në gjuhën shqipe duke përdorur germa latine.
6. **Abetarja shqip me germa arabe e Rexhep Vokë Tetovës (1847-1917)**
   Rexhep Vokë Tetova ishte një nga dijetarët më të njohur të asaj kohe, dhe abetarja e tij në shqip me germa arabe tregonte përpjekjet e vazhdueshme për të përhapur arsimimin në gjuhën shqipe, pavarësisht alfabeteve të ndryshme të përdorura.
7. **Abetarja e Abdulhaqim Hiqmet Doganit (1880-1955)**
   Abdulhaqim Hiqmet Dogani, një tjetër figurë e

rëndësishme e arsimit shqip, kontribuoi me abetaren e tij në zhvillimin e edukimit kombëtar shqiptar.


ABETARE

PRÉ

Hafez Ali-ut

Hatib i Korçes

KORÇE

1910 (1326).

Figura 15: Abetarja e Hafiz Ali Korçës e botuar në vitin 1910

Roli i Hoxhë Hasan Tahsinit në zhvillimin e alfabetit shqip

Hoxhë Hasan Tahsini luajti një rol të jashtëzakonshëm në zhvillimin e alfabetit shqip dhe në përhapjen e arsimit kombëtar shqiptar. Në vitin 1872, ai hartoi një alfabet të ri për gjuhën shqipe dhe shprehu bindjen se arsimi dhe letërsia kombëtare ishin çelësat për qytetërimin e kombit shqiptar. Mendimi i tij se *"duhet të shkruajmë gjuhën dhe të krijojmë letërsinë tonë kombëtare"* përfaqëson thelbin e përpjekjeve të Rilindjes Kombëtare për emancipimin e shqiptarëve përmes arsimit.

Klubi i Shqiptarëve "Bashkim" dhe mbështetja e Sulltan Abdulhamidit II

Pas shpalljes së Kushtetutës së Perandorisë Osmane në vitin 1908, shqiptarët themeluan disa klube kombëtare, ndër të cilat më i rëndësishmi ishte Klubi i Shqiptarëve "Bashkim" në Manastir. Ky klub luajti një rol të rëndësishëm në përpjekjet për unifikimin e alfabetit shqip dhe zhvillimin e arsimit kombëtar. Anëtarët e klubit i dërguan një telegram Sulltanit për të kërkuar ndihmë financiare, duke e informuar për qëllimet e tyre kombëtare. Për shkak të kufizimeve që i kishte sjellë Kushtetuta e re, Sulltani nuk kishte mundësi të vepronte përmes buxhetit shtetëror, por ai e financoi klubin me 100 lira nga pasuria e tij personale (vlerësuar rreth 400,000 dollarë sot).

Ky akt mbështetje nga Sulltan Abdulhamid II ishte një ndihmë e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes kombëtare shqiptare, një fakt i njohur dhe i pranuar gjerësisht, siç e konfirmon edhe gazeta "Lirija" e Mit'hat Frashërit, ku përmendet telegrami i dërguar Sulltanit dhe ndihma e tij financiare për klubin.

Këto alfabetet dhe abetaret të hartuara përpara Kongresit të Manastirit pasqyrojnë përpjekjet e heronjve të arsimit shqiptar për të përhapur gjuhën shqipe, pavarësisht sfidave politike dhe kulturore të kohës. Ndërsa alfabeti latin u standardizua më vonë, kontributet e këtyre

shkollarëve mbeten të pashlyeshme në historinë e arsimit kombëtar shqiptar.

Mejtepet dhe Medresetë: Institucionet e arsimit dhe kombëtarizmit shqiptar

Mejtepet: Shkolla e parë shqipe

"Mejtepet ishin shkolla!" Kjo frazë sintetizon thelbin e këtyre institucioneve arsimore që luajtën një rol jetik në zhvillimin e arsimit shqip në Kosovë dhe në trojet shqiptare. Në këto shkolla, të cilat vepronin kryesisht në shekujt XVII-XVIII dhe më vonë, nxënësit shqiptarë merrnin arsim në shkencat ekzakte, shoqërore, gjuhësore dhe artet e bukura. Ky arsimim i gjerë dhe gjithëpërfshirës ishte një bazament për formimin e brezave të rinj të intelektualëve shqiptarë.

Përveçse mësimi zhvillohej në shqip, mejtepet ishin vendet ku formoheshin gjenerata të reja, të përgatitura për të udhëhequr dhe për të kontribuar në çështjen kombëtare. Siç thotë Prof. Muhamet Pirraku (1995), këto institucione luanin rolin e seminareve të nacionalizmit përparimtar shqiptar, duke përgatitur gjeneratat që më vonë do të merrnin pjesë në lëvizjet kombëtare për liri dhe pavarësi.

Medresetë: Qendra të arsimit dhe rezistencës kombëtare

Medresetë, po ashtu, ishin institucione arsimore të rëndësishme që funksiononin krahas mejtepeve, duke luajtur një rol të dyfishtë: ofronin arsim fetar dhe kombëtar. Shumë prej këtyre medreseve ishin qendra ku përpjekjet për futjen e gjuhës shqipe dhe shqiptarizimin e institucioneve fetare ishin thelbësore. Prof. Pirraku (1989) përmend se këto medrese ishin "çerdhe të arsimit shqip ilegal," të cilat funksiononin si baza politike dhe arsimore të shqiptarëve dhe shpesh ishin në mbikëqyrje të policisë serbe për shkak të aktiviteteve të tyre kombëtare.

Roli i arsimit shqiptar në mejtepe dhe medrese

Edhe pse përmbajtja dhe organizimi i këtyre institucioneve ndryshonin me kohën, mësimi në shqip dhe përkushtimi ndaj çështjes kombëtare ishin konstante. Prof. Ramiz Zekaj (2007) thekson se, pavarësisht nga ndryshimet strukturore dhe programore, mejtepet dhe medresetë gjithmonë kanë ruajtur një përmbajtje të theksuar fetare dhe një edukim fillestar teologjik islam për brezat e rinj.

Për më tepër, këto institucione kanë luajtur një rol të rëndësishëm në thellimin e përpjekjeve për shqiptarizimin e xhamive dhe institucioneve të tjera fetare, një përpjekje që kishte për qëllim ruajtjen e identitetit kombëtar. Pirraku(1989) e përmend këtë si një

proces të vazhdueshëm, i cili filloi që në fazat e hershme të arsimimit shqiptar dhe që ndihmoi në krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin kombëtar. ‘’Nga këto mejtepe dhe ato të rangut më të lartë si në Shkup, Selanik, Stamboll, Kajro e vende tjera dolën shumë kuadro të kualifikuara për veprimtari fetare, por edhe për ne sado-kudo ishin të vlefshme, sepse ishin shkëndijat e para të një lloj arsimimi...’’ (Retkoceri & Marevci 2007).

Qendra të arsimit të lartë shqiptar: Nga Medreseja Isa Beu deri te Medreseja e Vushtrrisë

Medreseja Isa Beu në Shkup

Medreseja Isa Beu, e hapur para vitit 1411, është një nga qendrat më të vjetra dhe më të rëndësishme të arsimit në trojet shqiptare. Kjo medrese u bë qendra kryesore ku u edukua shumica e elitës intelektuale shqiptare, e cila më pas do të udhëhiqte zhvillimet politike dhe kulturore të shqiptarëve në rajon. Sipas Krasniqit (2017), kjo medrese luajti një rol kyç në formimin e brezave të intelektualëve shqiptarë, të cilët më vonë do të luanin një rol vendimtar në proceset kombëtare.

Medreseja e Vushtrrisë

Medreseja e parë në Kosovë, Medreseja e Vushtrrisë**,** e themeluar ndërmjet viteve 1444-1455, ishte një tjetër qendër e rëndësishme e arsimit shqiptar. Kjo medrese, si

shumë të tjera, shërbente jo vetëm për edukimin fetar, por edhe për formimin e një klase intelektuale që do të kontribuonte në zhvillimin kombëtar të shqiptarëve.

Roli i mejtepeve dhe medreseve në historinë e arsimit shqiptar është i pashlyeshëm dhe jetik për kuptimin e zhvillimeve arsimore dhe kombëtare në trojet shqiptare. Përmes këtyre institucioneve, brezat e rinj u formuan si intelektualë, patriotë dhe udhëheqës, duke kontribuar në ruajtjen dhe përhapjen e identitetit kombëtar në kohë të vështira. Këto qendra të dijes, të cilat funksionuan për shekuj të tërë, përfaqësojnë themelet e një sistemi arsimor të përkushtuar ndaj çështjes kombëtare dhe shpirtit shqiptar.

Shkollat shqipe në Ferizaj

Shkollat shqipe në Ferizaj: Një vështrim historik dhe shkencor

Në qytetin e Ferizajt kanë ekzistuar shkolla të shumta që përfaqësonin ndikime të ndryshme kulturore dhe politike, si shkollat serbe, greke, austro-hungareze, turke dhe shqiptare. Shkollat shqiptare kryesisht funksiononin si mejtepe dhe medrese, të cilat ishin të lidhura me xhamitë përkatëse dhe ofronin mësim në gjuhën shqipe. Në këto institucione edukative, krahas mësimit të gjuhës shqipe, përfshiheshin edhe lëndë të tjera. Është e mundur që shqipjatë jetë mësuar edhe në shkollat katolike

shqiptare, por të dhënat tregojnë se shkolla katolike që ekzistonte në Ferizaj në fillim të shekullit XX ishte e financuar nga Austro-Hungaria, një pushtues që së bashku me shtete të tjera ballkanike me origjinë sllave përpiqej të copëtonte trojet shqiptare.

Për një periudhë të gjatë kohore, vetëdija për shkolla jo fetare shqipe ishte e munguar, pasi shqiptarët arsimoheshin në institucione pranë xhamive si mejtepet dhe medresetë**.** Këto institucione arsimore ofronin një edukim të gjithanshëm, duke ndikuar në formimin e nxënësve dhe intelektualëve shqiptarë. Vetëm kur ndikimet globale dhe lëvizjet politike ndryshuan, shqiptarët filluan të adoptojnë modele të reja të arsimit laik.

Dy çështje kryesore për shkollat shqipe në Ferizaj

Kur analizojmë shkollat shqipe në Ferizaj nga një perspektivë historike dhe shkencore, është e rëndësishme të kemi në konsideratë dy çështje themelore:

1. **Shkollat shqipe** janë të gjitha institucionet ku është dhënë mësim në gjuhën shqipe, pavarësisht nëse kanë ekzistuar brenda objekteve fetare apo janë zhvilluar nga organizata fetare.
2. **Mohimi i këtij realiteti** do të përbënte një padrejtësi ndaj burrave të mëdhenj shqiptarë, intelektual e paritet që u edukuan në këto institucione – veçanërisht është padrejtsi ndaj

hoxhallarëve – të cilët kontribuuan në edukimin e nxënësve në ato shkolla. Mohimi i këtyre institucioneve do të përforconte narrativën e fqinjëve, të cilët përpiqen të paraqesin shqiptarët si të ardhur apo të sjellë nga turqit, ndërkohë që shqiptarët kanë qenë banorë autoktonë të këtyre trojeve për mijëra vjet.

Është e pamundur të mendojmë se një popull që ka ekzistuar prej mijëra vitesh në këto territore, qysh para erës sonë, do të priste deri në vitin 1941 për të hapur një shkollë shqipe.

Shkolla "Ismajl Qemajli" dhe kontributi i hoxhallarëve shqiptarë

Shkolla "Ismajl Qemajli", e hapur në vitin 1941 në Ferizaj, shpesh citohet si një kundërpërgjigje ndaj arsimit fetar islam. Megjithatë, e vërteta është krejt ndryshe. Mësimdhënësit e parë të kësaj shkolle ishin hoxhallarë dhe ish-medresistë, të cilët kontribuuan në organizimin dhe drejtimin e saj. Njëri nga ta ishte Shaban Vata, i cili, përveçse ishte organizator lokal, shërbente si myezin**në** Xhaminë e Vogël (e njohur si "Xhamia e Boshnjakut") në Ferizaj. Më vonë, ai Shaban Vata u bë drejtori i kësaj shkolle.

Xhamia e Berishajve dhe roli i saj në arsimin shqiptar

Xhamia e Berishajve në fshatin Greme është ndër xhamitë më të vjetra në territorin e Ferizajt, dhe mendohet se është ndërtuar rreth vitit 1398, me disa të dhëna që e lidhin themelimin e saj me vitin 1403. E njohur si Xhamia e Shqiptarëve, ajo ka ekzistuar gati para gjysmë mijëveçari para themelimit të vetë qytetit të Ferizajt. Xhamitë e tilla, përfshirë edhe Xhaminë e Berishajve, ishin gjithashtu qendra arsimore ku zhvillohej mësimi në gjuhën shqipe dhe mësoheshin lëndë fetare e laike. Gjatë viteve 1992-1993, kjo xhami shërbeu si shkollë publike për arsimin paralel, ndërsa në vitin 1999 ajo u përdor si bazë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Rektoceri dhe Mareci (2007) përmendin se përpjekjet për një arsim të mirëfilltë shqip datojnë që nga fillimi i shekullit XX, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane**.** Ata vërejnë se pushteti osman lejoi hapjen e mejtepeve për nxënësit shqiptarë. Në territorin e Ferizajt, këto mejtepe ekzistonin kryesisht në fshatrat më të mëdha ku kishte xhami. ‘’Përpjekjet e shqiptarëve për një shkollim të mirëfilltë, sipas disa gjurmimeve datojnë që nga fillimi i shekullit XX d.m.th. gjatë sundimit të Perandorisë Osmane. Pushteti i atëhershëm lejoi hapjen e mejtepeve për nxënësit shqiptar’’ (Rektoceri dhe Mareci, 2007)

Studiuesit Rektoceri dhe Mareci (2007) shkruajnë se: ‘’Në territorin e komunës sonë (Ferizaj) këso mejtepesh kishte nëpër fshatrat më të mëdha, aty ku kishte xhamia, meqë

mësimi ishte i rangut të klasave të ulëta (prej I-IV). Kjo gjendje zgjati deri më 1912, ku u shpartallua Perandoria Osmane. Edhe përkundër përpjekjeve të shqiptarëve që t'i mbrojnë trojet e veta, në vitin 1912, forcat serbë-malazeze pushtuan Kosovën dhe trojet tjera etnike shqiptare. Ashtu edhe siç dihet pushuesit serb do ushtrojnë mbi shqiptarët ''terror i organizuar shtetëror'.

Pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane në vitin 1912, pushtimi serb ushtroi terrorizëm të organizuar shtetërormbi shqiptarët. Shqiptarët përballeshin me ndalimin e shkollimit në gjuhën shqipe, dhe siç e përshkruajnë studiuesit, dënimet për posedimin e një libri në shqip ishin më të ashpra se për posedimin e armëve.

Rektoceri dhe Marevci (2007) shtojnë që: ''Krahas shtypjes sistematike ekonomike dhe nacionale, popullit shqiptarë, shteti serb me ligj ua mohoi të drejtën e shkollimit shqip. Se sa i vrazhdë ishte terrori serb, sa për ilustrim po përmendi 'më shumë dënohej shqiptari i cili zihej me një libër në gjuhen shqipe, sesa t'i kapeshin disa armë zjarri!'' (Retkoceri dhe Marevci, 2007).

Sipas studiuesit Mustafa (2020), kjo periudhë njihet si nga historianë të arsimit si "periudha e modernizimit të shkollave", ku në plan-programe, krahas përmbajtje religjioze-shoqërore, hyjnë edhe përmbajtje nga lëndët natyrore ndryshe nga periudha paraprake ku shkollimi ishte i sistemit feudalo-skolastik në aspektin pedagogjik

në zbatimin e metodave të punës që bazohej ekskluzivisht në përmbajtjet religjioze. Në zhvillimin e shkollës dhe të arsimit nën Perandori qartë dallohen dy periudha: periudha e parë kap kohën prej vendosjes së Perandorisë në këto treva e deri në gjysmën e shekullit XIX, kur shkollat kanë po ato tipare të sistemit feudalo-skolastik në aspektin pedagogjik në zbatimin e metodave të punës që bazohej ekskluzivisht në përmbajtjet religjioze dhe, periudha e dytë, që nga shumë historianë të arsimit quhet "periudha e modernizimit të shkollave", ku në plan-programe, krahas përmbajtje religjioze-shoqërore, hyjnë edhe përmbajtje nga lëndët natyrore. (Mustafa, 2020)

Ndryshe nga periudha e bashkëqeverisjes në kuadër të Perandorisë Osmane, periudha pas nga pushtuesit ballkanik ishte e pamëshirë me shqiptarët.

Atyre nuk u mjaftonte vetëm vrasje, dëbimi dhe dhunimi i çdo vlere njerëzore që i bënë shqiptarëve për në rrugën e tyre për të aneksuar këto territore ata qenë fiksuar për asimilimin e popullit shqiptar duke fshirë çdo gjurmë shqiptare. Prandaj në këtë periudhë të pushtueseve ballkanik më krim do konsiderohej një fjalë apo material i shkruar shqip se një vrasje.

Serbët ishin jashtëzakonisht radikal në qëndrimet e tyre në raport me mësimin e shqipes ''Regjimi hegjemonist i Mbretërisë së Serbisë'' jo vetëm që nuk lejoi hapjen e shkollave dhe veprimtarinë botuese në gjuhën shqipe,

por edhe e ndaloi përdorimin e saj në jetën publike. (Islami, 1997)

Gjatë Luftës së Parë Botërore, territori i Kosovës u nda në dy zona pushtimi (1915-1918), dhe gjatë kësaj kohe filluan të hapen shkolla shqipe në disa vende të Kosovës. Një nga këto përpjekje ishte edhe ajo e Hafiz Ymer Shemsiut, i cili, me ndihmën e Hasan Prishtinës, në vitin 1915 hapi një shkollë shqipe në fshatin Sazli të Ferizajt. 'Me ndihmën e Hasan Prishtinës, në vitin 1915, Hafiz Ymer Shemsiu e hapi një shkollë shqipe në katundin Sazli, në rrethin e Ferizajit. (Yvejsi, 2010).

Por në ndarjet administrative Ferizaj do të lihej nën pushtimi bullgar, i cili mësimin e shqipes do ta konsideronte krim të pafalshëm. ''Ferizaj ishte zonë e pushtuar nga bullgarët, të cilët e mbyllën pa u bërë muaji, kurse mësuesin, hoxhën, Hafiz Ymer Shemsiun e lidhën me zinxhirë dhe e dërguan, ashtu të lidhur, në burgun e Ferizajit…'' (Yvejsi, 2010)

Jugosllavia i konsideronte Imamët 'Të edukuar në frymën armiqësore ndaj shtetit (Jugosllav)'!

Gjersa lexoni deri në fund për fatin e Hafiz Ymerit, e të keni lexuar për Mulla Idriz Gjilanin, Mulla Vesel Gutën, Mulla Adem Gutën e të tjerë të cilët qenë të përndjekur e përvjuatur nga regjimet e pushtuesve ballkanik, e keni të

pamundur të pranoni teori jo shkencore dhe jo akademike, të cilët hoxhallarët i prezantojnë jo si figura kombëtare, madje si të kundërtat e figurave kombëtare.

Prof Kraja(2016) në studimin e tij tregon që 'pushteti jugosllav nuk kishte besim në myftinjtë e imamët shqiptarë, të cilët kishin një shtrirje të gjerë me 50 myfti e 600 imamë shqiptarë në Kosovën e vitit 1923, edhe pse shumica e tyre nuk e zotëronin gjuhën serbe i trajtonte me idenë se "të gjithë janë të edukuar në frymën armiqësore ndaj shtetit tonë"(Koliqi, 2002). Kështu që kishte gjetur arsye dhe i kishte mbyllur''të gjitha mejtepet, duke lejuar një medrese, ndërsa në shkolla vendosi të zhvillohej lënda e mësimit të besimit.(Kraja, 2016)

Medreseja e Ferizajt (1903 - 1999)

Medreseja e Ferizajt është një ndër shkollat e para formale të arsimit shqip në qytetin e Ferizajt, dhe historia e saj daton që nga viti 1903. Kjo medrese, e njohur si Medreseja e Haxhi Pllanës**,** luajti një rol të rëndësishëm në edukimin e brezave të rinj, duke ofruar mësim në gjuhën shqipe dhe duke përgatitur nxënës për studime të thelluara në teologji dhe lëndë të tjera.

Në vitin 1941, Medreseja e Ferizajt u bombardua nga forcat naziste gjermane, pasi ishte uzurpuar nga ushtria jugosllave. Ky akt shkatërrimi u motivua nga fakti se

forcat pushtuese gjermane e konsideronin medresenë një bazë strategjike të kontrolluar nga armiku. Pas bombardimit, shqiptarët e Ferizajt e rindërtuan medresenë, duke e mbajtur atë si një vatër të rëndësishme të edukimit kombëtar. Megjithatë, në vitin 1999, gjatë luftës së Kosovës, medreseja u dogj dhe u rrënua pothuajse plotësisht nga forcat serbe.

Që nga viti 1999, Medreseja e Ferizajt ka mbetur veçse një kujtim i lavdishëm i rezistencës kulturore dhe edukative të shqiptarëve. Sot, në vendin ku dikur qëndronte medreseja, është ndërtuar një objekt banimi dhe për afarizëm. Gjithsesi, ekziston idea që në të ardhmen këto ndërtesa të shpronësohen dhe medreseja të rindërtohet për të rikthyer simbolikën e saj edukative dhe kulturore.

Roli i Medresesë në edukimin e nxënësve

Në vitin shkollor 1931/32, Medreseja e Ferizajt numëronte 51 nxënës shqiptarë, të cilët ndiqnin mësimet në këtë institucion fetar dhe arsimor. Një ndër figurat më të rëndësishme të kësaj medreseje ishte profesori Hasan Nahi nga Gjakova, njëri nga dijetarët më të shquar shqiptar të kohës. Hasan Nahi njihet gjithashtu si një ndër përkthyesit e parë të Kuranit në gjuhën shqipe, dhe ndikimi i tij në medresenë e Ferizajt ishte i jashtëzakonshëm.

Përmes përkushtimit dhe erudicionit të tij, profesor Nahi arriti të krijojë një bazë të fortë arsimore dhe intelektuale

në këtë shkollë, duke tërhequr nxënës nga vende të ndryshme të Kosovës, përfshirë edhe nga ajo që sot njihet si MaqedoniaeVeriut. Kjo tregon për rolin strategjik dhe kombëtar që kishte medreseja në edukimin e shqiptarëve, jo vetëm në Ferizaj, por në gjithë rajonin e gjerë të Kosovës.

Medreseja e Ferizajt mbetet një shembull i qartë i përpjekjeve të shqiptarëve për të ruajtur identitetin kombëtar dhe fetar përmes edukimit, edhe në kohë të vështira pushtimesh dhe represioni.

Mejtepi i Ferizajt

Mejtepi i Ferizajt, i themeluar nga Haxhi Pllana, luajti një rol thelbësor në arsimimin e shqiptarëve të Ferizajt dhe rrethinave, duke u shndërruar në një qendër të rëndësishme edukative dhe kombëtare. Ky institucion, si pjesë e strukturës së shkollave pranë xhamive, ofronte mësim në gjuhën shqipe dhe përgatitjen për lëndë teologjike dhe shkencore, duke ndihmuar në ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar gjatë një periudhe të vështirë për shqiptarët.

Një ndër figurat kyçe që kontribuoi në këtë mejtep ishte Hafiz Ymeri, i cili jo vetëm që shërbeu si mësimdhënës në këtë institucion, por edhe u përgatit personalisht për të marrë titullin e hafizit. Mexhid Yvejsi (2010) thekson: "Veprimtarinë arsimore-pedagogjike e filloi në mejtepin

e Ferizajit, pranë dajës, Haxhi Pllanës, ku do të mbajë mësime, ndërsa vetë përgatitej për hafiz" (Yvejsi, 2010). Kjo periudhë ishte kyçe për formimin e tij intelektual dhe shpirtëror, ndërsa më vonë do të luante një rol të rëndësishëm në jetën fetare dhe kombëtare të shqiptarëve.Përveç Hafiz Ymerit, në këtë mejtep kanë shërbyer edhe hoxhallarë të tjerë të shquar, si Sylë IdrizidheShaban Vata, të cilët më vonë do të jenë ndër mësimdhënësit e parë të shkollës publike "Ismajl Qemajli" që u hap në Ferizaj më 1941, me iniciativën e ministrit të arsimit shqiptar Ernest Koliqi. Profesor Shaban Vata madje do të emërohej drejtor i kësaj shkolle, duke vazhduar të kontribuojë në edukimin e gjeneratave të reja të shqiptarëve në këtë periudhë të vështirë.

Si Medreseja e Ferizajt, ashtu edhe Mejtepi vepronin në të njëjtin objekt ndërtesor, duke ofruar një sintezë të edukimit fetar dhe kombëtar për shqiptarët. Xhamia e Madhe e Ferizajt kishte gjithashtu mejtepin e saj, i cili ishte ndërtuar afër xhamisë, dhe mbi themelet e këtij mejtepi sot qëndron Kisha Ortodokse Serbe. Kjo kishë, e ndërtuar gjatë periudhës së dominimit serb mbi shqiptarët, përfundoi si një simbol i tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfetare në kohën kur shqiptarët fituan kontrollin politik dhe shoqëror.

Figura 16: Xhamia e Madhe dhe Mejtepi i Ferizajt, tani në themelit e të cilit gjendet objektet e Kishës Ortodokse Serbe!

Shkollat laike në Ferizaj

Shkolla e parë laike në Ferizaj u hap në vitin 1863, në fshatin Nerodime, nga pushtuesit serbë dhe ishte dedikuar kryesisht për komunitetin serb që jetonte në atë zonë. Kjo përpjekje e hershme për të institucionalizuar arsimin në formë laike reflektonte interesat e okupatorëve serbë për të forcuar kontrollin mbi popullsinë lokale përmes shkollimit në gjuhën dhe kulturën e tyre.

Megjithatë, shkolla e parë laike në gjuhën shqipe në qytetin e Ferizajt do të hapet shumë më vonë, më 26 nëntor 1941, me urdhër të ministrit të arsimit të

Shqipërisë, prof. Ernest Koliqi. Kjo shkollë, e njohur fillimisht si "Ismajl Qemajli", vazhdon të funksionojë edhe sot me emrin "Tafik Çanga".

Arsyeja e vonesës për hapjen e një shkolle shqipe në këtë formë laike ishte rezultat i një sërë faktorësh politikë, përfshirë pushtimin dhe administratat e ndryshme që e kishin penguar për një kohë të gjatë këtë përpjekje. Për më tepër, mungesa e mësimdhënësve të kualifikuar lokalë e kishte bërë të vështirë organizimin e arsimit shqip në formë të strukturuar.

Figura 17: Objekti i shkollës së pare shqipe në Ferizaj

Për ta bërë funksional këtë projekt të rëndësishëm, ministri Koliqi dërgoi mbi 300 mësues nga Shqipëria për të nisur arsimin laik në gjuhën shqipe në Kosovë. Një

sfidë tjetër me të cilën përballeshin autoritetet arsimore ishte gjetja e stafit të kualifikuar lokal, pasi një pjesë e madhe e popullsisë së Kosovës ishte arsimuar përmes mejtepevedhemedreseve**.** Ky staf ishte i përgatitur në institucionet fetare, por aftësitë dhe njohuritë e tyre ishin jetike për të mbështetur arsimin laik që po fillonte në rajon.

Në mesin **e** mësimdhënësve të parë të kësaj shkolle ishin edhe hoxhallarët dhe medresistët nga Ferizaj, të cilët kishin ndërtuar një përvojë të pasur akademike përmes institucioneve fetare. Shaban Vata**,** Sylë Idrizi**,** dhe Jusuf Demiri ishin disa nga figurat kryesore që ndihmuan në konsolidimin e këtij sistemi arsimor. Përveç tyre, medresistë nga rajone të tjera të Kosovës, si Idriz Gashinga Pejtreshtica, Sabit Bajrami nga Gumnasella, dhe Abdullah Hoxha nga Kaçaniku, kontribuan gjithashtu në dhënien e mësimit në këtë shkollë të re, duke shërbyer si një urë lidhëse mes arsimit tradicional dhe atij modern.

Kush ishte Prof. Shaban Vata – Mësimdhënësi i parë i Ferizajt (1915 – 1979)

Prof. Shaban Vata ishte një figurë qendrore në historinë e arsimit shqip në Ferizaj dhe më gjerë. Ai përfundoi shkollën fillore, duke ndjekur tre klasa të shkollës qytetare, për të vijuar më pas shtatë klasa të tjera në Medresenë e Ferizajt. Arsimimi i tij nuk u ndal me kaq; në vitin 1943**,** ai përfundoi Kursin Pedagogjik në

Prishtinë dhe Kursin Plotësues në Ferizaj, duke marrë diplomë të Shkollës Normale**.** Ky edukim e përgatiti atë për një karrierë të gjatë e të suksesshme në mësimdhënie.

Prof. Shaban Vata vazhdoi studimet e tij më të larta, duke përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike në Shkup, si dhe Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**.** Kjo arsimim i avancuar i mundësoi që të jetë një mësimdhënës i shkëlqyer, duke kombinuar njohuritë e thella të gjuhës dhe letërsisë shqipe me një përvojë të gjerë pedagogjike.

Prof. Vata filloi karrierën e tij si mësimdhënës feje dhe imam, por roli i tij më i rëndësishëm erdhi si mësimdhënës i gjuhës shqipe në shkollën e parë publike shqip në Ferizaj. Ai ishte ndërthemeluesit dhe mësimdhënësit e parë të kësaj shkolle, e cila fillimisht njihej si "Ismail Qemajli" (më vonë Tefik Çanga). Përkushtimi dhe aftësitë e tij në mësimdhënie bënë që ai të emërohej **drejtor** i kësaj shkolle, duke ndikuar në formimin e shumë gjeneratave të reja të nxënësve shqiptarë.

Figura 18: : Prof. Shaban Vata me një grup nxënës të Shkollës 'Ismajl Qemajli', fotografi e vitit 22.05.1941)

Në përputhje me rritjen e tij profesionale, Prof. Shaban Vata u emërua edhe zëvendësdrejtor **i** shkollës së mesme ekonomike, fillimisht në Ferizaj dhe më pas në Prishtinë. Karriera e tij u shtri për dekada, dhe gjatë kësaj kohe, ai kontribuoi në përparimin e arsimit shqip jo vetëm në Ferizaj, por edhe në Kaçanik**,** Podujevë**,** dhe Prishtinë, ku punoi si mësimdhënës që nga viti 1945. Përmes përkushtimit të tij në edukim dhe mësimdhënie, ai luajti një rol të pazëvendësueshëm në ndërtimin e sistemit arsimor të Kosovës në një kohë kritike për popullin shqiptar.

Aktiviteti pedagogjik i Hafiz Ymerit

Ferizaji, gjatë periudhës së jetës së Hafiz Ymer Shemsiut, përjetoi disa nga periudhat më të errëta të historisë shqiptare, duke u bërë arenë luftërash, pushtimesh dhe gjenocidesh. Pas përfundimit të Luftës së Parë Ballkanike më 1912, serbët morën nën kontroll të gjithë Kosovën, përfshirë edhe Ferizajin. Ky pushtim u njoh formalisht me Traktatin e Londrës në vitin 1913, që kufizoi Shqipërinë në kufijtë e sotëm, duke lënë jashtë tyre një pjesë të madhe të kombit shqiptar. Kosova, përfshirë Ferizajin, ishte pjesë e territoreve që mbetën jashtë kufijve zyrtarë.

Në vitet 1914-1918, gjatë Luftës së Parë Botërore, Kosova u pushtua nga forcat bullgare dhe austro-hungareze. Ferizaji u përfshi në zonën e sunduar nga bullgarët, ku ndodhen masakra të tmerrshme dhe gjenocid. Kjo periudhë mbetet ende e papranuar në mënyrë zyrtare nga asnjë nismë për njohjen e "Gjenocidit Bullgar në Ferizaj" dhe në pjesë të tjera të Kosovës, duke lënë një njollë të errët në kujtesën historike të këtij rajoni.

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore në 1918, fuqitë qendrore kapitulluan dhe në Beograd u shpall Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene, një entitet që vijoi deri më 1941 dhe njihej si "Burgu i Popujve Jo-Sllavë". Ky regjim e shtypi rëndë popullin shqiptar në Kosovë dhe më vonë, do të zëvendësohej nga Jugosllavia, një shtet që përfundimisht do të shpërbëhej përmes luftës së

lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe një aleance të heshtur me NATO-n, që i dha fund dominimit sllav në këtë rajon.

Në këto kushte të ndërlikuara historike, filloi aktiviteti pedagogjik i Hafiz Ymer Shemsiut, një nga figurat më të shquara dhe të formuara të Ferizajt. Sipas studiuesit të njohur,Prof. Muhamet Pirraku**,** aktiviteti i tij pedagogjik mori formë në vitin 1915, në kushtet e vështira që krijoi Lufta e Parë Botërore. Siç thekson Pirraku, në këtë kohë, "aktiviteti i mirëfilltë pedagogjik i Hafiz Ymerit zë fill më 1915. Në rrethanat që u krijuan nga Lufta e Parë Botërore do të përfitojë edhe çështja shqiptare e Kosovës, ndonëse e ndarë në dy zona okupuese: austro-hungareze dhe bullgare. Në zonën austro-hungareze u hap një perspektivë e madhe për arsimin dhe kulturën shqiptare, kurse në zonën okupuese bullgare jetohej nën urdhra të ligjeve barbare sllave gjenocidiste. Ferizaj me rrethinë i takonte kësaj zone. Megjithatë, aktiviteti arsimor i Hasan Prishtinës do të ndihet edhe këtu. I ndikuar nga Hasan Prishtina, nëpunësi i bashkisë (komunës) së Talinocit, Hafiz Ymer Shemsiu, e hapi një shkollë shqipe në fshatin Sazli" (Pirraku, 1992).

Kjo periudhë e aktivitetit të Hafiz Ymerit përkon me një kohë kur shqiptarët përpiqeshin të ruanin identitetin dhe kulturën e tyre në mes të një represioni të rëndë nga pushtuesit. Përmes hapjes së shkollës në Sazli, ai jo vetëm që kontribuoi në edukimin e gjeneratave të reja, por edhe në mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare në

një kohë kur këto vlera ishin të rrezikuara nga asimilimi dhe dhuna sistematike e pushtuesve.

Aktiviteti pedagogjik i Hafiz Ymerit dhe figura e tij mbeten një monument i përpjekjeve për të ruajtur arsimin dhe identitetin kombëtar në një periudhë të errët të historisë shqiptare, dhe përmes veprës së tij, Hafiz Ymeri ngrihet si një model për pasardhësit e tij, duke ilustruar qëndresën intelektuale dhe kombëtare të popullit shqiptar.

Hafiz Ymeri hapi dy shkolla shqipe

Shkolla Shqipe në Sazli – 1915

Hafiz Ymeri konsiderohet mësimdhënësi i parë i gjuhës shqipe dhe i mësimit të organizuar shqip në Ferizaj. Në vitin 1915, ai themeloi një shkollë - mejtep në fshatin Sazli të Ferizajt, e cila për pak kohë u bë qendër e përhapjes së gjuhës shqipe. Por, brenda një kohe të shkurtër, pasi autoritetet bullgare që mbanin pushtimin e Ferizajt mësuan për ekzistencën e saj, shkolla u mbyll dhe Hafiz Ymeri u burgos si themelues dhe mësimdhënës. Këtë shkollë Hafiz Ymeri e kishte hapur me mbështetjen e frymën e krijuar nga Hasan Prishtina, duke bart vet Hafiz Ymeri funksione në Konunën e Talinocit (organizim i atëherësh i vendbanimeve), e cila nismë kishte ndikuar që përveç bursojes edhe t'i ndalohet nga ana pushtuesit

bullgare, bartja e funksioneve zyrtare në Komunën e Talinocit!



Also from this period are a number of little known Moslem poets of whom only a few oems have survived. Among them are: **Dervish Veseli** (1887-1950) of Rahovec, who travellec ridely in the Middle East and was killed accidentally at the Great Sa'di *teke* of Gjakovë in 1950 **lafiz Imer Shemsiu** (1893-1945), imam of Talinovc, who opened an Albanian-languag lementary school in Sazli-Talinovc and of whose estimated thirty religious poems we have bu ıree; **Dervish Idrizi**, a blacksmith from Gjakovë and author of one poem dated 1908; educato **'aik Maloku** (1900-1935), also known as *Faik efendi* of Prishtinë, and **Sheh Osmoni** of Junik f whom we have two poems each; and **Hafiz Islami** (ca. 1910 - ca. 1934), pseudonym of Islan Mehmet Bytyqi, from the village of Mllanaviq i Llapushës, who after religious studies ir ijakovë under Fahri Efendiu died young while performing military service in Slovenia. A ertain **Sheh Ahmedi** of Shkodër, a dervish of the Rufai sect, was also little known until recently

Figura 19: Nga libri i Robert Elsie The Currents of Moslem and Bektashi Writing in Albania (1850-1950).

Shkolla Shqipe në Sazili - Talinoc

Megjithatë, Hafiz Ymeri nuk u ndal me këtë përpjekje. Në vitin 1934, ai hapi një shkollë tjetër - mejtep, këtë herë në fshatin Sazli për banorët e fshatrave Sazli Talinoc të Muhaxhirëve, Papaz, Softaj dhe Pojatë. Gjatë punimit të këtij libri kemi pas rast të takojmë një nga ish nxënsit e Hafiz Ymerit të kësaj shkolle Haxhi Nazim Maliqi nga Pojata. Kjo shkollë vazhdoi të funksiononte deri në vitin 1941, kur hapja e shkollave publike formale në të gjitha trojet shqiptare filloi me një sistem dhe program unik. Në lidhje me këtë përpjekje të tij të jashtëzakonshme për të përhapur arsimin shqip, thuhet se "Ai ishte mësues edhe

me veprën e tij letrare e kombëtare. Punoi me nxënësit e tij dhe me të rriturit për mësimin e shkrim-leximit në gjuhën shqipe me alfabetin latin të vendosur në Kongresin e Manastirit" **(**Kraja, 2016**).**

Shkolla - mejtepi i parë në Sazli ishte i vendosur në vendin ku sot gjendet xhamia e fshatit, dhe rruga që kalon përmes fshatit mban emrin e Hafiz Ymerit, si një nderim për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për arsimin shqiptar. Për këtë përpjekje arsimore të Hafiz Ymerit, shumë studiues shqiptarë dhe të huaj kanë shkruar në mënyrë të detajuar. Ndër të tjerë, autorët ferizajas Qemal Retkoceri dhe Ruzhdi Marevci në librin e tyre "Shkollat në Komunën e Ferizajt" vënë theksin në rolin e tij të rëndësishëm, duke shkruar: "Hafiz Ymeri ua mësonte shkrim-leximin nxënësve edhe në gjuhën shqipe. Kuptohet, ky veprim ishte i ndaluar nga sistemi atëhershëm" **(**Retkoceri dhe Marevci, 2007**).**

Shkolla e themeluar nga Hafiz Ymeri në vitin 1915 në Sazli njihet historikisht si shkolla e parë shqipe në Ferizaj, e ripahur në objekt të ri në vitin 1934, duke vijuar mësimdhënien në gjuhën shqipe dhe lëndë të ndryshme nga shkencat natyrore, shoqërore, gjuhësore dhe artet. Shkolla e dytë vazhdoi të funksiononte deri në vitin 1941, kohë kur filluan të hapeshin shkolla të reja në Ferizaj, duke çuar drejt organizimit të rregullt të arsimit në këtë rajon.

Figura 20: Aty ku ka ekzistuar shkolla shqipe - mejtpi i Hafiz Ymerit, tani është xhami e fshatit Sazli. Në fotografi shihet emërtimi i kësaj rruge me emrin e Hafiz Ymerit!

Nxënësit e Hafiz Ymerit përbënin një burim të rëndësishëm për mësimdhënësit e shqipes në Ferizaj dhe për ata që zinin pozita në administratën publike të kohës. Hafiz Ymeri u përmend për kontributin e tij edhe nga studiuesit si Dr.Muhamet Pirraku dhe Prof. Dr. Hajrullah Koliqi në librin "Historia e arsimit pedagogjik shqiptar", ku thuhet: "Hafiz Shemsedni bashkëpunoi me Mulla Rexhep Krasniqin, me mësuesin shëtitës Vesel Pagarusha, me Mulla Rexhep Shalën etj., në disa drejtime të dobishme atdhetare e mes tjerash për gjuhën shqipe" **(**Koliqi, 2002**).**

Hapja e këtyre shkollave në Sazli për qytetarët përreth u përmend edhe në librin "Poezia e Bejtexhinjve", botuar nga Rilindja në vitin 1987, ku thuhet: "Në kohën e Luftës së Parë Botërore ka punuar si nëpunës në Talinovc, kur

edhe bëri punë më të madhe për hapjen e një shkolle në gjuhën shqipe në Sazli – Talinovc, e cila u mbyll shpejt prej bullgarëve" **(**Salihu, 1987**).**

Në të dyja shkollat – mejtepet që Hafiz Ymeri hapi dhe ku ai mësoi, përdori dy sisteme të shkrimit për shqipen: shkrimin arab dhe shkrimin latin. Siç theksohet nga Ramiz Zekaj**,** "Hfz. Ymer Shemsedini në të dy mejtepet që mbajti mësim në Kosovë, përdori dy sisteme të shkrimit për shqipen, shkrimin arab dhe shkrimin latin, i pari për lëndët mësimore fetare, kurse i dyti për lëndët shoqërore dhe ekzakte" **(**Zekaj, 2007**).** Edhe studuesit ferizajas Tefik Ajvazi përmend për Hafiz Ymerin ‘’Profesor Ymer ... me përgatitje fetare ishte dhe atdhetar i njohur, sepse shumë mësime i mbante edhe në gjuhën shqipe’’(Ajvazi – Mjeku, 2025).

Këto përpjekje të mëdha për arsmimin e rinisë shqiptare përbëjnë një nga kontributet më të rëndësishme të Hafiz Ymerit, i cili u bë simbol i ruajtjes së gjuhës dhe kulturës kombëtare në një

Studiuesit e huaj për shkollat e Hafiz Ymerit

Rëndësia e shkollave të themeluara nga Hafiz Ymeri ka tërhequr vëmendjen e studiuesve të huaj, të cilët e kanë përmendur atë në punimet e tyre shkencore. Robert Elsie, studiues i njohur gjerman me origjinë kanadeze, i

specializuar në letërsinë dhe folklorin shqiptar, e përmend Hafiz Ymerin si një figurë të rëndësishme arsimore: "Hafiz Ymeri Shemsiu (1893-1945), Imam i Talinovc, i cili hapi një shkollë fillore në gjuhën shqipe në Sazli-Talinovc" **(**Elsie, 1994**).** Ky citim tregon rëndësinë e Hafiz Ymerit si një figurë kyçe në arsimimin e shqiptarëve gjatë një periudhe të vështirë.

Studiuesi tjetër i huaj, Harry Norris, në librin e tij "Islami në Ballkan; shoqëri dhe fe mes botës Arabe dhe Europiane", përmend kontributin e Hafiz Ymerit për hapjen e shkollës në Sazli, si dhe për veprimtarinë e tij letrare në gjuhën shqipe. Norris shprehet për këtë periudhë: "Hafiz Ymeri hapi një shkollë shqipe në Sazli dhe ishte një ndër poetët e parë shqiptarë që shkroi poezi në shqip" **(**Norris, 1993**).**

Për shkak të përkushtimit të tij për zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe, Hafiz Ymer Shemsiu fitoi epitetin "Bard i Kosovës". Ky titull i është dhënë nga studiues shqiptarë për shkak të kontributit të tij në ruajtjen dhe përhapjen e kulturës dhe gjuhës shqipe në periudha të vështira historike. Siç përmendet në literaturë: "Bardi i Kosovës e sfidoi policinë serbe duke u mësuar shqip nxënësve dhe popullit, duke shkruar shqip dhe duke shtypur shqip" **(**Zekaj, 2012**).**

Këto citime nga studiues të ndryshëm theksojnë jo vetëm përkushtimin e Hafiz Ymerit ndaj arsimit shqiptar, por edhe rolin e tij si figurë kulturore dhe kombëtare në

mbrojtjen e identitetit dhe gjuhës shqipe në periudha të vështira për shqiptarët e Kosovës.

Hartimi i kurrikulave dhe syllabusëve nga Hafiz Ymeri

Hafiz Ymeri, intelektuali i njohur ferizajas, përmes njohurive të tij të thella në gjuhë të huaja dhe kontaktit me kultura të ndryshme, si ato të Lindjes ashtu edhe të Perëndimit, zhvilloi një qasje inovative ndaj arsimit. Ai jo vetëm që kishte njohuri mbi rëndësinë e mësimit të gjuhës shqipe, por gjithashtu ishte i përkushtuar për ta bërë këtë mësim të organizuar dhe të strukturuar sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar. Hafizi, përmes përvojës së tij të gjerë, hartonte programet dhe planifikimet mësimore në një mënyrë që përkonte me standardet moderne të arsimit, duke përfshirë edhe elementet e një kolegji të mirëstrukturuar.

Studiuesi Pirraku (1992) thekson rolin thelbësor të Hafiz Ymerit në këtë drejtim, duke thënë se ai "shkroi tekste doracakë shkollorë në frymën e leksioneve, të ligjëratave të lidhura harmonikisht, të dedikuara një qëllimi, një problemi mësimor-edukativ. Këto ishin shkrime ilegale, ku në mënyrë diskrete e kultivonte mësimin shqip, gjuhën shqipe" **(**Pirraku, 1992**).**

Vizionarizmi pedagogjik i Hafiz Ymerit

Hafiz Ymeri, si një vizionar, kuptoi rëndësinë e metodologjisë së mësimdhënies, një fushë që edhe sot

kërkon përmirësime të vazhdueshme. Ndërsa shumë mësimdhënës sot mund të kenë njohuri të thelluara për përmbajtjen lëndore, ata shpesh mund të mos zotërojnë aftësi dhe njohuri nga fusha e metodologjisë dhe pedagogjisë. Hafiz Ymeri kishte përfituar njohuri edhe në këto disiplina, duke e bërë atë një pionier në këtë aspekt. Duke u bazuar në traditën islame të mësimdhënies, ai e lidhi aktivitetin e tij pedagogjik me shembullin e Profetit Muhammed (a.s.), i cili pati një funksion themelor si mësues i njerëzimit. Siç thuhet në një hadith të Profetit: "Unë jam dërguar si mësues" **(**Ibn Maxhe**).**

Në një botë ku metodologjia e mësimdhënies si disiplinë shkencore filloi të formësohej më vonë, Hafiz Ymeri u ndikua nga dijetarët myslimanë që kishin kontribuar në zhvillimin e kësaj fushe që në periudha të hershme. Një nga dijetarët më të hershëm që ka shkruar për metodologjinë e mësimdhënies ishte Bruhand ad-Din El-Islam Az-Zurunxhi, i cili në vitet 1158–1223 shkroi librin "Instruksione studentëve: Metodat e të mësuarit" (Az-Zurunxhi, 1158-1223), ndërsa Ibn Halduni në veprën e tij të famshme "Mukaddime" (1377) kontribuoi në zhvillimin e metodologjisë së mësimdhënies si një disiplinë shkencore më vete. Ibn Halduni, i njohur si themeluesi i metodologjisë shkencore në shkencat shoqërore, thotë në veprën e tij: "Mësimdhënia është një zanat, sepse mjeshtëria e një shkence është rezultat i një zakoni që i mundëson poseduesit të saj të kuptojë të gjitha principet bazë të saj" **(**Ibn Haldun, 1377**).**

Ibn Halduni, gjithashtu, thekson rëndësinë e terminologjisë teknike në mësimdhënie, duke shtuar: "Çdo autoritet i famshëm ka terminologjinë e vet teknike për mësimdhënien shkencore... Kjo tregon se terminologjia teknike nuk është pjesë e zanatit në vetvete" (Ibn Haldun, 1377). Nga kjo trashëgimi kulturore dhe arsimore, Hafiz Ymeri ndërtoi një metodologji të përparuar për shkollat e tij, duke krijuar një sistem modern të arsimit që mbeti model për breza të tërë.

Dedikimi i Hafiz Ymerit për arsimin

Hafiz Ymeri ishte një njeri që nuk ishte i dhënë pas karrierës apo posteve të larta. Ai kryente me përkushtim punët pedagogjike në shkollat – mejtepet që ai vetë kishte themeluar, siç ishte rasti i shkollës në Sazli (1915) dhe më vonë në Talinoc (1934). Ai u përqendrua në edukimin dhe përhapjen e dijes në komunitetin e tij, duke mbajtur në qendër të mësimdhënies së tij gjuhën shqipe dhe shkencat shoqërore e ekzakte.

Siç vë në dukje studiuesi Mehmeti (2022), Hafiz Ymeri dhe autorë të tjerë të kohës së tij nga Ferizaj, si Vejsel Xhelaludin Guta, "ishin autorë të njohur veprash fetare, didaktike dhe atdhetare, disa prej të cilave të shkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab, në radhë të parë për nevoja të nxënësve dhe të studentëve, e pastaj edhe të masës së gjerë të komunitetit mysliman" (Mehmeti, 2022).

Sistem arsimor origjinal

Nëse analizohet në dritën e koncepteve bashkëkohore, është e vështirë të kuptohet përmasat e përpjekjeve të Hafiz Ymerit në themelimin e shkollave shqipe në Ferizaj. Ferizaj, për një periudhë të gjatë kohore, nuk kishte asnjë institucion që të mësonte shqip deri në hapjen e shkollës publike "Ismail Qemajli" (sot Tafik Çanga), e cila u themelua më 27 nëntor 1941 me vendim të ministrit shqiptar Ernest Koliqi. Kjo shkollë u hap plot 26 vite pas asaj që Hafiz Ymeri kishte ngritur në fshatin Sazli.

Sipas studiuesit Pirraku (1992), Hafiz Ymeri "i mbante mësimet paralelisht, duke angazhuar nxënësit e klasave të larta në mësim me klasat e ulëta dhe veçantë në ushtrime, ato që sot njihen si mësimdhënës asistent." Pirraku vëren se "kjo metodë ishte e njohur në mejtepet dhe medresetë e Kosovës, por veçanërisht e zbatonte Mulla Vesel Guta në Mejtepin e Vojnocit" (Pirraku, 1992).

Programi shkollor në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja

Në shkollat e themeluara nga Hafiz Ymeri, në të dy mejtepet ku ai jepte mësim, përdorej alfabeti shqip, ndërsa alfabeti arab përdorej vetëm për mësimin e Kuranit në origjinal, siç ndodh edhe sot në shumë vende të botës islame. Në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, në këto shkolla, përkraheshin dy sisteme shkrimi për shqipen: shkrimi arab për lëndët fetare dhe

shkrimi latin për lëndët shoqërore. Kjo e dyta zhvillohej në mënyrë të fshehtë, duke përfituar nga ombrella e shkollës fetare **(**Kraja, 2016**).**

Studiuesi Ramiz Zekaj (2007) thekson një aspekt tjetër të rëndësishëm të veprimtarisë së Hafiz Ymerit: "Një aspekt tjetër i veprimtarisë së Hfz. Ymer Shemsiut është edhe organizimi i mësimit të gjuhës shqipe fshehurazi. Në xhaminë e Talimocit, ku shërbente si imam i saj, ngriti Komitetin e Kosovës. Në këtë kohë ai jepte mësimin e gjuhës shqipe fshehurazi dhe, në të njëjtën kohë, mbante dhe mejtepin. Mësimin, në lokalin e ngritur nga vetë populli, e vazhdoi që nga viti 1934 deri me 1941. Në këtë mejtep, Hfz. Ymeri zhvilloi një punë pedagogjike përtej programit që zhvillohej në mejtep. Përveç shkrim-leximit në gjuhët orientale, ai u mësoi nxënësve dhe shkrim-lexim në gjuhën amtare shqipe dhe i përgatiti ata me njohuri dhe aftësi të vlefshme për jetën e përditshme" (Zekaj, 2007).

Bashkëpunimi arsimor dhe ndikimi nacionalist

Mësimi i gjuhës shqipe në këtë periudhë depërtoi edhe në mejtepet dhe medresetë e tjera të Kosovës, veçanërisht ato që kishin lidhje tradicionale me Gjilanin si qendër arsimore. Sipas Pirrakut, mejtepi i Mulla Vejselit në Vojnoc të Shtimes dhe ai i Hafiz Ymerit në Sazli të Ferizajt ishin dy shembuj të spikatur të këtij bashkëpunimi. "Mejtepet e tyre, realisht, ishin Seminare të Nacionalizmit Përparimtar Shqiptar, ishin Kurse të Ballit Kombëtar

qysh nga shtatori i vitit 1939" **(**Pirraku, 1995/2017**)**. Këta mualimë të vjetër, si Hafiz Ymeri dhe Mulla Vejseli, bashkëpunuan ngushtë për të përçuar jo vetëm mësimin fetar, por edhe idetë e nacionalizmit dhe edukimin në gjuhën shqipe, duke formuar një brez të ri të edukuar në frymën kombëtare dhe përparimtare.

Kurrikula e gjerë dhe bashkëkohore

Shkenca ekzakte dhe shoqërore

Mësimdhënia e organizuar në "mejtepin" e Hafiz Ymerit përfshinte një spektër të gjerë njohurish që tërhiqte paralele me edukimin modern. Përmes lidhjeve të tij personale dhe profesionale me shqiptarët e Shkupit, Hafiz Ymeri siguronte materiale shkollore dhe literaturën e nevojshme për zhvillimin e kurrikulave që përfshinin lëndë si gjuhë shqipe, letërsi, shkenca ekzakte dhe shoqërore.

Në "mejtepin" e Hafiz Ymerit, nxënësit mësonin lëndë të tilla si:

- Histori
- Gjeografi
- Matematikë
- Fizikë
- Artet e bukura
- Administratë publike

Përveç lëndëve akademike, ai u mësonte nxënësve edhe aftësi praktike që ishin të dobishme për jetën e përditshme dhe për zhvillimin e administratës publike. Shumë prej ish-nxënësve të tij, falë njohurive të fituara në shkollën e tij, u bënë mësimdhënës të gjuhës shqipe në Ferizaj, si dhe zyrtarë të administratës publike.

Sipas Mexhid Yvejsit (2010), "Hafiz Ymer Shemsiu, përveç veprimtarisë atdhetare-kombëtare-çlirimtare, është marrë edhe me veprimtari arsimore, pedagogjike, kulturore… Në mejtepin e tij, Hafiz Ymeri, përveç mësimeve fetare, ua mësonte nxënësve të tij, në fshehtësi, shkrim-leximin shqip, pastaj edhe njohuri të tjera si në histori, gjeografi, matematikë, fizikë, kështu, përgatiti kuadër të aftë edhe për administratë..." (Yvejsi, 2010). Edhe studuesi Ajvazi (2025) përmend faktin që Hafëz Ymeir ''në mejtep krahas mësimeve fetare i ka shpjeguar tema nga kultura e historia shqiptare'' (Ajvazi-Mjaku, 2025).

Përkrahja e dy sistemeve të shkrimit

Në mes të dy luftërave botërore, Hafiz Ymeri përdorte dy sisteme shkrimi për mësimin e gjuhës shqipe në mejtepet e tij: shkrimin arab për lëndët fetare dhe shkrimin latin për lëndët shoqërore. Kjo e fundit zhvillohej në fshehtësi, duke përfituar nga struktura e shkollës fetare. "Në

mejtepet ku jepte mësim Hafiz Ymeri, përkraheshin dy sistemet e shkrimit për shqipen: shkrimi arab për lëndët mësimore fetare dhe shkrimi latin për lëndët shoqërore, gjithnjë kjo e dyta zhvillohej ilegalisht, nën ombrellën e shkollës fetare" (Kraja, 1993).

Nxënës të të gjitha moshave

Nxënësit e Hafiz Ymerit përfshinin individë të të gjitha moshave, të rinj e të moshuar, që kërkonin të arsimoheshin në gjuhën amtare. Në atë periudhë, shkolla e tij përfaqësonte një qendër të ngritjes intelektuale në Ferizaj. Shumë nga ata që përfunduan arsimimin e tyre në këtë mejtep u bënë më vonë mësimdhënës, ose zënë poste të rëndësishme në administratën publike, duke dëshmuar vlerën e pazëvendësueshme të arsimit të fituar nën drejtimin e Hafiz Ymerit.

Artet e bukura si pjesë e kurrikulës

Hafiz Shemsedini ka hyrë me dinjitet në radhët e teologëve më të shquar shqiptarë në historinë e arsimit dhe të shkollës shqipe, duke kryer me përkushtim të veçantë jo vetëm detyrën fetare, por edhe atë atdhetare. Në kushte të jashtëzakonshme terrori dhe gjenocidi, ai u angazhua për mësimin e gjuhës shqipe, e cila u bë një simbol i etnisë dhe identitetit tonë kombëtar. Për më tepër, Hafiz Ymeri përdori artin muzikor kombëtar për të ngjallur emocione te nxënësit dhe te rriturit, duke konsoliduar ndjesitë dhe bindjet atdhetare te

bashkatdhetarët e tij. Kraja (2016) thekson: "duke përdorur me mjeshtëri edhe artin muzikor kombëtar, që ndikoi aq shumë në emocionet e nxënësve dhe të rriturve, në krijimin e konsolidimin e ndjesive, bindjeve atdhetare te bashkatdhetarët e vet."

Përgatitja e kuadrove për mësimdhënës dhe administratë publike

Institucionet arsimore të themeluara nga Hafiz Ymeri përfaqësonin një gjetje të pazëvendësueshme në mungesë të alternativave të tjera. Edhe nëse sot sistemi arsimor duket krejtësisht i ndryshëm, për shumë vite, shkollat e Hafiz Ymerit ishin qendra kryesore e edukimit. Hafiz Ymeri përgatiti kuadro për mësimdhënës dhe punonjës të administratës publike. Pirraku (1992) shkruan: "këto dy mejtepe ishin dy shkolla fetaro-kombëtare, të cilat përgatitnin kuadër për veprimtari fetare dhe administrative për vendin."

Yvejsi (2010) vlerëson gjithashtu përpjekjet e Hafiz Ymerit: "Hafiz Ymer Shemsiu, përveç veprimtarisë atdhetare-kombëtare-çlirimtare, është marrë edhe me veprimtari arsimore, pedagogjike, kulturore... Në mejtepin e tij, Hafiz Ymeri, përveç mësimeve fetare, ua mësonte nxënësve të tij, në fshehtësi, shkrim-leximin shqip, pastaj edhe njohuri të tjera si në histori, gjeografi, matematikë, fizikë, kështu, përgatiti kuadër të aftë edhe për administratë..."

Përshtatja e alfabetit me prurje shqipe

Një aspekt i rëndësishëm i punës së Hafiz Ymerit është përpjekja për përshtatjen e alfabetit për të shkruar shqipen, përpara unifikimit të tij në Kongresin e Manastirit. Ai përdori shkronjat e alfabetit osman për të shkruar shqipen, duke bërë disa plotësime për të shënuar zanoret. Pirraku (1992) përmend se "Hafiz Ymeri në alfabetin arabo-osman bëri disa plotësime për të shënuar zanoret: uu, ii, â, ô, c e të tjera. Me këtë grafi (rreth 1000 vargje) dedikuar, në rend të parë nxënësve, por edhe masave të gjera popullore."

Gjuha shqipe e përdorur nga Hafiz Ymeri ishte një gjuhë popullore dhe kuptueshme, me pak fjalë të huaja, kryesisht të ngritura në shkallë termash dhe nocionesh islame. Sipas Pirrakut (1992), "Hafiz Ymeri shkroi pa shumë filozofi, pa shumë mistikë, të drejtpërdrejtë dhe me poentë porositëse; të lehta për t'i kuptuar – sepse shkroi plotësisht në frymën e vargut popullor lirik dhe epik historik."

Edukimi i femrave

Trajtimi i femrës ka qenë një çështje tepër e ndjeshme në shoqërinë shqiptare, e ndikuar nga zakonet dhe ligjet e rrepta, siç ishte Kanuni, që shpesh i jepnin femrës një trajtim të pabarabartë. Megjithatë, prijësit fetarë myslimanë, të përgatitur thellësisht në teologji, ishin ndër të parët që luftuan për të përmirësuar statusin dhe

trajtimin e grave. Ky revolucion social për të drejtat e femrës nisi që në kohën e profetit Muhamed (a.s.), i cili i dha fund zakoneve të vjetra barbare që çonin në varrosjen e gjallë të vajzave.

Hafiz Ymeri ishte pjesë e këtij angazhimi për të luftuar mendësitë e mbrapshta ndaj femrës dhe për të promovuar edukimin e tyre. Ramiz Zekaj (2007) vëren se "Përbërja e nxënësve të mejtepeve, nga pikëpamja e gjinisë, zakonisht ishte e përzier (djem dhe vajza). Mosha e pranimit të nxënësve nuk ka qenë e fiksuar, por zakonisht ata pranoheshin nga mosha 6-7 vjeçare deri në moshën 14-16 vjeçare."

Përmes këtyre përpjekjeve, Hafiz Ymeri vendosi Ferizajn në hartën e intelektualëve të mëdhenj, duke ndikuar jo vetëm në arsimin dhe emancipimin e përgjithshëm, por edhe në avancimin e të drejtave dhe edukimit të femrave.

Mbyllja e shkollave shqipe nga pushtuesit ballkanik (serb dhe bullgar)

Në periudha të ndryshme historike, shkollimi në gjuhën shqipe është zhvilluar në kushte të ndryshme, fillimisht në xhami dhe mejtepe, ndërsa shkollimi në gjuhë të huaja realizohej në kisha dhe manastire. Kur rrethanat dhe struktura e arsimit ndryshuan, ishte e dukshme se pushtuesit ballkanikë shprehën një zell të veçantë për të penguar ngritjen intelektuale të shqiptarëve, duke u përpjekur të kufizonin përparimin e tyre në fushën e

edukimit dhe të ndikojnë në zhvillimin e tyre kulturor dhe kombëtar.

Për më shumë se pesëdhjetë vjet, bashkëqeverisja e komunistëve shqipfolës dhe serbëve në Kosovë dhe Ferizaj, në atë që ata e quajtën 'vllazin-bashkim', nuk solli ndonjë nismë të rëndësishme në këtë fushë. Përkundrazi, ka pasur një përpjekje të fuqishme për të ngarkuar çdo problem shqiptar me periudhën 'Otomane', duke përfshirë edhe bashkëqeverisjen e disa popujve ballkanikë dhe aziatikë, kryesisht turqit. Ky qasja ka qenë, ndoshta, një përpjekje për të vrarë dy zogj me një gur: të nxitej shqiptari kundër Turqisë (siç është ndodhur në dy momente të tjera historike), duke parë në të njëjtën kohë kërcënimin e pretendimeve territoriale të fqinjëve armiqësorë ballkanikë.

Në periudhën e Luftës së Parë Botërore, Ymer Shemsiu hapi një shkollë shqipe në fshatin Sazli. Megjithatë, shkolla pati një jetë të shkurtër. Siç përshkruan Ramiz Zakaj, "Pushtuesit bullgarë, kur hynë këtu, e mbyllën menjëherë këtë shkollë dhe mësuesin e saj shqiptar, Hafiz Ymerin, e lidhën me veriga dhe e burgosën në burgun e Ferizajt" (Zakaj, 2007). Hafiz Ymeri u burgos thjesht për shkak të përpjekjeve të tij për të mësuar shqip në Ferizaj. Është e qartë se territoret shqiptare në Kosovë, të administruara nga pushtues të tjerë, nuk ishin aq të rreptë në raport me mësimin e shqipes sa ishin bullgarët. Ndërsa projekti shkollor i Hafiz Ymerit kërkonte një nivel

të lartë dijnie, më shumë se gjithçka, kërkonte guxim të jashtëzakonshëm për të përballuar një situatë të tillë.

Për këto cilësi, studiusit e kanë quajtur Hfz. Ymer Shemsiun "Bard i Kosovës." "Bardi i Kosovës" sfidoi policinë serbe duke mësuar shqip nxënësve dhe popullit, duke shkruar dhe shtypur në shqip" (Zakaj, 2007). Pjesëmarrja e Hafiz Ymerit në këtë lëvizje edukative ishte një akt i jashtëzakonshëm që kontribuoi në ruajtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare nën kushte të vështira.

Hafiz Ymeri u përball me dhunën e pushtuesve bullgarë dhe përfundoi në burg pikërisht për shkak të përpjekjeve të tij për të ofruar edukim në gjuhën shqipe. Shkolla e tij u mbyll nga pushtuesit bullgarë dhe Hafiz Ymeri u burgos. Ndihma e Haxhi Pllanës ishte vendimtare për qëndrueshmërinë e Hafiz Ymerit dhe për evitimin e qëndrimit të tij të gjatë në burgun e Ferizajt.

Kapitulli VVV

Hafiz Ymeri 'Bardi i Kosovës' - Kontributi në art dhe kulturë

Arti, kultura, rekreacioni dhe religjioni!

Për të kuptuar thellësisht angazhimin e Hafiz Ymerit në art dhe kulturë, duhet të ndalemi në modelet dhe burimet e frymëzimit të tij. Si një hoxhë që ndiqte modelin e profetit Muhammed (paqja qoftë mbi të), Hafiz Ymeri i kushtoi vëmendje të veçantë jo vetëm fesë, por edhe kulturës, artit dhe rekreacionit, duke u përpjekur t'i përshtaste ato sipas standardeve më të larta njerëzore dhe fetare.

Arti dhe kultura kanë qenë gjithmonë një pjesë integrale e civilizimit islam. Ndryshe nga disa keqinterpretime të kohëve të fundit, Islami historikisht ka inkurajuar artin dhe rekreacionin, duke i parë ato si mjete për përmirësimin e qenies njerëzore. Në një thënie të famshme, profeti Muhammed ka përmendur: "Një orë për Zotin dhe një orë për veten," duke nënvizuar rëndësinë e balancës mes përkushtimit fetar dhe rekreacionit personal (Muslimi).

''Në kushte të ndalesave serbe të shkrimit shqip, të mësimit shqip fetar e kombëtar, të gjuhës shqipe në të gjitha veprimtaritë jetësore, me tendencës të ndalohej edhe në familje, vepra letrare e Hafiz Ymerit përfiton një peshë, në rëndësinë e saj historike. Këtë aktivitet poeti do ta zhvillojë në mënyrë disident e guerile, legale e kaçake, pa u frikësuar se mund t'i shkonte koka.

- Muhamed Pirraku, 1992

Kjo qasje e gjallë dhe gjithëpërfshirëse ndaj jetës, e frymëzuar nga parimet profetike, është ajo që Hafiz Ymeri e solli në veprimtarinë e tij. Ai krijoi një hapësirë

të artit dhe kulturës brenda një kuadri fetar, duke ndikuar te bashkatdhetarët e tij përmes muzikës dhe letërsisë, dhe duke kontribuar në ngritjen e një ndjeshmërie të lartë estetike dhe kombëtare.

Letërsia dhe Religjioni

Një nga dimensionet e rëndësishme të veprimtarisë së Hafiz Ymerit ishte lidhja e ngushtë mes letërsisë dhe fesë. Letërsia e tij ishte një përpjekje për të mbrojtur gjuhën dhe identitetin shqiptar në kushte të vështira represive. Kurani, si një burim frymëzimi për shumë prej poetëve dhe shkrimtarëve myslimanë, përmban një stil të lartë letrar. Siç thotë Kurani: "Betohem në penën dhe në atë çka shkruajnë" (Kur'an, Kalem: 1), duke vënë theksin mbi rëndësinë e shkrimit dhe krijimtarisë letrare.

Poezia dhe proza kanë qenë pjesë e rëndësishme e kulturës islame që nga koha e Profetit Muhammed. Profeti Muhammed a.s. thotë: *''Disa poezi përmbajnë urtësi...''*. Si shembull, Hasan bin Thabit, poeti i famshëm që mbronte profetin me vargje të fuqishme, u bë një model për poetët që e përdornin poezinë si një mjet për mbrojtjen e besimit dhe identitetit kombëtar. Në këtë linjë, Hafiz Ymeri u rreshtua në traditën e bejtexhinjve shqiptarë, të cilët shkruanin poezi dhe tekste fetare në shqip, duke përdorur alfabetet që ishin në dispozicion, si një mënyrë për të mbrojtur kulturën dhe gjuhën e tyre.

Hafiz Ymeri – Autori i parë i Ferizajt

Ferizaj u themelua si qytet relativisht vonë, në vitin 1873, por historia e këtij rajoni daton mijëra vite më parë, kur këtu banonte fisi i lashtë Dardan, pjesë e popullit ilir. Megjithëse hapësira e Ferizajt mund të ketë pasur autorë të tjerë që kanë shkruar më herët, është Hafiz Ymeri ai që është identifikuar si poeti dhe autori i parë i këtij rajoni, një figurë e cila la gjurmë të thella në kulturën dhe historinë letrare shqiptare.

Hafiz Ymeri është radhitur si autori i parë në veprën e Isa Baftiaj, Autorë nga rajoni i Ferizajt (1893-2016), e cila përfshin një periudhë të gjatë kohore prej më shumë se një shekulli. Kjo vepër përmban një listë të 168 autorëve që kanë kontribuar në fusha të ndryshme, përfshirë letërsinë artistike, sociologjinë, mjekësinë, publicistikën dhe folklorin. Në një recension të kësaj vepre, shkrimtari Kadriu (2018) thekson: "Përkushtimi i autorit shihet ngase ka prezantuar të gjithë autorët e këtij rajoni në një periudhe mbi një shekullore dhe atë duke i prezantuar të gjithë ata që lanë gjurmë në krijimtari, kush më shumë e kush më thellë duke ua prezantuar të gjitha veprat e botuara deri tash."

Në këtë përmbledhje, Hafiz Ymeri zë vendin e parë, duke u radhitur para figurave të tjera si Mulla Vesel Guta dhe të tjerë të rëndësishëm për historinë kulturore të Ferizajt. Isa Baftiaj (2017), në librin e tij Autorët e Ferizajt me

rrethinë, thekson: "Hafiz Ymeri ka shkruar shumë dhe ata që e mbajnë mend thonë se ai ka shkruar rreth tridhjetë poezi të gjata." (Baftiaj, 2017). Kjo e dhënë për krijimtarinë e Hafiz Ymerit përmendet edhe nga burime të tjera, duke përfshirë librin Poezia e Bejtexhinjve (Salihu, 1987), ku thuhet se poezitë e tij mund të numërohen rreth tridhjetë. Shumë nga këto poezi janë humbur, por mbetet bindja se Hafiz Ymeri ka shkruar shumë më tepër se ato që kemi sot në dorë.

Kontributi në Letërsinë Shqipe dhe trashëgimia e Hafiz Ymerit

Hafiz Ymeri mbetet një figurë qendrore në letërsinë fetare dhe kombëtare shqiptare. Edhe pse një pjesë e madhe e krijimtarisë së tij nuk ka mbijetuar, disa nga poezitë e tij janë përmbledhur në vepra të ndryshme si Poezia e Bejtexhinjve (1987) dhe Degë e këputur e Rizah Strellcit (1995). Gjithashtu, punimet e tij janë përmendur në botime akademike dhe revista, si në punimin e prof. Muhamed Pirrakut të botuar në revistën Dituria Islame (1992). Këto burime kanë mbajtur gjallë kujtesën për poezinë e tij, duke theksuar rëndësinë e tij për kulturën dhe letërsinë shqiptare.

Një aspekt interesant i krijimtarisë së Hafiz Ymerit është edhe përpjekja e tij për të përshtatur alfabetin arabo-osman për të shkruar shqip. Prof. Pirraku (1992) përmend se Hafiz Ymeri "në alfabetin arabo-osman bëri disa plotësime për të shënuar zanoret: uu, ii, â, ô, c e të tjera. Me këtë grafi (rreth 1000 vargje) dedikuar, në rend të parë

nxënësve, por edhe masave të gjera popullore." (Pirraku, 1992).

Njohja ndërkombëtare dhe studimet mbi Hafiz Ymerin

Kontributi i Hafiz Ymerit në poezinë dhe kulturën shqiptare është vlerësuar edhe nga studiues ndërkombëtarë. Robert Elsie (1994), studiues gjerman me origjinë kanadeze i cili u fokusua në studimet mbi kulturën dhe letërsinë shqiptare, përmend: "Hafiz Ymeri Shemsiu (1893-1945), Imam i Talinovcit, i cili hapi një shkollë fillore në gjuhën shqipe në Sazli-Talinovc" dhe shkroi "tridhjetë poema fetare të të cilave kemi vetëm tre" (Elsie, 1994). Gjithashtu, Harry T. Norris, në librin e tij Islami në Ballkan: Shoqëri dhe fe mes botës Arabe dhe Europiane (1993), përmend krijimtarinë poetike të Hafiz Ymerit dhe kontributin e tij në letërsinë shqipe, duke vënë theksin në "sasien e poezive të shkruara në shqip nga ky poet." (Norris, 1993).

Njohja ndërkombëtare për Hafiz Ymerin përfshin gjithashtu edhe një studim të detajuar nga profesori turk Dr. Bünyamin Çağlayan, i cili e përmend atë si një nga poetët më të shquar të shekullit XX. Ky vlerësim tregon për rëndësinë e Hafiz Ymerit jo vetëm në letërsinë shqiptare, por edhe në kontekstin më të gjerë të kulturës dhe poezisë islame në Ballkan.

Hafiz Ymeri mbetet një figurë monumentale në historinë kulturore të Ferizajt dhe të letërsisë shqiptare. Si poeti i

parë i njohur nga ky rajon, ai jo vetëm që kontribuoi në zhvillimin e letërsisë shqiptare, por gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare në kohë të vështira historike. Krijimtaria e tij, ndonëse pjesërisht e humbur, vazhdon të frymëzojë studime dhe hulumtime mbi historinë e letrave shqipe.

Autor i veprës më e mirë letrare në mes dy luftërave botërore – poemës 'Nazim Gafurri'!

Hafiz Ymeri mbetet një nga figurat më të njohura të kulturës shqiptare, i cili me veprat e tij la gjurmë të pashlyeshme në historinë letrare të Kosovës. Ai shquhej për një integrim të rrallë të njohurive fetare, atdhetare dhe kulturore. Një nga kryeveprat e tij letrare është poema "Nazim Gafurri", që cilësohet si një nga veprat më të njohura letraro-historike të kohës midis dy luftërave botërore.

Sipas Kraja (1993), "Vepra e tij, poema 'Nazim Gafurri', është nga më të njohurat krijime letrare-historiografike në Kosovën e mes dy luftërave botërore". Edhe studiuesi Zekaj (2012) veçon këtë krijim si një nga kryeveprat e Hafiz Ymerit, duke vlerësuar ndikimin e saj: "Hafiz Ymeri kishte shkruar poezi e krijime të tjera letrare për shumë heronj shqiptarë, por nga krijimtaria e tij spikat poema 'Nazim Gafurri'".

Vlera historike dhe letraro-estetike e poemës

Poema "Nazim Gafurri" është një vepër që dokumenton dhunën dhe padrejtësitë e kryera ndaj shqiptarëve në Kosovë, veçanërisht gjatë periudhës 1912–1928. Muhamet Pirraku (1992) e përshkruan këtë krijim si "vepra letrare historike më e rëndësishme në literaturën dhe në trashëgiminë letrare historiografike shqiptare të Kosovës midis dy Luftërave Botërore, e shkruar në shqip në gjuhën e popullit". Ajo ofron një panoramë të gjenocidit serb mbi popullin shqiptar në këtë periudhë, duke përdorur vargje të thjeshta, por me një mesazh të fuqishëm dhe domethënës.

Kush ishte Nazim Gafurri?

Nazim Gafurri, si një veprimtar politik dhe patriot shqiptar, luajti një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave kombëtare të shqiptarëve. Ai ishte një deputet në Parlamentin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, dhe veprimtaria e tij u shqua për guximin dhe përkushtimin ndaj popullit shqiptar. Në një nga thëniet e tij, Gafurri u shpreh me vendosmëri: "Armiqtë nuk do të arrijnë të më vrasin: e para, para se ta hap shkollën shqipe, e dyta, i kam shtruar vetes për detyrë të bëhem kurban i popullit tim, lirisë dhe bashkimit demokratik" (Pirraku, 2022).

Sipas Pirrakut (2022), figura e Gafurrit qëndron përkrah heronjve të mëdhenj shqiptarë si Myderriz Ymer Prizreni dhe Hasan Prishtina, për guximin dhe vendosmërinë e tij

në përpjekjet për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve. Ai gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm në ndërkombëtarizimin e krimeve serbe, si Masakra e Gallapit në vitin 1921.

Hafiz Ymeri, me poemën "Nazim Gafurri", arriti të ndërthurë mjeshtërisht letërsinë dhe historinë, duke dhënë një dokumentacion të pasur dhe emocional për periudhën tragjike të gjenocidit serb ndaj shqiptarëve. Kjo vepër mbetet një dëshmi e përjetshme e dhimbjes dhe krenarisë shqiptare, duke i dhënë një zë të fuqishëm popullit të shtypur dhe duke forcuar ndërgjegjen kombëtare në një periudhë të errët të historisë sonë.

Analiza e poemës "Nazim Gafurri" e Hafiz Ymerit

Poema "Nazim Gafurri" e Hafiz Ymerit është një nga veprat më të rëndësishme në letërsinë shqiptare të Kosovës, shkruar gjatë periudhës midis dy Luftërave Botërore. Ajo përfaqëson një dokument historik të rëndësishëm për krimet dhe gjenocidin serb ndaj shqiptarëve, duke sjellë një perspektivë të fuqishme letraro-historiografike. Gjatë kohës kur Nazim Gafurri vepronte për ndërkombëtarizimin e krimeve serbe, vrasja e tij nga serbët synonte të shuante një zë të fuqishëm, por përkundrazi, ajo e përjetësoi figurën e tij. Hafiz Ymeri, përmes kësaj poezie, arriti të japë një dimension të ri historik dhe emocional, duke e bërë Nazim Gafurrin një simbol të përjetshëm të qëndresës shqiptare.

Sipas Pirrakut (1992), "Poetin Bard (Hafiz Ymeri) do ta bëjë të njohur edhe të pakrahasueshëm më të tjerët poema 'Nazmi Gafurri', e shkruar para vitit 1930". Kjo vepër përbëhet nga 454 vargje tetërrokëshe me ndërhyrje të gjashtë, shtatë dhe nëntërrokëshit, duke e përkryer në formë dhe ritëm për një narrativë epike. Variantin më të hershëm të kësaj poezie e kemi të shënuar nga rapsodi dhe poeti Riza Strellci (1904–1947) përpara vitit 1938, e botuar më vonë në vitin 1995 në veprën "Degë e këputur" (Pirraku, 1992).

Struktura dhe forma e poemës

Struktura tetërrokëshe e poemës e bën atë lehtësisht të përshtatshme për recitim dhe përçim të mesazhit te masat popullore. Tetërrokëshi, që përdoret në këngët popullore, krijon një lidhje të drejtpërdrejtë me folklorin shqiptar, duke e bërë poezinë të ngulitet thellë në shpirtin e dëgjuesve. Duke përfshirë figurat e trimërisë dhe vuajtjes shqiptare, poema arrin të krijojë një lidhje emocionale të fuqishme, që nxit atdhedashurinë dhe frymën e rezistencës.

Hafiz Ymeri përdor figura letrare për të shpërfaqur realitetin e dhunshëm të kohës, duke e kthyer çdo varg në një dëshmi të drejtpërdrejtë të gjenocidit serb. Përshkrimi i vuajtjeve dhe krimeve është një element qendror i poemës, duke u bazuar në ngjarje reale që nga Masakra e Gallapit deri te ngjarjet e tjera të viteve 1912–1928.

Vlerat letraro-historike

Prof. Pirraku (1992) thekson se "kjo vepër madhore letrare e historiografike ka 454 vargje tetërrokëshe, ku çdo varg është një argument ose sintezë argumentesh, së paku një tezë për një studim". Poema paraqet një kronikë letrare, duke përdorur fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta që përshkruajnë mizoritë serbe dhe qëndresën shqiptare. Si një tekst historiografik, ajo ka vlera të mëdha dokumentare, duke ofruar një dëshmi të fuqishme për periudhën më të errët të historisë shqiptare.

Poezia fillon me një përshkrim të mbërritjes së serbëve në Kosovë, duke e shpërfaqur dhunën e tyre me një fuqi emocionale përmes vargjeve të para:

"Kur na erdh e para Serbi
Q'na ngushton ket t'zezë Shqipni
Ka tridhet n'ptare ka shti
Ka dridhet poj shtjen n'patare
Don Shqiptarët mej qit fare"
(Pirraku, 1992).

Këto vargje krijojnë një atmosferë tmerri dhe pasigurie, ku gjenocidi bëhet një mjet i përditshëm i sundimit serb mbi shqiptarët.

Mesazhi patriotik dhe vlera emocionale

Poema jo vetëm që përshkruan mizoritë serbe, por edhe vë në pah heroizmin e Nazim Gafurrit dhe të bashkëluftëtarëve të tij. Gafurri ishte një figurë simbolike e sakrificës dhe përkushtimit për kombin shqiptar, dhe përmes fjalëve të tij, Hafiz Ymeri e kthen atë në një model të qëndresës dhe rezistencës.

Prof. Pirraku (1992) shton se "Nazim Gafurri shkriu pasuri përrallore dhe fali jetën e vet për lirinë e Kosovës, për bashkimin e Shqipërisë së copëtuar nga Evropa". Kjo frymë vetëflijimi dhe sakrifice reflektohet qartë në vargjet e fundit të poemës, ku shfaqet përmendorja e Gafurrit:

"Nona e vet çka ka marue,
Gurin e vorrit ja paska shkrue
Dëshmor Nazimin ma ka kallxue,
Po le t'dihet për çka ka shkue,
E me flori e ka flakure,
Se kus se për vëllazni
I shkruet e mri n'histori
Edhe flakohet me flori"
(Pirraku, 1992).

Poema si himn i rezistencës shqiptare

Vepra e Hafiz Ymerit arrin të bashkojë elementet historike, poetike dhe muzikore në një krijim të vetëm, duke u bërë një himn i fuqishëm i rezistencës shqiptare.

Në kontekstin e zhvillimeve kulturore dhe politike të kohës, kjo poemë i jep jehonë jo vetëm figurës së Gafurrit, por edhe vetë autorit, Hafiz Ymerit, duke e kthyer atë në një ndër krijuesit më të shquar të asaj periudhe.

Prof. Kraja (2016) e cilëson këtë poemë si një vepër që **"**ndikon në emocionet e dëgjuesve të shumtë, të cilat ndikonin dukshëm në ndjenjat e tyre atdhedashëse, në zgjimin dhe konsolidimin e tyre**"**. Ajo i jep zë vuajtjeve të popullit shqiptar, duke ndërtuar një narrativë që pasqyron dhimbjen dhe shpresën për liri.

Analiza e poezive të Hafiz Ymerit

"Atdheu i dashtun"

Poezia "Atdheu i dashtun", e gjetur në përmbledhjen e Rizah Strellcit të botuar nga familjarët e tij në vitin 1995, është një nga krijimet më të ndjeshme të Hafiz Ymerit. Rizah Strellci në hyrje të tekstit thekson: "Për dashurinë e Atdheut të dashtun dhe të lirisë kombëtare; e bame kjo vjershë prej Hafuz Imer Shemsit nga Sazlija dhe e përmirësuese kapak ku asht nevoja prej meje" (Strellci, 1995). Ky fakt tregon që poezia kishte një rëndësi të veçantë për të, përmirësuar dhe ruajtur ndër breza.

Poezia kap një nivel të thellë emocional dhe përshkon ndjenjat e dashurisë për atdheun dhe lirinë. Ajo përshkruan një kohë kur kufijtë midis jetës fetare dhe sekulare nuk ishin aq të ngarkuara sa sot, dhe Hafiz

Ymeri përdor gjuhën e kohës për të përçuar një mesazh që mund të mos kuptohej menjëherë nga të gjithë.

Poezia fillon me vargjet:

"Në erë të miskut, lulet lagshtue,
Afër duket lindja e diellit tonë,
Mora pendën hartim me shkrue,
Dashurinë e bahqes tonë."
(Strellci, 1995).

Figura letrare **"**lindja e diellit tonë" simbolizon një dritë të re për atdheun dhe shpresën për ndryshim dhe liri, ndërsa **"**bahqja jonë**"** është një metaforë për atdheun. Ky pasqyrim i thjeshtë dhe i ndjeshëm ngjall ndjenja të fuqishme patriotizmi.

Poezia vazhdon me një përshkrim të ndjesive të shpresës dhe rigjallërimit, ku vargjet:

"Tash ka çelë lulja jorgovan,
Do t'vjen koha për ne me u gëzue,
Të gjithë arshikëve erë me u dhanë,
Për rreth sa me u bashkue."
(Strellci, 1995).

Këto vargje nënkuptojnë ardhjen e një kohe të re për shqiptarët, një rilindje për të cilën Hafiz Ymeri shpresonte dhe për të cilën kontribuoi.

"Bylbyl i vetëm" (Garib Bylbyl)

Poezia **"**Garib Bylbyl**"** ose **"**Bylbyl i vetëm**"** është një nga krijimet më të njohura të Hafiz Ymerit, e shkruar në 23 vargje. Duke qenë një shqipe letrare me një nivel të lartë, kjo poezi është karakterizuar nga vargu tetërrokësh, duke reflektuar një dashuri të thellë për lirinë dhe Shqipërinë e copëtuar.

Poezia fillon me vargjet:

"Garib bylbyl n'kafaz knon,
Ah! Knimi tina vaj kallxon.
Jesirin hiç s'e don,
N'rrem t'therrës don me kon,
Shqipnia jon 'prëget n'honë
Çyfaria dill ka nxonë."
(Pirraku, 1992).

Në këtë poezi, Hafiz Ymeri përdor metaforën e bylbylit të vetëm për të përshkruar situatën e Shqipërisë, një vend që ka mbetur i izoluar dhe i lënë në errësirë. Bylbyli simbolizon Shqipërinë dhe popullin shqiptar, të cilët po përjetonin izolimin dhe shtypjen nga forcat jugosllave dhe ndërkombëtare.

Sipas prof. Pirrakut (1992),"Poeti duke qëlluar mbi pushtuesin vajtonte për Shqipërinë e formuar vetëm mbi një pjesë të vogël të S

hqipërisë etnike, dhe veçantë stigmatizonte propagandën jugosllave...". Hafiz Ymeri, përmes kësaj poezie, ngre zërin kundër padrejtësive dhe ndarjes që i është bërë Shqipërisë dhe popullit të saj.

Simbolizmi dhe përshkrimi i ndjenjave të mërzisë dhe izolimit të shqiptarëve janë të fuqishme, duke reflektuar dhimbjen dhe mërzinë e poetit për gjendjen e vendit të tij.

Vlerat e larta artistike

Një nga veçoritë më të rëndësishme të poezisë së Hafiz Ymerit është përdorimi i figurave letrare dhe ndërtimi i vargut që përçon emocione të thella dhe ndjenja patriotike. Poezia "Bylbyl i vetëm" është një shembull i shkëlqyer i kësaj. Hafiz Ymeri përshkruan zjarrin liridashës që e digjte, duke mos mundur të besojë se fati i Shqipërisë ishte shkruar nga Zoti në mënyrë kaq të padrejtë:

"Nxomja jote ah moj honë!
Krejt Shqipnin n'ter e ka lonë.
Athu Zoti n'tagdir t'vet
T'fshefi prej nesh
-N'vransi t'zezë...?!"
(Pirraku, 1992).

Poezia mbyllet me shpresën për rilindje dhe dritën e lirisë që do të vijë për shqiptarët, për të cilën poeti besonte se do të sjellë gjaku i dëshmorëve:

"Texheli nasib me kon
Qajo rreze n'bahqe ton
Terih n'guri na dojm me shkru
Shokt mas nesh mos me i harru!"
(Pirraku, 1992).

Këto vargje janë një përshkrim poetik i përjetësimit të kujtimit të dëshmorëve që luftuan për lirinë e atdheut.

Analiza dhe vlerësimi

Analiza e poezive të Hafiz Ymerit tregon një artist të madh, i cili përmes vargjeve të tij arrin të përçojë ndjenja të thella patriotike, shpresë dhe dhimbje për popullin dhe atdheun e tij. Si në **"**Atdheu i dashtun**"**, ashtu edhe në **"**Bylbyl i vetëm**"**, Hafiz Ymeri shpreh dashurinë dhe përkushtimin e tij për lirinë dhe pavarësinë e shqiptarëve. Figuracioni i pasur, përdorimi i metaforave dhe simbolikës, si dhe ndërtimi letrar i këtyre poezive e bëjnë krijimtarinë e tij të pavdekshme.

Prof. Pirraku (1992) thekson rëndësinë e analizës së veprave letrare të Hafiz Ymerit, duke sugjeruar që ato duhet të analizohen në detaj, si një trashëgimi letrare e pasur dhe e vlefshme për shqiptarët.

Muzika rapsodike

Shumë nga krijimtaria patriotike e Hafiz Ymerit, e cila motivonte dhe mbante gjallë ndjenjën kombëtare

gjithandej në Kosovë, ishte e ndërlidhur me artin rapsodik. Krijimet e tij, poezi dhe tekste këngësh me motive kombëtare, fetare dhe shpirtërore, shpesh herë këndoheshin pa u njohur gjithmonë autorësia e tij. Studiuesit përmendin një numër prej rreth tridhjetë krijimesh letrare të tij, të cilat kapin tema që variojnë nga etika njerëzore deri te çështja kombëtare shqiptare.

Rizah Strellci, një nga rapsodët më të shquar të kohës, ishte një nga interpretuesit kryesorë të këngëve të Hafiz Ymerit. Në librin **"**Degë e këputur**"**, përzgjedhur nga Halil Kajtazi, janë përmbledhur disa poezi dhe tekste këngësh të Hafiz Ymerit. Aty përfshihen krijime që flasin për heronjtë e kombit dhe betejat e tyre, të kënduara nga Hafiz Ymeri me çifteli dhe të përshkruara nga lëvizje valltare karakteristike shqiptare. Sipas Zekajt (2012**)**, Hafiz Ymeri ishte një artist që jo vetëm shkruante, por edhe interpretonte këngët e tij me ndjenjë dhe përkushtim.

Një nga tekstet më të rëndësishme që Rizah Strellci ka interpretuar, i titulluar **"**Qyr Hafuz që rri në Sazli**"**, përmban vargjet:

"Qyr Hafuz që rrin në Sazli,
Ti qi më konke kombëtare,
Po gjithnji më rrin ndër sy,
Po ban vjersha me do fjalë."
(Strellci, 1938).

Strellci e përshkruan Hafiz Ymerin si një njeri që i kushton jetën dhe talentin e tij mbrojtjes së gjuhës dhe rinisë shqiptare. Vargjet reflektojnë admirimin e tij për angazhimin kombëtar të Hafiz Ymerit, veçanërisht për ruajtjen dhe forcimin e gjuhës shqipe.

"T'falem nderës Hafuz i jonë,
Gjithë rinisë i ke ndihmue,
Gjithë kur folshim për gjuhë tonë,
Fjalët tona i ke forcue."
(Strellci, 1938).

Në këtë poezi, Hafiz Ymeri shfaqet si një lider me ndikim, që punonte për të ndriçuar mendjet e rinisë shqiptare. Ai ishte një modernist që përfaqësonte një urë mes traditave fetare dhe modernizmit kulturor.

Kënga për Ramë Bllacën

Një tjetër kryevepër e krijimtarisë së Hafiz Ymerit është kënga e tij për Ramë Bllacën, veprimtar i çështjes kombëtare dhe deputet në parlamentin jugosllav nga partia Xhemijet. Raporti i CIA-së përmend emrin e Ramë Bllacës dhe rrethanat e arrestimit të tij. Bllaca u vra për shkak të kundërshtimit të tij ndaj shpërnguljes së shqiptarëve jashtë Kosovës dhe për refuzimin e tij për të firmosur letrën për të legjitimuar këtë spastrim etnik.

Hafiz Ymeri, i cili ishte bashkëpartiak me Ramë Bllacën, i kushtoi një këngë me vargje që përmbledhin dhimbjen dhe krenarinë kombëtare:

"Haber i zi n'gazetë është shkrue,
Ky Ramë Bllaca jetë ka ndrrue.
Ramë o vlla nuk je dek,
Veç prej dynjaje ke ndrru jetë.
Por e ke lan djalin n'Universitet.
Të tana gajlet ty t'i hjek
Por kush e bani këtë ujdi
Hoxhë ka fol n'fshatin Sazli."
(Retkoceri dhe Marevci, 2007).

Kjo poezi reflekton ndjenjat e ngarkuara të kohës, duke përkujtuar një figurë të shquar si Ramë Bllaca, që kishte dhënë jetën për çështjen kombëtare. Vargjet përmbajnë një përzierje të ndjenjave të humbjes dhe shpresës për brezat e ardhshëm, të cilët do të vazhdonin luftën për liri dhe drejtësi.

Muzika si instrument i rezistencës dhe ndërgjegjes kombëtare

Krijimtaria e Hafiz Ymerit, e lidhur ngushtë me muzikën rapsodike, është një dëshmi e fuqisë që muzika dhe poezia kishin në përhapjen e ndjenjave kombëtare dhe në ruajtjen e identitetit kulturor shqiptar. Me anë të këngëve të tij, Hafiz Ymeri ndihmoi në mbajtjen gjallë të shpirtit të rezistencës kundër shtypjes, duke mbështetur kulturën

dhe gjuhën shqipe në një kohë kur ato ishin nën kërcënim të vazhdueshëm.

Poezitë dhe këngët e tij, të cilat shpesh këndoheshin nga të tjerë pa e ditur autorësinë e tyre, përhapeshin gjithandej në Kosovë dhe trojet shqiptare. Ato ishin një instrument i fuqishëm për të motivuar dhe frymëzuar shqiptarët të qëndronin të fortë në përballjen e tyre me padrejtësitë historike.

Në përmbledhje, Hafiz Ymeriështë një shembull i artistit që ndërthur në mënyrë të përkryer artin, kulturën dhe patriotizmin. Vepra e tij, qofshin ato poezi, këngë apo vargje të shkruara, përmbajnë një trashëgimi të pasur artistike dhe shpirtërore që vazhdon të frymëzojë brezat e sotëm dhe të ardhshëm.

Muzika spirituale

Hafiz Ymeri është një nga figurat më të rëndësishme që ka kontribuar në zhvillimin e muzikës shpirtërore (spirituale), një zhanër që mbart me vete një ndjenjë të thellë devocioni dhe përkushtimi ndaj Zotit. Në krijimtarinë e tij, Hafiz Ymeri ka shkruar dhe kënduar këngë që hyjnë në kategorinë e **ilahive**, këngë të cilat i janë kushtuar Zotit dhe të cilat në thelbin e tyre përçojnë mesazhe shpirtërore dhe hyjnore. Ilahitë, të cilat në kuptimin e tyre etimologjik nënkuptojnë "Zotit im" (duke iu referuar Allahut), janë pjesë e rëndësishme e traditës muzikore fetare, por fatkeqësisht sot shumë këndime të

emëruara si ilahi nuk i përmbahen domethënies së tyre të vërtetë, duke humbur kështu autenticitetin e tyre shpirtëror.

Ndërkohë që Hafiz Ymeri u përpoq të ruajë pastërtinë e këtij zhanri, është e rëndësishme që krijimet letrare dhe artistike që përfshijnë këngët spirituale të mos mbeten jashtë vëmendjes së institucioneve akademike, përfshirë katedrat muzikore dhe muzikologët. Muzika spirituale, përfshirë ilahitë, kërkon studim dhe përfshirje më të thellë në fushën e artit dhe muzikës, për t'u pranuar dhe për t'u avancuar si disiplinë në vete.

Nuk duhet të harrojmë se muzika spirituale apo ilahitë nuk janë vetëm manifestime rituale; ato janë forma arti të ngritura mbi ndjenja të thella njerëzore dhe universale. Zhanri i muzikës sufike, që shpesh gjendet mes muzikës shpirtërore dhe ilahive, është një shembull i qartë i kësaj lidhjeje midis mistikës dhe muzikës. Ilahitë, pavarësisht origjinës fetare, shpesh përçojnë mesazhe universale që gjejnë jehonë te shumë njerëz, përfshirë ata që nuk e konsiderojnë veten fetarë.

Një shembull i shkëlqyer i suksesit të kësaj muzike shpirtërore është këngëtari, tekst-shkruesi, kompozitori dhe multi-instrumentalisti britanik **Sami Yusuf**, i cili, përmes mesazheve universale të muzikës së tij, ka prekur miliona shpirtra anembanë botës. Në vitin 2009, Sami Yusuf u rendit si një nga "30 britanikët më të famshëm" nga BBC, duke u vendosur në vendin e 14-të, dhe

koncertet e tij janë të mbushura me njerëz nga të gjitha fetë dhe kulturat. Ky shembull tregon fuqinë që ka muzika shpirtërore për të kapërcyer ndarjet fetare dhe për të shërbyer si një urë lidhëse përmes mesazheve të saj të paqes dhe dashurisë.

Sot, vepra të rëndësishme të muzikës kishtare zënë vend të rëndësishëm në studimet akademike dhe në fushën e muzikës dhe artit. Por, një qëndrim i padrejtë dhe shpesh racist është adoptuar ndaj muzikës spirituale islame, përfshirë ilahitë, duke e vështruar këtë zhanër me një sy kritik dhe aspak artistik. Ilahitë, përkundrazi, meritojnë një studim të thellë dhe një përfshirje të drejtë në fushat akademike, pasi ato bartin jo vetëm dimensionin fetar, por edhe atë estetik dhe shpirtëror të thellë.

Roli i Ilahive në art dhe kulturë

Ilahitë nuk janë thjesht këngë fetare; ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të artit dhe kulturës së zhvilluar nga rrethet fetare islame. Ndërkohë që shumë krijime artistike të kësaj natyre përçojnë mesazhe të paqes, dashurisë dhe devocionit, ato shpesh i tejkalojnë kufijtë e fesë dhe gjejnë vend te njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore dhe shpirtërore. Për më tepër, këngët shpirtërore janë bërë të njohura në mbarë botën dhe kanë arritur të tërheqin vëmendjen e publikut të gjerë, jo vetëm për vlerat e tyre fetare, por edhe për përmbajtjen e tyre artistike.

Ilahitë e Hafiz Ymerit: Mes spiritualitetit dhe patriotizmit

Krijimtaria e Hafiz Ymerit në fushën e ilahive përfaqëson një ndërthurje të shkëlqyer midis spiritualitetit dhe ndjenjës së thellë kombëtare. Ndërsa shumë nga ilahitë e tij përçonin mesazhe hyjnore dhe shpirtërore, ato gjithashtu përmbanin elemente patriotike, duke i shërbyer si një mënyrë për të mbajtur gjallë shpirtin kombëtar dhe për të motivuar njerëzit në kohë të vështira.

Muzika si mjet për frymëzim universal

Roli i muzikës shpirtërore në jetën e Hafiz Ymerit dhe në kulturën shqiptare është i paçmuar. Ai përdori muzikën për të përçuar mesazhe hyjnore dhe për të lidhur njerëzit me Zotin, por gjithashtu për të frymëzuar shoqërinë e tij në përballjen me sfidat kombëtare dhe shpirtërore. Ndërsa ilahitë e tij mbeten një pjesë e rëndësishme e trashëgimisë artistike shqiptare, ato janë një thesar që duhet studiuar dhe promovuar më tej, për të kuptuar më mirë ndikimin e tyre në kulturën dhe historinë tonë.

Hafiz Ymeri ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në zhvillimin e muzikës shpirtërore dhe ilahive, duke i përdorur këto si mjete për frymëzim, devocion dhe mobilizim kombëtar. Në një botë ku ndarja midis shpirtërores dhe materiales është gjithnjë e më e pranishme, Hafiz Ymeri na kujton rëndësinë e ruajtjes së

lidhjes me shpirtin dhe kombin, përmes muzikës dhe artit.

Roli i muzikës dhe artit në jetën e Hafiz Ymerit

Për Hafiz Ymerin, muzika nuk ishte thjesht një formë dëfrimi; ajo ishte një mjet për të përçuar mesazhe shpirtërore, patriotike dhe morale. Krijimtaria e tij letrare dhe muzikore, si pjesë e traditës shqiptare dhe islame, përbënte një urë lidhëse midis shpirtit dhe kombit. **Muzika rapsodike dhe spirituale** e Hafiz Ymerit ishte një ndërthurje e elementëve shpirtërorë dhe patriotikë, duke përçuar ndjenjat e besimit dhe dashurisë për atdheun.

Në kontekstin e kulturës shqiptare, Hafiz Ymeri është një shembull i shkëlqyer i një intelektuali që përdori muzikën dhe poezinë për të frymëzuar njerëzit dhe për të mbajtur gjallë shpirtin e kombit. Këngët dhe poezitë e tij shpeshherë ishin të përshkuara me mesazhe fetare, por njëkohësisht edhe patriotike, duke treguar se arti mund të jetë një mjet i fuqishëm për të përçuar mesazhe të thella dhe për të mobilizuar shoqërinë drejt kauzave të drejta.

"Rizah Strellci, një nga rapsodët më të njohur të kohës, interpretoi dhe përhapi shumë nga këngët e Hafiz Ymerit, duke e bërë krijimtarinë e tij të njohur anembanë trojeve shqiptare. Në përmbledhjen e tij "Degë e këputur", Strellci përmend me respekt krijimet e Hafiz Ymerit, duke vënë në dukje se këngët dhe poezitë e tij

kishin një ndikim të thellë në ndjenjat e popullit shqiptar" (Strellci, 1995).

Në kontekstin e zhvillimit të muzikës dhe artit në traditën shqiptare dhe islame, Hafiz Ymeri luajti një rol të rëndësishëm në promovimin e muzikës spirituale dhe patriotike. Krijimtaria e tij artistike, e përshkuar me ndjenja të thella shpirtërore dhe kombëtare, mbetet një trashëgimi e çmuar për kulturën shqiptare dhe një frymëzim për brezat e ardhshëm. Ndërkohë që keqinterpretimet rreth muzikës vazhdojnë të ekzistojnë, studiuesit dhe artistët duhet të inkurajojnë një qasje më të kuptueshme dhe të balancuar ndaj artit dhe kulturës, duke njohur vlerën e tyre të lartë shpirtërore dhe njerëzore.

Këngët spirituale

Në veprën e tij të pasur dhe të ndritshme, Hafiz Ymeri ka krijuar këngë të veçanta që lidhen ngushtë me thelbin e mësimeve fetare dhe problemet shoqërore të kohës së tij. Një nga këto këngë është "Ve Duha," e cila është e kushtuar profetit Muhammed, paqja qoftë mbi të. Ky tekst, ndonëse i mbështetur në kontekstin fetar, shkon përtej dimensioneve religjioze për të ofruar një mesazh të fuqishëm dhe shpirtëror që është gjithashtu i lidhur me realitetin shoqëror shqiptar.

Titulli "Ve Duha" referohet në kaptinën e Kuranit të quajtur "Duha," e cila në shqip do të thotë "Pasha

paraditen." Kjo kaptinë përmban një premtim të Zotit për profetin Muhammed, që pjesa e dytë e jetës së tij do të jetë më e mirë se e para: "se pjesa e dytët e jetës tënde do të jetë më e mirë se pjesa e parë" (Izeti, 2017). Në këtë kontekst, Hafiz Ymeri përdor këtë premtim si një metaforë për të ngjallur shpresën dhe moralin në mesin e popullit shqiptar, duke theksuar se, ndonëse sfidat janë të mëdha dhe mund të duken të pafundme, e ardhmja do të sjellë përmirësime dhe përparim. Kjo është një formë e fuqishme e shpirtërores që kërkon të ngrejë moralin e shoqërisë dhe të theksojë se, për sa kohë që kauza shqiptare është e drejtë dhe e natyrshme, ajo do të triumfojë në fund.

Për analizën e kësaj vepre, profesor Pirraku (1992) thekson se "Aktualiteti i poezisë së tij akoma nuk ka rënë, sepse ngërthen frymën e Kuranit, mësimet e Muhamedit a.s. të ndërthurura me problemet shoqërore të botës shqiptare të kohës së tij dhe të kohës sonë." Kjo është një vëzhgim i rëndësishëm që nënvizon se poezia e Hafiz Ymerit, edhe pse e shkruar në një kontekst historik të caktuar, mbetet e lidhur ngushtë me çështjet dhe nevojat e kohës moderne. Ky përshkrim është ilustruar më së miri me tekstin e ilahisë që është kushtuar Lindjes së Pejgamberit Muhammed Mustafasë. Në këtë pjesë, Hafiz Ymeri, duke ndjekur shembullin e jetës së Muhammedit, fton nxënësit dhe bashkatdhetarët të qëndrojnë të bashkuar dhe të fortë për të përballuar shtypjen dhe sfidat që i rrethojnë.

Në mes të kësaj poezie, poeti, duke përdorur zërin e Muhammedit a.s., shpreh mesazhe të rëndësishme, duke i ftuar njerëzit të qëndrojnë të bashkuar dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin në çdo situatë, qoftë në vështirësi apo në gëzim. Kjo ndihmon në theksimin e domosdoshmërisë së unitetit dhe solidaritetit në përballjen me vështirësitë shoqërore dhe politike. Poeti thotë:

"Hallall boma ej ymmet
Nasihat se kom vasijet
Ni trup me kanen
jegvuxhud
Shoqi shoqin mos me dhan
Si n'idhnim, qashtu n'gzim
Se n'birlik ka gjallërim"

Këto vargje përmbajnë një mesazh të fuqishëm dhe motivues, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe unitetit (jegvuxhud) si një mjet për të arritur gjallërimin dhe prosperitetin në shoqëri. Termat "ymmet" (popull, komunitet), "nasihat" (këshillë), "vasijet" (testament), dhe "birlik" (bashkim) janë përdorur për të ilustruar themelet e bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke që janë të nevojshme për të përballuar sfidat dhe për të ndihmuar në ngritjen e një shoqërie më të

Jemi ardhur në këtë dynja

Filozofia dhe qëllimi i krijimit janë tema të thella që kanë preokupuar mendjen njerëzore dhe shkencat filozofike

për shekuj me radhë. Edhe pa ndikimin e metodave shkencore të sotme, njerëzit shpesh janë përballur me pyetje ekzistenciale: Kush jam unë? Nga kam ardhur? Dhe ku po shkoj?

Hafiz Ymeri, një mendimtar dhe krijues i rëndësishëm i traditës shqiptare, ka treguar një njohuri të thellë në filozofi dhe teologji. Veprat e tij shpirtërore, përveç se të ndritura artistikisht, janë edhe të mbushura me reflektime filozofike të thella. Në një nga këngët e tij më të njohura, ai trajton pikërisht çështjen e qëllimit të krijimit të njeriut dhe kuptimin e ardhjes në këtë botë, duke e shprehur këtë temë në mënyrë të përhapur dhe të ndikshme.

Vargjet e këngës "Jemi ardh në këtë dynja" përmbajnë një mesazh të fuqishëm mbi qëllimin e ekzistencës njerëzore:

"Jemi ardh në këtë dynja
Për me dit se ka Allah
Atij me ju lutun na
La ilahe ilAllah"

Këto vargje nënvizojnë se qëllimi i ardhjes në këtë botë është njohja e Zotit dhe lutja ndaj Tij. Ky mesazh është një reflektim i thellë mbi ndihmën dhe udhëzimin hyjnor në jetën e përditshme.

Një aspekt interesant i kësaj kënge është se, ndryshe nga shumë krijime të tjera artistike, ajo thekson rëndësinë e

diturisë dhe studimeve shkencore. Hafiz Ymeri, me një modesti të veçantë, e sheh veten jo si individ të zakonshëm, por si "Ibni Shemsi" – "i biri i Shemsiut," duke preferuar të përdorë një formë modeste të përfaqësimit të tij. Ai shpreh:

"Ibni Shemsi e ka shkru
Zoti në xhenet e pas çu
Mësojave ilmin (diturinë) fëmije ty
Le ilahe ilAllah"

Ky fragment flet për vlerën e diturisë dhe përkushtimin e Hafiz Ymerit ndaj mësimdhënies dhe përhapjes së dijes. Nëse Hafiz Ymeri do të kishte ndaluar me angazhimet e tij në fushën e arsimit, prapë do të kishte arritur të lë një ndikim të jashtëzakonshëm në përparimin intelektual dhe shkencor të shoqërisë.

Një tjetër varg i fuqishëm në këtë këngë është:

"Na pa mësim nuk ban me kanë
Sa pa dillë e sa pa hanë
Paditurinë e kemi dushman
La ilahe ilAllah"

Këto fjalë theksojnë se pa dituri dhe edukim, individët janë të dënuar të mbeten në një gjendje të paditurisë, që është e barazvlefshme me një armik të rrezikshëm për zhvillimin e individëve dhe shoqërisë. Fenë Islame e nxit dhe e motivon zhvillimin shkencor dhe ngritjen

intelektuale si një mjet për të avancuar shoqërinë dhe individët.

Një bashkëpunëtor i rëndësishëm i Hafiz Ymerit, Mulla Vesel Guta, gjithashtu i ka kënduar rëndësisë së diturisë, duke e nxitur popullin shqiptar që të kërkojë dhe të zhvillojë njohuri.

Ai ka theksuar se pa dituri, individët dhe shoqëritë nuk mund të arrijnë përparim dhe zhvillim. Në *këtë kontekst, Guta shprehet:*

"Çka asht i bam
Asht nji sen
Xhehaleti kurni sen
I pa knueshmi si pa men
Pa knim na smujm me kan
Sa pa dill e pa han
Xhehaletin e kem dushman"

(Mulla Vesel Guta)

Në këto vargje, Mulla Vesel Guta shprehet në mënyrë të fuqishme për domosdoshmërinë e diturisë dhe njohurive si një element thelbësor për të përballuar paditurinë dhe për të ndihmuar në përparimin shoqëror.

Mos e le fale namazin

Një tjetër krijim i rëndësishëm i muzikës spirituale të Hafiz Ymerit është kënga kushtuar namazit, e cila përmban 30 vargje, të ndara në dhjetë strofa me tri vargje secila. Ndërsa në një lexim të thjeshtë, kjo këngë mund të duket si një ilahi fetare, konteksti historik dhe rrethanat kur është shkruar janë shumë më të thella. Prof. Pirraku, i cili ka intervistuar shumë njerëz që e kanë njohur nga afër Hafiz Ymerin, shprehet se kjo këngë "është moralizuese dhe u është dedikuar masave të gjera, luftës kundër dembelisë, kundër përçarjes fetare e kombëtare." Midis tjerash, ajo thërriste:

"Mos e le fale namazin,
Bile synet edhe farzin
Mos ta idhnojmë Allahun!"

Në këtë këngë, Hafiz Ymeri thekson rëndësinë e ruajtjes së namazit dhe e kritikon mungesën e përkushtimit ndaj këtij obligimi fetar. Ai thekson gjithashtu se, nëse dikush lë namazin, atëherë është përbuzur nga shejtani dhe ndëshkohet për këtë.

Në këngën e tij, Hafiz Ymeri i drejtohet edhe ata që janë angazhuar në tarikate dhe që përkushtimi i tyre në praktikën fetare e ka shpërqendruar nga çështjet e jetës së përditshme dhe kauza kombëtare. Prof. Pirraku nënvizon se Hafiz Ymeri ka këshilluar dhe s'është pajtuar me menaxhimin e kohës që bënin dhe 'dy vëllezërit e tij,

të cilët ishin myhybë kadiri të Sheh Mehmetit, të cilët në lutje, në ziqet po humbnin kohë të vlefshme për punë arsimore, kulturore dhe binin ndesh me Hadithin (thëniet e Muhammedit paqja qoftë mbi të).

Poeti përfundon poezinë me një apel për ndihmë dhe ndëshkim për ata që e kanë braktisur këtë praktikë të rëndësishme dhe kërkon mëshirën e Zotit për të gjithë ata që janë të përkushtuar në ndihmën e shoqërisë:

"Na po të l'tuemi ty Ja Gafarr,
Xheza bani gjithë zullumqar
Se kurgja nuj po na lon me mar…"

Në përfundim, këto krijime të Hafiz Ymerit dhe bashkëpunëtorëve të tij tregojnë një angazhim të thellë për edukimin dhe zhvillimin intelektual si një mjet për përparimin e shoqërisë dhe mbrojtjen e vlerave fetare dhe kulturore.

Instrumentist dhe valltar

Hafiz Ymer Shemsiu ishte një prej instrumentistëve më të shquar në Kosovë gjatë viteve 1920 dhe 1930. Kjo periudhë e artit muzikor shqiptar ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe njohësve të biografisë së tij, të cilët e cilësuan si një nga figurat kyçe të muzikës tradicionale shqiptare. Siç thekson Prof. Muhamet Pirraku: "Veprimtari i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare, pedagogu dhe krijuesi moralizues iluminist, Hafiz

Ymeri, ishte njëri ndër rapsodët dhe instrumentistët muzikorë më të shquar të Kosovës të viteve ’20 e ’30 të shekullit XX.

Luante valle me çifteli dhe me mandolinë, me ritme plotë vrulle, me kthesa të thekshme që i shkonin për shtati tiparit dhe temperamentit shqiptar, të njeriut të tokës dhe të qiellit shqiptar" (Pirraku, 1992).

Kontributi i tij muzikor, përveç që ishte një formë artistike, shërbente si një mjet për përçimin e vlerave kombëtare dhe historike. Ai këndonte këngë atdhetarie në ngjarje të shënuara dhe festa kombëtare, duke prekur temat e trimërisë, plagët e mërgimit dhe heroizmin shqiptar. Siç thekson Prof. Kraja: "Hafizi ishte i njohur njëkohësisht edhe si një ndër rapsodët e instrumentistët

më të shquar të Kosovës së viteve '20-30 të shekullit XX. Në festa dhe ngjarje të shënuara, Hafiz Ymeri me çiftelinë e tij këndonte këngë atdhetarie, historike të krahinës dhe mbarë viseve shqiptare. I këndoi akteve të trimërisë, plagës së mërgimit, duke vënë në melodi edhe vargje të poezive dhe të poemës së tij 'Nazim Gafurri', duke krijuar emocione te dëgjuesit e shumtë, të cilat ndikonin dukshëm në ndjenjat e tyre atdhedashëse, në zgjimin dhe konsolidimin e tyre" (Kraja, 1993).

Hafiz Ymeri nuk e kufizonte veten vetëm në përformanca të veçanta; ai ishte pjesëmarrës aktiv në ngjarje të shumta kulturore, si gjatë festave kombëtare dhe fetare, ashtu edhe në ahengje familjare. Në këto raste, siç përshkruan Prof. Pirraku, "me çiftelinë e tij këndonte këngë patriotike, historike, të Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe këngë për Lëvizjen e Rezistencës Shqiptare kundër

okupatorit serb dhe jugosllav, të cilat i hartonte vetë ose ato që i krijonin anëtarët tjerë të Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare, si Dervish Goxhulli, Mulla Maliq Sylejmani etj." (Pirraku, 1992).

Kontributi i tij në artin muzikor dhe kulturën shqiptare të kësaj periudhe ishte i jashtëzakonshëm. Siç përmend Prof. Ramiz Zekaj: "Në këtë kohë, Hafiz Ymeri shpërtheu me tërë personalitetin e tij, bashkëpunoi me lëvizjen kaçake kombëtare, këndoi me çifteli këngë që evokojnë të shkuarën e lavdishme të kombit, formuloi ilahi dhe thuri poezi me metrika të ndryshme, por ku mbizotëron vargu popullor" (Zekaj, 2007).

Bardi i Kosovës së viteve '20 e '30-ta

Një nga cilësimet më të njohura për Hafiz Ymerin, si "Bardi i Kosovës," erdhi nga studimi i thellë dhe i zgjatur që Prof. Muhamet Pirraku realizoi për veprimtarinë e tij. Ky hulumtim, i cili zgjati më shumë se një dekadë, solli në dritë shumë aspekte të jetës dhe veprimtarisë së Hafiz Ymerit. Në studimin e botuar në revistën *Dituria Islame* në vitin 1992, Pirraku e cilëson Hafiz Ymerin si "Bardi i Kosovës," një figurë e rrallë që ndërthurte në mënyrë të përkryer artin muzikor dhe angazhimin patriotik.

Së paku gjashtë këngë dhe një poemë historike

Studimet e realizuara për veprën e Hafiz Ymerit tregojnë se ai ka krijuar dhe kënduar së paku gjashtë këngë dhe një poemë historike. Këto krijime, të cilat ai i interpretonte i pari, të shoqëruara nga çiftelia, mbeten një thesar i kulturës popullore shqiptare. Siç përmend Prof. Pirraku: "Hulumtimet në fushë të veprës së Hafiz Ymerit vërtetojnë se kemi para vetes, për njohje e studim, një Bard të vërtetë të Kosovës, i cili së paku i shkroi gjashtë këngë dhe një poemë historike, dhe që të gjitha i këndoi i pari me përcjellje me çiftelia" (Pirraku, 1992).

Autor i këngës kushtuar 'Muhaxhirëve'

Një nga këngët më të njohura të krijuara nga Hafiz Ymeri ishte ajo kushtuar muhaxhirëve të dëbuar nga Toplica dhe Kosanica. Sipas Prof. Pirrakut, kjo këngë u këndua në dy gjuhë, shqip dhe turqisht, dhe u përhap gjerësisht në të gjitha viset ku ishin përqendruar muhaxhirët pas vitit 1878. Kjo këngë mbeti një simbol i vuajtjeve dhe

qëndresës së shqiptarëve të dëbuar nga tokat e tyre (Pirraku, 1992).

Këngë patriotike dhe figura kombëtare

Përveç këngës kushtuar muhaxhirëve, Hafiz Ymeri krijoi dhe këndoi edhe për shumë figura të shquara të kohës së tij, si Ahmet Mulla Syla, i vrarë në vitin 1924, Ferat Be Draga, Ramë Bllaca, dhe Banush Sadllari. Në këto këngë, të cilat përfshijnë mbi 250 vargje, Hafiz Ymeri dëshmohet si një kronikan besnik i kohës së tij, duke ruajtur dhe përjetësuar ngjarje të rëndësishme për historinë shqiptare (Pirraku, 1992).

Model në bashkëpunim kulturor dhe artistik

Bashkëpunimi i Hafiz Ymer Shemsiut me rapsodin e njohur Rizah Strellci është një shembull unik i ndërlidhjes së kulturës muzikore dhe artistike shqiptare në vitet '20-'30. Ky bashkëpunim, i karakterizuar nga një harmoni e rrallë, ka mbetur një pikë referimi për studiuesit e kulturës shqiptare. Siç thekson Prof. Muhamet Pirraku: "Bardi poet Hafiz Ymeri dhe rapsodi poeti Rizah Strellci janë si dy pipat në instrumentet muzikore 'Pelqesje' ose 'Gajde'. Njëri jepte zërin, e tjetri tingujt; njëri melodinë e tjetri përmbajtjen" (Pirraku, 1992). Ky bashkëveprim mes dy figurave ishte një sintezë perfekte e dy komponentëve të artit – tingulli dhe fjalës, ku secili plotësonte tjetrin në përhapjen e ideve kombëtare.

Prof. Kraja e përshkruan Rizah Strellcin si një "krijues të talentuar të shkollës së Hafiz Ymerit dhe Mulla Vejsel Xheladin Gutës, i cili e shoqëroi shumë herë në aktivitetet e tij" (Kraja, 2016). Ky bashkëpunim artistik dhe kulturor nuk ishte vetëm një veprim muzikor, por një platformë për të artikuluar dhe përhapur idetë e rezistencës kombëtare dhe frymën patriotike në një periudhë kritike për shqiptarët e Kosovës.

Prof. Pirraku thekson se ky bashkëpunim ishte i paprecedentë në historinë e mendimit letrar shqiptar: "Në historinë e mendimit letrar shqiptar nuk dimë dy krijues që kanë bashkëpunuar aq burrërisht si Hafiz Ymeri e Rizah Strellci. Së këndejmi, është vështirë të veçohet se në çfarë është njëri dhe çfarë është tjetri, veçantë në fushën e këngës historike. Jetuan dhe vepruan për njëri-tjetrin e të dy për popullin. Kur nuk bënë pasuri, sepse nuk patën kohë t'i kushtohen jetës private. Jetuan midis popullit, si dy shahirë, njëri imam e tjetri mjeshtër drugdhendës, njëri ideolog e tjetri përhapës i ideologjisë kombëtare. Të dy poet të zjarrtë" (Pirraku, 1992). Ky bashkëpunim ishte një shembull i rrallë i ndërlidhjes së mendimit letrar dhe muzikës në shërbim të një ideali të përbashkët – lirisë dhe rezistencës kombëtare.

Në një poezi të gjatë, Hafiz Ymeri pranon rëndësinë e këtij bashkëveprimi, duke e quajtur Rizah Strellcin "Bilbil" dhe veten si të mbyllur në kafaz, të burgosur në burgun kolektiv për popullin shqiptar nën robërinë jugosllave. Në këtë poezi, Hafiz Ymeri shkruan:

"O bylbyl sa mirë po këndQyr sa fort po me perget mu,Nat e dit qi po vajtonMe u bashu me vllahen tu..."
(Pirraku, 1992).

Hafiz Ymeri e fton Rizah Strellcin të vazhdojë veprimtarinë revolucionare, duke ngritur lart dashurinë për lirinë dhe për Shqipërinë etnike, dhe duke madhëruar dëshmorët që po binin në Lëvizjen e Rezistencës Shqiptare. Ai i thotë Rizah Strellcit:

"Kije formën hem bukurinë;Këndo bylbyl cim cim gjithmonëSe shumë emna t'Zotit i dinëTi vuajtjen t'ona na i diftonë..."
(Pirraku, 1992).

Rizah Strellci, krijuesi i talentuar i shkollës së Hafiz Ymerit dhe Mulla Vejsel Xheladin Gutës, e njohu dhe e nderoi me përkushtim këtë bashkëpunim të veçantë në një poezi prej 24 strofash me katër vargje, të titulluar "Nji përgjegjëse me i falënderim një Hoxhe vjershtor nga Sazlija, i quajturi Hafuz Ymer Shemsi, në vitin 1938", ku ai shkruan:

"Qyr Hafuz qi rrin në Sazli,Ti që më konke kombëtar,Po gjithnji me rrinë nder sy,Po ban vjersha me do fjal.

Ti e vajtojshe gjithë bylbylin
Me ato kangë qi asht tu këndue,
Se aji i mjeri po e lyp pyellin,
N'tjetër vend nuk mund me rrnue..."
(Pirraku, 1992).

Kjo poezi përshkruan jo vetëm bashkëpunimin artistik mes dy figurave, por edhe përkushtimin e tyre të thellë ndaj idealeve të kombit dhe lirisë. Një ndërthurje e tillë e artit dhe ideologjisë, ku poezia dhe muzika bëhen mjete të fuqishme për përhapjen e frymës së rezistencës, është një model që rrallë është hasur në historinë e kulturës shqiptare. Hafiz Ymeri dhe Rizah Strellci bashkëjetuan në një lidhje të ngushtë mes poezisë dhe muzikës, duke lënë gjurmë të thella në kujtesën kombëtare dhe artistike të kohës.

Kapitulli V

Ideolog i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare

Ideolog i Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare

E gjithë veprimtaria e Hafiz Ymer Shemsiut ishte një përkushtim i plotë për çështjen kombëtare shqiptare, duke e parë identitetin kombëtar shqiptar si një determinizëm hyjnor. Ai e zhvilloi këtë mision përmes arsimit, kulturës dhe edukimit, por gjithashtu nëpërmjet veprimtarive diplomatike dhe ushtarake. Me një përgatitje të thellë si intelektual dhe teolog, Hafiz Ymeri kishte njohuri të thella për zhvillimet kulturore dhe politike në perëndim dhe lindje, të cilat ia mundësuan atij të veprojë në mënyrë strategjike. Siç ka thënë

KOHËSHTRIRJE

1912 – Lufta Parë Ballkanike, forcat serbe e marrin nën kontroll pjesën tjetër të Kosovës.
1913 - Traktati i Londrës e krijon shtetin e ri shqiptar – duke e lënë shumicën e shqiptarëve jashtë tij – dhe kështu njeh sovranitetin serb në Kosovë.
1914 – 1918 – Kosova pushtohet nga Bullgaria dhe Austro – Hungaria në Luftën e Parë Botërore.
1918 - Mbrojtja Kombëtare e Kosovës
1918 – Pas përfundim të luftës, fuqitë qendrore kapitullojnë, delegatë në Beograd e shpallin ''Mbretërinë Serbe, Kroate dhe Sllovene''.
1919 - Partia e Parë Politike Shqiptare 'Xhemijeti' – 'Bashkimi'
1937 – Organizata e Rinisë Përparimtare Shqiptare ''Drita''
1943 - Lidhja e Dytë e Prizrenit – Komiteti Qarkor i Ferizajt
1944 – Lufta e Ferizajt
1945 – Hafiz Ymeri vdes i izoluar nga

Profeti Muhamed: "Kushtoni rëndësi intuitës së besimtarit, sepse ai sheh me dritën e Zotit." Për Hafiz Ymerin, ky ishte një udhëzues, por puna e tij u mbështet gjithmonë në analiza të sakta dhe studime të thella.

Në përpjekjet e tij për ngritjen e nivelit arsimor dhe kulturor të shqiptarëve, ai nuk e la pas as përfshirjen e tij në veprimtari diplomatike dhe në luftën e armatosur për mbrojtjen e kombit. Siç thekson Prof. Muhamet Pirraku: "Ta mbrosh fenë islame, për kohën e poetit, ishte luftë për kombin shqiptar; ta mbrosh gjuhën shqipe ishte heroizëm kombëtar; të përpiqesh për lirinë dhe ta ndihmosh Rezistencën Shqiptare kundër denacionalizimit të Kosovës ishte sakrificë dhe heroizëm kombëtar" (Piraku, 1992).

Veprimtaria e Hafiz Ymerit ishte gjithmonë në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare. Siç ka thënë Prof. Kraja: "Hafiz Ymeri vazhdonte të punonte me përkushtim për Shqipërinë e plotë dhe nuk u josh asnjëherë ndaj synimeve ideologjike sllave e të tjera, aq shumë të interesuara për copëtimin dhe shkombëtarizimin shqiptar. Ai kishte për ideal Shqipërinë etnike mj,,dhe nuk u pajtua asnjëherë me lëshimet as koncensionet ideologjike" (Kraja, 1993).

Hafiz Ymeri ishte një nga ideologët kryesorë të Lëvizjes së Rezistencës Shqiptare, një figurë e cila nuk u ndal kurrë së motivuari popullin për të mbrojtur kufijtë etnikë të Shqipërisë.

Angazhimin kombëtar e kishte nisur mbase edhe para 1920-tës. Do i ecnte, motivonte, e ishte pjesë e nismave kombëtare që prej kësaj kohe e deri në vdekje në gjitha qendrat e medha shqiptare jashtë Shqipirës londineze si Prishtinë, Shkup, Vushtrri, Mitrovic, Prizren e Gjilan.

Përgatitja e tij fetare dhe botëkuptimi islam, siç thekson Prof. Ramiz Zekaj, luajtën një rol kyç në formimin e tij si një lider dhe motivues: "I ngritur nga ana botëkuptimore islame, botëkuptim që e respekton lirinë dhe lufton për te, Hfz. Ymeri, i mbrujtur me dashuri për kombin, u aktivizua në shërbim të Komitetit për Çlirimin Kombëtar të Kosovës dhe bëri pjesë në partinë politike shqiptaro-myslimane 'Bashkimi,' që kryesohej nga Ferhat Draga. Në këtë kohë, Hfz. Ymeri shpërtheu me tërë personalitetin e tij, bashkëpunoi me lëvizjen kaçake kombëtare" (Zekaj, 2012).

Si një nga hoxhallarët dhe intelektualët që i shërbenin çështjes kombëtare shqiptare, Hafiz Ymeri u bashkua me figura të tjera të njohura të asaj kohe, si Mulla Iljaz Broja, Mulla Ibrahim Polaci, Mulla Zekë Bërdyna, Haxhi Jahja Daci, dhe shumë të tjerë. Siç thekson Prof. Rexhepi: "Në mesin e tyre ishin edhe: Mulla Iljaz Broja, Mulla Ibrahim Polaci, Mulla Zekë Bërdyna, Mulla Nura i Gjinocit, Haxhi Jahja Daci, Asim efendi Luzha, Mulla Hamit Bytyçi, Mulla Ahmet Çunaku, Mulla Riza Osmani, Hafiz Imer Shemsiu, Mulla Rexhep Krasniqi..." (Rexhepi, 2013).

Hafiz Ymeri, një ideolog dhe promotor i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u përball me shumë sfida dhe rreziqe gjatë veprimtarisë së tij. Siç thuhet: "Për shkak të veprimtarisë atdhetare është ndjekur e përndjekur vazhdimisht" (Retkoceri & Marevci, 2007).

Mbrojtja Kombëtare e Kosovës – 1918

"Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" ishte një organizatë shqiptare që u themelua ilegalisht më 1 maj 1918, duke marrë një formë më të përhershme më 7 nëntor të po atij viti, kur selia e saj u vendos në Shkodër. Themelimi i kësaj organizate shënoi një pikë të rëndësishme në historinë e rezistencës shqiptare kundër ndarjes së padrejtë të territoreve shqiptare, e cila u bë me vendimet ndërkombëtare të vitit 1913. Organizata kishte si qëllim kryesor mbrojtjen e sovranitetit të shtetit të pavarur shqiptar, demokratizimin e tij, dhe mbi të gjitha, çlirimin e Kosovës dhe bashkimin e trojeve shqiptare që ndodheshin nën sundimin jugosllav.

Themeluesit e kësaj organizate ishin disa nga figurat më të rëndësishme të kohës, përfshirë Hoxhë Kadri Prishtinën, ish-mjek ushtarak dhe ish-ministër i Drejtësisë së Shqipërisë, Qerim Begolli, Hysni Curri (nipi i Bajram Currit), dhe shumë të tjerë. Ndër figurat kryesore që kontribuan në organizatën "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" përmenden emra të shquar si Bajram Curri, Hoxhë Kadri Prishtina, Sali Nivica, Hasan

Prishtina, Bedri Pejani, Hafiz Ismet Dibra dhe të tjerë. Organizata synonte jo vetëm çlirimin e territoreve të okupuara shqiptare, por edhe integrimin e tyre në një Shqipëri të lirë dhe të vetëqeverisur.

Një nga pikat kyçe të programit të organizatës përfshinte angazhimin për bashkimin e krahinave të Kosovës dhe trevave përreth, duke përfshirë Shkupin, Kumanovën, Tetovën, Ferizajn, Pejën, dhe shumë të tjera, me shtetin shqiptar. Siç përshkruan dokumenti themelues: "Me u përpjekë para pushteteve të mëdha të Entantës e me kërkue bashkimin e krahinave të Kosovës (Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Kaçanik, Ferizoviq (Ferizajn), Gjilan, Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Jeni Pazarin (Pazari i Ri), Rozhajë, Pejë, Guci, Gjakovë, Prizren) në Shqipni të lirë dhe vetëurdhënuese."

Sipas gjithë studiuesve të figurës së tij, Hafiz Ymeri ishte një pjesëmarrës aktiv i kësaj organizate kombëtare. Prof. Muhamet Pirraku, duke përshkruar rolin e Hafiz Ymerit dhe të hoxhallarëve të tjerë të Ferizajt në organizatën "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës", thekson rëndësinë e tyre: "Midis hoxhallarëve që bënë emër në historinë e Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës, përpos komandantit të përgjithshëm të vullnetarëve për Nënprefekturën e Gjilanit, Mulla Idrizit, ishin edhe Mulla Ramadan Ahmeti, ish-kryetar i Bashkësisë Komunale të Dobërçanit, kurbani i shqiptarizmit të dobërçanasve; Mulla Ymer Shemsedini, poet i viteve ’30-ta e mualim; Mulla Vejsel Xhelaludin Guta, pedagog mejtepesh, poet

e ideolog i Lëvizjes për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës, autor i himnit luftarakë 'Shqiptarë'" (Pirraku, 1995).

Kjo organizatë, me një përbërje të fuqishme intelektualësh dhe patriotësh shqiptarë, ishte një forcë politike dhe ushtarake që jo vetëm synonte mbrojtjen e trojeve shqiptare, por gjithashtu donte të sensibilizonte fuqitë e mëdha për çështjen e pazgjidhur shqiptare. Siç përfundon Prof. Pirraku: "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës ishte organizata politike gjithëkombëtare më e fuqishme dhe më unike, e cila luftonte për mbrojtjen e trojeve dhe interesave shqiptare, organizata që do aktualizonte në nivel global çështjen e pazgjidhur shqiptare."

Figura 21: Flamuri i Kosovës i paraqitur nga Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës viti 1918

Partia e parë Politike Shqiptare 'Bashkimi' ose 'Xhemijeti' – 1919

"Xhemijeti" ishte një nismë politike shqiptare e krijuar në vitin 1919, e cila luajti një rol kyç në përfaqësimin dhe mbrojtjen e çështjes shqiptare brenda Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, që mbante nën pushtim një pjesë të madhe të trojeve shqiptare jashtë kufijve të "Shqipërisë Londineze". Studiues të njohur, si Noel Malcolm, Robert Elsie dhe Oliver Schmitt, e kanë theksuar rëndësinë e kësaj partie në mbrojtjen e të drejtave shqiptare në këtë periudhë, ndërsa përpjekjet për të minimizuar rolin e saj zakonisht vijnë nga individë me prirje ideologjike dhe jo nga një qasje shkencore objektive.

Partia "Xhemijeti" vepronte nën petkun e një organizate fetare, pasi çështja shqiptare si kauzë kombëtare ishte ndaluar ashpër nga autoritetet e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene. Nën drejtimin e Nexhip Dragës dhe më vonë të vëllait të tij Ferhat Draga, partia synonte të mbronte territorin shqiptar nga kolonizimi i nxitur nga reforma agrare serbe, e cila promovonte shpërnguljen e shqiptarëve dhe zëvendësimin e tyre me kolonë sllavë. Siç thekson Prof. Azizi: "Xhemijeti, duke synuar mbrojtjen e territoreve etnike shqiptare nga kolonizimi, që stimulohej përmes reformës agrare, në fakt e mbronte gjeografinë shqiptare" (Azizi, 2019). Përveç kësaj, partia kishte një fokus të fortë në arsimin në gjuhën amtare, duke kërkuar arsim kombëtar në gjuhën shqipe, një

kërkesë e domosdoshme për mbrojtjen e kulturës dhe identitetit kombëtar.

Partia "Xhemijeti" konsiderohet si një vazhdimësi e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, duke u bërë një nga organizatat politike më të rëndësishme të kohës që vepronte për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve brenda një shteti armiqësor. Ajo ndërpreu skenarin e shpërnguljes masive të shqiptarëve nga tokat e tyre, një fakt që theksohet edhe nga sociologu serb Sreten Vukosavleviq, i cili në vitin 1923 shkruante: "Synimet e nacionalistëve shqiptar janë rreziku më i madh për ne. Njerëzit që udhëheqin Xhemijetin janë nacionalistët më të dalluar të kryengritjeve shqiptare nga viti 1908-1912" (Azizi, 2019).

Përfaqësuesit e "Xhemijetit" morën pjesë në Parlamentin e Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, duke i dhënë zë politikës shqiptare në një legjislaturë të huaj. Hafiz Ymeri ishte gjithashtu një nga pjesëtarët aktivë të kësaj partie, siç theksohet nga studiues të ndryshëm: "Hafiz Ymeri, i mbrujtur me dashuri për kombin, u aktivizua në shërbim të Komitetit për Çlirimin Kombëtar të Kosovës dhe bëri pjesë në partinë politike shqiptaro-myslimane 'Bashkimi', që kryesohej nga Ferhat Draga" (Zekaj, 2007). Hafiz Ymeri, si dhe figura të tjera të shquara të kësaj lëvizjeje, si Nazim Gafurri, që u vra në vitin 1927, vazhduan të luftonin për mbrojtjen e të drejtave shqiptare. Për Gafurrin, Hafiz Ymeri shkroi një poemë përkujtimore, duke i dhënë kështu zë shpirtit të tij patriotik.

Hafiz Ymer Shemsiu, që nga viti 1920, ishte një veprimtar i devotshëm në Lëvizjet Çlirimtare Shqiptare në Kosovë dhe një pjesëtar aktiv i "Xhemijetit". Ai bashkëpunoi me Lëvizjen Kaçake Kombëtare dhe themeloi Komitetin e Kosovës në Xhaminë e Talinofcit (Yvejsi, 2010). Kjo lëvizje e fuqishme kontribuoi në mbrojtjen e interesave shqiptare, duke parandaluar kolonizimin dhe shpërnguljen masive të popullsisë.

Organizata e Rinisë Përparimtare Shqiptare "Drita" – 1937

Organizata e Rinisë Përparimtare Shqiptare "Drita" u themelua më 1 prill 1937 në rrethana ilegale në Arllat të Drenicës (Keçmezi-Basha, 2019). Kjo organizatë ishte fryt i përpjekjeve të medresistëve shqiptarë që studionin në Medresenë e Madhe të Kral Aleksandrit dhe në Medresenë Isa Beu në Shkup. Siç theksohet nga Pirraku (1995/2017), "Realisht kjo organizatë është themeluar me iniciativën e nxënësve e studentëve që mësonin në 'Medresenë e Madhe të Kral Aleksandrit' dhe në Medresenë 'Isa Beg' në Shkup dhe kishte lidhur për vete krerë dhe hoxhallarë përparimtarë, patriot e dashamirë të librit shqip."

Një aspekt themelor i kësaj organizate ishte që ajo përfshinte jo vetëm të rinj, por gjithashtu dhe njerëz të moshave më të mëdha, duke u bërë një rrjet i gjerë i intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë që vepronin në

Ferizaj dhe më gjerë. Hafiz Ymer Shemsiu, imam i fshatrave Talinofc i Muhaxhirëve dhe Sazli, ishte një prej anëtarëve të saj nga kjo trevë (Retkoceri & Marevci, 2007).

Organizata "Drita" kishte për qëllim të përhapte arsimin kombëtar shqiptar në kushte ilegale dhe të demotivonte shpërnguljen në Turqi, siç theksohet nga Pirraku (1974) dhe Hashani (1995): "Organizata, pos tjerash si detyrë kryesore kishte përhapjen e arsimit kombëtar ilegal shqip dhe propagandonte kundër shpërnguljes së shqiptarëve në shkretëtirat e Anadollit." Sipas Prof. Krajës (2016), ndër bashkëpunëtorët e saj ishin edhe figura të shquara si Mulla Rexhep Krasniqi, Vesel Pagarusha dhe Mulla Arif Shala.

Hafiz Ymeri shërbeu si sekretar i organizatës, duke mbështetur me përkushtim përhapjen e arsimit kombëtar dhe rezistencën ndaj presionit për emigrim, duke luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar përmes arsimit dhe kulturës (Retkoceri & Marevci, 2007).

Lidhja e Dytë e Prizrenit - 1943

Komiteti Qarkor i Ferizajt

Lidhja e Dytë e Prizrenit, e mbajtur në shtator të vitit 1942, përfaqësonte një nismë kombëtare që synonte organizimin politik dhe ushtarak të popullit shqiptar, gjithnjë sipas modelit kombëtar shqiptar dhe me qasje demokratike. Megjithëse ekzistojnë pikëpamje të

ndryshme për datat dhe zhvillimet e saj, studiuesit bien dakord mbi objektivat kryesore, të cilat përfshijnë organizimin e propagandës për mbrojtjen e territorit shqiptar dhe përgatitjen shpirtërore e materiale të popullit për këtë qëllim. Sipas Dr. Alban Dobruna (2016), "Qëllimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishte përgatitja fizike dhe shpirtërore e popullit për mbrojtjen e tërësisë së trojeve shqiptare". Lidhja synonte gjithashtu organizimin e një aparati administrativ për të gjitha trevat shqiptare, me një strukturë që përfshinte prefektura, komuna dhe bashki.

Lidhja synonte gjithashtu bashkimin e trojeve shqiptare, përfshirë Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë, me Shqipërinë, si dhe mbrojtjen e këtyre territoreve nga popullsitë sllave. Dr. Dobruna (2016) gjithashtu përmend që një nga qëllimet ishte "sigurimi në rrugë historike dhe diplomatike të qenies së shqiptarëve në këto toka". Në këtë kontekst, Hafiz Ymer Shemsiu luajti një rol të rëndësishëm. Profesor Muhamet Shatri (2016) e përshkruan si një figurë kyçe që "u zgjodh anëtar i Komitetit Qarkor të Ferizajt dhe organizoi mobilizimin e vullnetarëve për mbrojtjen e trevave etnike të rrezikuara nga ripushtimi serbo-komunist". Hafiz Ymeri, përveç organizimit të mobilizimit, ishte ndjekur dhe persekutuar vazhdimisht për veprimtarinë e tij atdhetare dhe ishte njohës i disa gjuhëve të huaja.

Kontributi i Hafizit u përmend gjithashtu nga Pirraku (1992), i cili thekson se Hafiz Ymeri "bashkëpunoi

ngushtësisht me veprimtarët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit: Mustafë Natikun, Halim Shukun, Ilaz agë Tashin dhe kryente punë të përkthyesit nga shqipja e turqishtja në gjermanisht dhe nga gjermanishtja në këto dy gjuhë." Kjo veprimtari u krye në zyrën e Kryetarit të Bashkisë, Mustafë Natiku, një prishtinas i arsimuar në Stamboll, i cili luajti një rol kyç në këtë nismë kombëtare.

Situata e ndërlikuar politike e kohës kërkonte unitet dhe bashkërendim të forcave shqiptare për të mbrojtur trojet etnike nga rreziku i ripushtimit. Në këtë përpjekje, roli i klerit mysliman ishte thelbësor, siç përmend Dr. Alban Dobruna (2020), i cili vë në pah rëndësinë e "liderëve fetarë myslimanë si njerëz me autoritet të arsimuar dhe influencë në popull." Hafiz Ymeri ishte padyshim një prej këtyre liderëve, që shërbeu si frymëzues për Lëvizjen Popullore dhe ndihmoi në ruajtjen e kufijve etnikë të Shqipërisë. Ai bashkëpunoi ngushtë me Basri Boshnjakun, kryetar i Komitetit të Vullnetarëve të Ferizajt, në organizimin e vullnetarëve për të mbrojtur kufijtë, siç e përshkruan Prof. Pirraku (1992): "Hafiz Ymeri dha një kontribut të çmueshëm në fushë të ngritjes së vetëdijes kombëtare midis masave popullore të cilave u duhej folur në gjuhën e një hoxhe, një të besueshmi në Zotin dhe Muhamedin as., e jo në gjuhën e të besueshmëve në jahudizmin evropian, përkatësisht në pansllavizëm rus të quajtur komunizëm." Ky angazhim kombëtar për të mbrojtur identitetin dhe integritetin territorial të Shqipërisë tregon rëndësinë e Lidhjes së

Dytë të Prizrenit në historinë shqiptare, duke pasqyruar një përpjekje të guximshme për ruajtjen e sovranitetit dhe për t'u përballur me sfidat e jashtme.

Figura 22: Xhamia në Talinoc të Muhaxhirëve ku ishte vendosur Komiteti Qarkor i Feirzaj i Lidhjes II të Prizreni

Lufta Kundër 'Aleancës Nazifashiste' – 1941-1944 (Gjermania, Italia dhe Bullgaria)

Në vitin 1941, trojet shqiptare u ndanë në tri zona kontrolli: gjermane, italiane dhe bullgare. Ndërkohë, shqiptarët filluan të organizojnë rezistencën e tyre kundër pushtimit, veçanërisht në Kosovë, e cila ishte nën

sundimin bullgar. Rezistenca kundër aleancës nazifashiste u zhvillua gjithashtu nga Lëvizja Antifashiste, e udhëhequr nga Partia Komuniste Jugosllave. Nëpërmjet komunistëve shqiptarë, pushtuesit serbë synonin të shfrytëzonin shqiptarët për të përzënë pushtuesit fashistë, me qëllim të dobësimit të Shqipërisë dhe popullit shqiptar.

Hafiz Ymeri, duke ruajtur idealet politike për një Shqipëri etnike, e refuzoi hapur linjën e Luftës Nacionalçlirimtare Antifashiste të drejtuar nga komunistët. Ai shprehu pakënaqësi ndaj bashkëpunimit të disa qarqeve me komunistët serbë, maqedonas dhe malazezë, duke e parë atë si një tradhti ndaj interesave kombëtare shqiptare. Siç thekson Prof. Muhamet Pirraku: "Hafiz Ymeri vazhdonte me idealet politike të popullit shqiptar – për Shqipërinë etnike. Nuk e pëlqeu linjën e Luftës Nacional Çlirimtare Antifashiste të drejtuar prej komunistëve dhe haptazi shprehu indinjatën ndaj bashkëpunimit të disa qarqeve me komunistët serbë e maqedonas" (Pirraku, 1992).

Ky qëndrim i Hafiz Ymerit pasqyroi një lexueshmëri të thellë të zhvillimeve globale, duke ndjekur një linjë rezistence të pavarur kundër të gjithë pushtuesve. Ai, ashtu si shumë intelektualë shqiptarë, nuk preferoi "pushtues të preferuar", por luftoi kundër çdo fuqie që kërcënonte tokat shqiptare dhe kombin shqiptar. Kjo qasje e tij mbështetej edhe nga figura të tjera të rëndësishme të kohës, si Mulla Idriz Gjilani, i cili në një

takim me përfaqësuesin e komunistëve shqiptarë Fadil Hoxha në vitin 1942 deklaroi: "Shqiptari nuk mund të çlirohet pa u mbështetur në forcat ndërkombëtare demokratike, por kurrë nuk do të fitojë liri duke u mbështetur në fqinjët tradicionalë të Shqipërisë Etnike, e aq më pak duke u mbështetur në komunistët serbë dhe çetnikët" (Pirraku, 1995/2017).

Roli i Hafiz Ymerit në rezistencën kundër fashizmit përmendet gjithashtu nga Abdullah Musliu në ditarin e tij. Në pozicionin e tij si kryetar i Komunës së Talinofcit, ai nisi organizimin e celulave të partisë, përfshirë figura të tilla si Halit Ibishi dhe Tafik Çanga. Musliu thekson se Hafiz Ymeri, Musli Sojeva dhe Isak Biba ishin ndër ata që morën pjesë në organizimin e komiteteve të vendit, duke i përgatitur shqiptarët për largimin e pushtuesve gjermanë: "Këto përgatitje ishin shumë të nevojshme para se me u tërhiq gjermanët. Qëllimi im ishte që me largimin e gjermanëve ne të zbresim prej maleve nëpër qytete" (Musliu, 2016).

Megjithëse nuk i përkrahte ideologjitë komuniste, Musliu kritikonte moralin dhe ateizmin e tyre, duke i quajtur "të dëgjueshëm që nuk mendonin me kokë të vet" dhe "truri i gipsuar" (Musliu, 2016). Këto kritika theksojnë shqetësimet e vazhdueshme të elitave shqiptare për rrezikun që komunizmi dhe fqinjët sllavë paraqisnin për të drejtat dhe lirinë e shqiptarëve.

Një dokument sekret i CIA-s konfirmon këto shqetësime, duke përmendur rolin e Koci Xoxes, një serbofil, në përndjekjen e nacionalistëve kosovarë: "Në Shqipërinë komuniste, Koci Xoxe, një serbofil, ishte përgjegjës për marrëdhëniet e jashtme me Jugosllavinë. Servilizmi që ai dhe ndihmësit e tij treguan në arrestimet dhe torturat e nacionalistëve kosovarë i habiti edhe vetë jugosllavët" (Mehmetaj & Haxhiu, 2022). Hafiz Ymeri ishte i lidhur me figurën e Ramë Bllacës, për të cilin kishte thurur edhe një poezi, duke përkujtuar qëndrimin e tij të pathyeshëm. Dokumenti i CIA-s përmend edhe rastin e Ramë Bllacës dhe shumë nacionalistëve të tjerë shqiptarë që u arrestuan dhe iu dorëzuan autoriteteve jugosllave për t'u gjykuar e dënuar (Mehmetaj & Haxhiu, 2022).

Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore – 1941

Hafiz Ymer Shemsiu, së bashku me Mulla Vesel Guta dhe hoxhallarë të tjerë nga Ferizaj, luajtën një rol kyç në mbrojtjen e kufijve të Kosovës Lindore gjatë viteve të vështira të pushtimit. Ata, përveçse ishin intelektualë të përkushtuar, morën pjesë aktive në luftëra të drejtpërdrejta, duke i udhëhequr shqiptarët në betejat që synonin mbrojtjen e trojeve etnike. Në rastet kur lufta ishte e pashmangshme, këta prijës fetarë dhe kombëtarë jo vetëm që motivonin popullin, por edhe angazhoheshin vetë në front.

Një moment kyç gjatë këtyre viteve ishte përballja me stuhinë e fuqishme që kërcënonte kufijtë shqiptarë të Kosovës Lindore. Mulla Ymer Shemsiu ishte ndër figurat më të rëndësishme, duke marrë pjesë si ushtar vullnetar për të mbrojtur tokat nga pushtuesit. Siç përshkruan Prof. Muhamet Pirraku: "Mulla Ymer Shemsiu, së bashku me më shumë se 20 imamë, përfshirë Mulla Idriz Gjilanin si komandant, Mulla Ramadan Ahmetin dhe Mulla Vesel Xheladin Gutën, luftuan për mbrojtjen e kufijve të Kosovës Lindore" (Pirraku, 1995).

Kjo angazhim i përbashkët i prijësve fetarë dhe intelektualë dëshmon për rolin e tyre të dyfishtë – si udhëheqës shpirtërorë dhe mbrojtës të tokave shqiptare, të cilët nuk hezituan të marrin armët për të ruajtur lirinë dhe integritetin kombëtar.

Lufta e Ferizajt – 1944

Lufta e Ferizajt është një nga ngjarjet më pak të ndriçuara në historinë shqiptare, një betejë që deri më sot ka mbetur jashtë vëmendjes së duhur historike dhe akademike. Mbase, me kohë, kjo ngjarje mund të përfshihet më gjerësisht në programe shkollore dhe zyrtare, duke u masivizuar në kujtesën kolektive. Fillimi i rezistencës kombëtare shqiptare kundër ripushtimit sllavo-komunist nisi me formimin e grupeve të para të rezistencës në dhjetor të vitit 1944 (Buxhovi, 2015).

Lufta u zhvillua më 2 dhjetor 1944 dhe përmendet edhe në raportin top-sekret të CIA-s të vitit 1953, i deklasifikuar pjesërisht në vitin 2011, ku përshkruhet se situata e kosovarëve gjatë viteve 1944-1948 ishte jashtëzakonisht e rëndë, duke pasur si alternativa vetëm burgun, vetëvrasjen, ose nënshtrimin ndaj regjimit komunist dhe sllav (Mehmetaj & Haxhiu, 2022).

Ferizaj ishte një nga qytetet e para shqiptare në ish-Jugosllavi, dhe madje edhe në Evropë, që ngriti armët kundër vendosjes së regjimit çetnik-komunist në Kosovë. Hafiz Ymer Shemsiu ishte një ndër intelektualët që vepruan kundër komunizmit, i cili po kërcënonte qenien shqiptare në mënyrë më të rrezikshme sesa pushtuesit e huaj. Sipas studiuesve, ai ishte aktiv në rezistencën kundër komunizmit dhe, pas marrjes së pushtetit nga forcat partizane-komuniste, u izolua dhe përndoq nga regjimi. Në maj të vitit 1945, ai ndërroi jetë në mjerim, në kushte të rënda izolimi (Yvejsi, 2010; Pirraku, 1992).

Regjimi komunist i instaluar pas luftës, sidomos në Kosovë, përbëhej nga elementë serbë dhe shqiptarë, të cilët përdornin të njëjtat metoda të dhunës dhe represionit. Një shembull i tmerrshëm i kësaj periudhe është vrasja e "Vëllezërve Maçastena" (Selimi, Bajrami dhe Hamdiu), të pushkatuar nga Fadil Hoxha në Ferizaj (Berisha, 2016). Gjatë këtyre viteve, numri i të burgosurve shqiptarë ishte trefish më i madh sesa ai i serbëve.

Hafiz Ymeri, i vetëdijshëm për synimet serbe dhe manipulimin e komunistëve shqiptarë nga fqinjët sllavë, mbante takime të rregullta me popullin, duke mbajtur fjalime dhe lexuar poezi patriotike. Ai i ftonte bashkatdhetarët të mbronin kufijtë shqiptarë nga rreziku i propagandës komuniste sllave. Hafiz Ymeri angazhoi dy djemtë e tij të birësuar, Faikun dhe Jusufin, në Lëvizjen e Rezistencës: Faiku u dërgua në viset e Pejës dhe Rugovës për të mbrojtur tokat shqiptare, ndërsa Jusufi u angazhua në njësitë e "Shtabit Suprem të Kosovës" të drejtuar nga Adem Gllavica dhe Mulla Idriz Gjilani, miq të ngushtë të Hafiz Ymerit (Pirraku, 1992).

Vlen të përmendet se vetëm në pranverën e vitit 1945, regjimi komunist vrau rreth 40,000 shqiptarë nën pretekstin se ishin "antikomunistë" dhe të "shitur në perëndim" (KultPlus, 2019). Hafiz Ymeri ishte një nga viktimat e këtij represioni të egër, si dhe shumë hoxhallarë të tjerë që rezistuan ndaj politikave komuniste. Pushteti komunist, përveçse i vrau dhe i persekutoi, synonte të ndryshonte thellësisht ndërgjegjen e shqiptarëve duke u përpjekur të largonte popullin nga feja dhe të demonizonte figurat e hoxhallarëve, të cilët ishin ndër pengesat kryesore për përhapjen e ideologjisë së re.

Ndër hoxhallarët e vrarë gjatë kësaj periudhe ishte edhe Adem Guta, vëllai i Mulla Vesel Gutës, i cili u ekzekutua në mënyrë brutale në shkurt të vitit 1945, pasi u akuzua për propagandë kundër "vëllazërim-bashkimit"

shqiptaro-serb dhe për dhunë ndaj serbëve (Berisha, 2016). Siç theksonte vetë Adem Guta: "Me komunistët e çetnikët serbë e kam lehtë, por nga bashkëpunëtorët e tyre shqiptarë nuk mund ta sigurojë qetësinë dhe ardhmërinë e shqiptarisë së vendit"

Vetëm 50 vjet jetë, mbi 30 vjet në shërbim të njerëzores dhe të shqiptares

Që nga ardhja e Hafiz Ymer Shemsiut në Ferizaj në vitin 1915, ku filloi angazhimin e tij në Mejtepin e qytetit së bashku me Haxhi Pllanën, e deri në vdekjen e tij tragjike në vitin 1945, ai shërbeu për më shumë se 30 vite në kauzën shqiptare dhe në zhvillimet kombëtare në këtë pjesë të Kosovës. Hafiz Ymeri u bë një figurë e pandashme e çdo nisme dhe ngjarjeje që shërbente interesave kombëtare të shqiptarëve në Ferizaj. Ai nuk qëndroi kurrë larg proceseve vendimtare për shoqërinë shqiptare; përkundrazi, ishte gjithmonë në qendër të veprimeve si iniciator, motivues dhe pjesëmarrës aktiv. Qoftë në aspektin arsimor, kulturor, politik apo fetar, Hafiz Ymeri udhëhoqi dhe frymëzoi breza të tërë në shërbim të një ideali të përbashkët: ruajtjen dhe mbrojtjen e identitetit kombëtar shqiptar.Përkushtimi i tij nuk u kufizua vetëm në organizata apo nisma të veçanta, por shtrihej në çdo fushë të mundshme, duke i dhënë formë dhe energji rezistencës shqiptare në Ferizaj. Me ndikimin e tij të fuqishëm si intelektual, udhëheqës fetar dhe

patriot, Hafiz Ymeri u bë një simbol i qëndresës dhe i përkushtimit ndaj kauzës së popullit shqiptar.

Kapitulli V

Shkollari dhe teologu shembull

Xhamia e vjetër fshatit Talinoc ku ka shërbyer Hafiz Ymeri.

Angazhimi si Imam

Veprimtaria e Hafiz Ymerit ishte tërësisht e orientuar drejt shërbimit fetar dhe atdhetar. Ai, si edhe shumë shkollarë të kalibrit të tij, e shihte angazhimin në shërbim të shoqërisë si një përmbushje të detyrës së tij fetare. Hafiz Ymeri e kuptonte se Islami nuk kufizohej brenda mureve të xhamive, por përfshinte çdo aspekt të jetës. Ai besonte se gjithçka që bënte në dobi të shoqërisë përbënte një akt të devotshëm dhe të përshpirtshëm, duke ndjekur filozofinë e gjerë të Islamit që çdo veprim të dobishëm e konsideron pjesë të fesë.

Hafiz Ymeri, përmes shërbimit të tij fetar, ka treguar se të kuptuarit e Islamit nuk është vetëm çështje e njohurive teorike, por mbi të gjitha e aftësisë për ta përjetuar dhe zbatuar atë në çdo fushë të jetës. Ai ishte një shembull i gjallë i një teologu të përkushtuar, i cili ndante diturinë e tij me të tjerët në mënyrën më të dobishme. Veprimtaria e tij dëshmon për një figurë të jashtëzakonshme në jetën intelektuale dhe fetare të Ferizajt, e cila ka lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e këtij qyteti.

Hoxhë në Xhaminë e Talinocit të Muhaxhirëve

Hafiz Ymeri ka shërbyer si imam në xhaminë e fshatit Talinoc të Muhaxhirëve dhe në mejtepin e fshatit Sazli, veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit. Në këtë xhami, ku gravitonin besimtarë nga fshatrat përreth si Sazli, Bibaj,

Pojatë, Softaj, dhe Papazë, ai shërbeu me përkushtim të jashtëzakonshëm. "Me përkrahjen e Haxhi Pllanës, Hafiz Ymeri filloi aktivitetin e tij në xhaminë e Talinocit në fund të viteve '20-ta" (Pirraku, 1992).

Shërbimi si imam e vendosi Hafiz Ymerin në qendër të komunitetit, ku ai luante rolin e udhëheqësit fetar, por edhe atë të mësuesit dhe këshilltarit. Puna e tij përfshinte jo vetëm kryerjen e ritualeve fetare, por edhe arsimimin e të vegjëlve dhe të rriturve në gjuhën shqipe, në mënyrë të organizuar. "Hafiz Ymeri ishte i përkushtuar ndaj mësimit të gjuhës shqipe dhe ndaj veprimtarisë atdhetare, duke punuar pandërprerë për çështjen kombëtare" (Musa Kraja, 2016). Pirraku e përforcon këtë përshkrim duke theksuar: "Në detyrën e imamit, Hafiz Ymeri u dallua për zotësinë, autoritetin dhe shkathtësinë e tij"(Pirraku, 1992).

Imamët e kohës si Hafiz Ymeri zotëronin një autoritet të padiskutueshëm në komunitet, duke u respektuar për dijet dhe udhëzimet e tyre të urta. Në "Ditarin" e tij, patrioti ferizajas Abdullah Musliu përmend se gjatë periudhës kur shërbente si kryetar i Komunës së Talinocit, kishte përzgjedhur Hafiz Ymerin si anëtar të Pleqësisë së Komunës. "Të gjithë anëtarët e pleqësisë betoheshin në Kuran, nën udhëheqjen e Hafiz Ymerit, duke premtuar se nuk do të pranonin ryshfet dhe se do të punonin drejt pa hile" (Musliu, 2016).

Në xhematin e Hafiz Ymerit kishte individë që angazhoheshin jo vetëm në jetën fetare, por edhe në atë politike e kulturore, duke e mbështetur atë në përpjekjet e tij për arsimin e rinisë dhe për lëvizjen kombëtare. "Xhemati i tij ishte shumë aktiv në veprimtarinë e Xhemijetit dhe arsimimin ilegal të rinisë në gjuhën shqipe" (Pirraku, 1992).

Historiku i Xhamisë së Talinocit të Muhaxhirëve

Xhamia e Talinocit u ndërtua në vitin 1906, sipas Hetemit dhe Mustafit, megjithëse Katalogu i Muzeut të Ferizajt e daton ndërtimin e saj në vitin 1908. Këto diferenca të vogla mund të lidhen me periudhat e ndërtimit dhe fillimit të funksionimit të xhamisë. Për studiuesit e ardhshëm, burimet e para historike janë më të sigurta për të përcaktuar datën e saktë të themelimit.

Figura 23: Interieri i Xhamisë së vjetër në fshatin Talinoc i Muhaxhirëve

Kjo xhami ishte një qendër e rëndësishme për komunitetin lokal dhe "në të është formuar një Komitet i Komitetit të Kosovës"(Pirraku, 1992). Imamët në këtë xhami, përveç udhëheqjes fetare, shërbenin edhe si mësimdhënës dhe ligjërues. Hafiz Ymeri, përveç këtyre detyrave, ndihmonte në arsimimin dhe ndërgjegjësimin kombëtar të rinisë shqiptare.

Fakti që besimtarët gravitonin në xhaminë e Talinocit nga fshatrat përreth, tregon se shërbimi dhe reputacioni i Hafiz Ymerit ishin të njohur dhe të respektuar. "Xhamia e Talinocit mbeti një qendër e rëndësishme e jetës fetare dhe kombëtare falë përkushtimit dhe punës së palodhur të Hafiz Ymerit" (Musa Kraja, 2016).

Në xhaminë e Talinocit, Hafiz Ymeri jo vetëm që ndihmoi në udhëheqjen fetare, por edhe në edukimin e gjeneratave të reja me një ndjenjë të fortë të përkatësisë kombëtare dhe atdhedashurisë. "Ai ishte një figurë qendrore në luftën për ruajtjen e identitetit kombëtar dhe fetar të shqiptarëve, duke shfrytëzuar çdo mundësi për të edukuar rininë dhe për të mbrojtur gjuhën dhe kulturën shqiptare" (Pirraku, 1992).

Angazhimi i Hafiz Ymerit si imam dhe mësues i fesë dhe gjuhës shqipe tregon për një figurë të fuqishme intelektuale dhe shpirtërore që ndikoi thellë në jetën e komunitetit të tij. Ai ishte një shembull i shkëlqyer i përkushtimit ndaj fesë dhe kombit, duke i shërbyer popullit të tij jo vetëm në aspektin fetar, por edhe atë

arsimor e kombëtar. "Në xhaminë e tij, Hafiz Ymeri krijoi një frymë bashkëpunimi dhe përkushtimi, duke e bërë atë një qendër të jetës fetare, kombëtare dhe kulturore të Ferizajt" (Musa Kraja, 2016).

Historiku i fshatit Salzli

Në juglindje të Kosovës, ndodhet fshati Sazli, i cili gjendet në zemër të komunës së Ferizajt. Ky pozicion gjeografik ka ndikuar që fshati Sazli të shëndrrohet në qendër të rëndësishme për bujqësi, kulturë, art dhe arsim.

Fshati është i vendosur në një rreze malore dhe ka një peizazh të bukur natyror. Me këtë pozitë, Sazli ka një klimë të favorshme, duke ofruar mjedisin e përsosur për kultivimin e tokave bujqësore dhe zhvillimin e bimësisë. Toka e pasur me resurse dhe kujdesi i bujqve të zonës kanë bërë që Sazli të njihet për prodhimin e lartë të ushqimit të freskët dhe cilësisë së tij.Përveç potencialeve bujqësore, pozita e Sazlit është gjithashtu e rëndësishme për zhvillimin urbanistik dhe ekonomik të komunës së Ferizajt. Aksesibiliteti i lehtë nga qyteti i Ferizajt dhe zonat përreth krijon mundësi për investime të ndryshme, duke përfshirë industrinë dhe shërbimet.

Emërtimi i fshatit mendohet se vjen nga emri Saz dhe origjina e këtij emërtimi shkon deri në shekullin XIII sipas studiuesit Jusuf Osmani (Osmani, 2004) që është nga

historanët dhe njohësit më të mirë të historikut të vendbanimeve kosovare.
Në aspektin historik, fshati Sazli është njohur si një vendbanim në cilin banorët kanë konservuar traditat dhe zakonet e tyre. Monumentet kulturore dhe bukuritë natyrore rrethuese bëjnë që ky fshat të jetë një destinacion i preferuar për turistë dhe për ata që dëshirojnë të njohin pasurinë kulturore të zonës.

Pozita gjeografike e fshatit Sazli në Komunën e Ferizajt e bën atë një qendër e rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë lokale, kultivimin e bujqësisë dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Fshati Sazli përbën një mrekulli natyrore ashtu siç njihet për histori të pasur të kontributit dhe traditave!

Angazhimi si mësimdhënës i mësimeve për fenë

Në veprimtarinë e tij si mësimdhënës fetar, Hafiz Ymeri ngriti një shkollë pranë xhamisë, e cila u shërbente qytetarëve të moshave të ndryshme. Shkolla e tij nuk ishte thjesht një vend ku transmetoheshin njohuri fetare; ajo përfaqësonte një vizion të gjerë edukativ që përfshinte elemente të arsimit modern dhe kombëtar. Si ligjërues fetar, ai nuk ofronte vetëm predikime teorike, por demonstronte Islamin në praktikë, duke frymëzuar dhe aktivizuar komunitetin e tij për t'u angazhuar në jetën sociale dhe kombëtare.

Xhemati që ai edukoi u bë bartës i proceseve më të rëndësishme arsimore dhe kombëtare në zonë, veçanërisht në luftën kundër pushtuesve bullgarë dhe në përpjekjet për mbrojtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare**.** "Më 1934, xhemati i Sazlisë dhe i fshatrave përreth ia ngritën një dhomë për mejtep për fëmijë meshkuj dhe femra. Ky mejtpe do të punojë deri më 1941, deri në shpartallimin e Jugosllavisë versajase. Mejtepi i Sazlisë përgatiti kuadër për aktivitete kulturore e kombëtare të gjithanshme. Në shkollë, krahas mësimeve fetarezhvilloi edhe njohuri mësimore nga shkencat ekzakte, natyrore e historike" (Pirraku, 1992).

Krahas punës në xhaminë e Talinovcit dhe mejtepit të Sazlisë, Hafiz Ymeri ishte i angazhuar edhe si mësimdhënës në Mejtepin e Ferizajt, i cili ishte themeluar nga daja i tij, Haxhi Pllana. Ky mejtep ishte një tjetër vatër e rëndësishme e edukimit fetar dhe kombëtar në rajon, ku Hafiz Ymeri luajti një rol qendror. Përfshirja e tij në këto institucione arsimore jo vetëm që dëshmonte përkushtimin e tij në fushën e arsimit, por edhe përhapjen e ndikimit të tij në komunitet dhe përtej tij.

Mësimdhënës në xhaminë e Talinovcit dhe mejtepin e Sazlisë

Hafiz Ymeri filloi punën e tij si mësimdhënës në xhaminë e Talinovcit, ku mësonte nxënësit e fshatit për njohuritë fetare dhe leximin e Kuranit. Më pas, ai ngriti mejtepin e Sazlisë, ku përveç mësimeve fetare, u jepte nxënësve njohuri nga shkencat ekzakte, natyrore dhe historike. **"**Ai

tregoi që ishte një mësimdhënës më shumë se profesional" (Yvejsi, 2010). Ky përkushtim tregon se Hafiz Ymeri ishte një edukator i përkushtuar që shihte rëndësinë e formimit të gjeneratave të reja jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në aspektet shkencore dhe kombëtare.

Një nga tiparet e veçanta të metodologjisë së tij mësimore ishte përfshirja e arteve në edukim. Hafiz Ymeri kishte një shije të thellë për letërsinë dhe muzikën, dhe këto elemente i përdorte në mësimdhënie për të bërë procesin edukativ më tërheqës për nxënësit e tij. Ai i inkurajonte nxënësit të këndonin këngë me motive morale, etike dhe kombëtare, duke përfshirë artin në edukimin e përditshëm. Ky qasje e tregonte jo vetëm si një mësimdhënës të aftë, por edhe si një edukator inovativ që kuptonte rëndësinë e artit dhe kulturës në formimin e karakterit të nxënësve të tij.

Përmes aktiviteteve të lira, Hafiz Ymeri arrinte të bënte mësimin më të dashur për nxënësit e tij, duke i ndihmuar ata të zhvillonin një dashuri të veçantë për diturinë dhe edukimin. "Edhe pse në rrethana të vështira, pranë këtyre mejtepeve u edukuan gjenerata të fuqishme që do t'i shërbenin kauzës Islame, por edhe asaj shqiptare" (Pirraku, 1992).

Një model edukimi gjithëpërfshirës

Në periudhën kur vepronte Hafiz Ymeri, konceptet si laicizmi dhe sekularizmi nuk ishin ende të përhapura në shoqërinë shqiptare. Në atë kohë, mësimi i fesë dhe mësimi i shkencave ekzakte apo shoqërore nuk shiheshin si të ndara. Ky model edukimi, ku bashkëjetonin njohuritë fetare dhe ato shkencore, përfaqëson një qasje të thellë dhe gjithëpërfshirëse ndaj formimit të njeriut.

Gjeneratat që dolën nga shkolla e Hafiz Ymerit janë dëshmi e suksesit të këtij modeli edukativ. "Gjenerata të tëra të edukuara me sistemin shkollor të asaj kohe do të shihen si modele edhe për gjeneratat vijuese" (Pirraku, 1992). Në një kohë kur shkolla të tjera po privonin nxënësit nga njohuri të cilat orientojnë dhe formojnë vlerat shpirtërore, shkolla e Hafiz Ymerit ishte një shembull i një institucioni që krijonte individë të aftë të përballeshin me sfidat e jetës me një formim të plotë moral, intelektual dhe kombëtar.

Për këtë arsye, shkolla e Hafiz Ymerit duhet të shihet si një model për sistemin modern të arsimit. Ajo përfaqëson një shkollë që integron të gjitha fushat e dijes dhe që përpiqet të zhvillojë të gjithë dimensionet e individit – nga ai shpirtëror dhe etik, deri te ai shkencor dhe kombëtar. “Shkolla e Hafiz Ymerit duhet të shihet vazhdimisht si një model i një shkolle moderne me njohuri gjithëpërfshirëse” (Pirraku, 1992).

Në përfundim, Hafiz Ymeri nuk ishte vetëm një imam apo mësimdhënës fetar, por një vizionar që ndihmoi në formimin e një gjenerate të tërë që shërbeu për të mbrojtur dhe zhvilluar kombin shqiptar. Ai përfaqëson një figurë të rrallë të cilën historia shqiptare duhet ta mbajë mend për kontributet e tij të mëdha në fushën e arsimit dhe të fesë.

Edukimi kombëtar në xhami

Hafiz Ymeri përfaqësonte një model të rrallë të një dijetari fetar që kishte kuptuar thellë fushëveprimin e gjerë të fesë dhe rolin që ajo mund të luajë në jetën kombëtare dhe shoqërore. Ai nuk e shihte fenë të ndarë nga përpjekjet për të çuar përpara edukimin dhe zhvillimin kombëtar, por si një mjet që ndihmonte në forcimin e identitetit dhe vlerave shqiptare. Angazhimi i tij fetar nuk kufizohej në predikime të zakonshme, por përfshinte një vizion të gjerë që lidhte jetën shpirtërore me atë kombëtare. "Gjithçka që kishte bërë, e kishte bërë nga njohja e thellë por edhe të kuptuarit e drejt të fesë" (Pirraku, 1992). Ai kishte një kuptim të thellë të fesë Islame, jo vetëm si sistem besimi, por edhe si një mënyrë për të organizuar dhe ngritur shoqërinë.

Sipas mësimeve të Islamit, të kuptuarit e fesë është një dhuratë e veçantë që i dhurohet atij që Zoti dëshiron, dhe Hafiz Ymeri ishte padyshim një prej atyre individëve të zgjedhur që kishin përvetësuar jo vetëm njohuri të gjera,

por edhe aftësinë për të kuptuar thelbin e fesë. Siç sqarohet brenda shpjegimeve fetare, "njerëzit mund të dinë sasi të mëdha njohurish për fe, por mund të mos e kuptojnë fenë". Për Hafiz Ymerin, ky kuptim i thellë i fesë Islame e bënte atë të aftë të përdorte dijet e tij për të fuqizuar komunitetin dhe për të lidhur vlerat fetare me ato kombëtare.

Figura 24 Takimi me Haxhi Nazim Malokun ish nxënës i Hafiz Ymerit

Hafiz Ymeri ishte gjithashtu një figurë me ndikim të gjerë në shoqëri. "Ishte shumë i përfillur, i konsultushëm, i gjallë, shumë i mprehtë nga mendja dhe investim në çdo hap, në çdo veprim. Lexonte shumë, shënonte ngjarjet që i përjetonte populli shqiptar, informonte veprimtaritë e

Komitetit të Kosovës dhe të Xhemietit, bashkëpunonte me Lëvizjen Kaçake Kombëtare, e ndihmonte atë, këndonte këngë historike duke ipërcjellë me çifteli, shkruante poezi historike në frymën plotësisht popullore dhe poezi moralizuese fetare, ilahi" (Pirraku, 1992). Ky përshkrim e vendos Hafiz Ymerin në radhët e figurave që përmes veprimtarisë së tyre intelektuale, fetare dhe kulturore kanë luajtur një rol vendimtar në mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar shqiptar.

Kujdesi për Kuranin

Si hafiz i Kuranit, Hafiz Ymeri i kushtoi një kujdes të veçantë mësimit të Kuranit dhe përhapjes së njohurive fetare. Edukimi i brezave të rinj përmes mësimit të Kuranit ishte një ndër objektivat kryesore të tij. Ai zhvillonte programe ku qindra ferizajas dhe jo ferizajas mësonin artin e leximit të bukur të Kuranit. Por më shumë se kaq, Hafiz Ymeri ishte njohës i thellë i përmbajtjes së teksteve fetare, duke pasur një kuptim të veçantë për mesazhet e Kuranit**.** "Përveç aspekteve si 'Artit të Leximit të Bukur të Kuranit', ku në programet e tij kishin mësuar leximin e Kuranit me qindra ferizajas e jo ferizajas, Hafizi si njohës i thellë i shumë shkencave dhe gjuhëve kishte të kuptuar të veçantë të përmbajtjes së teksteve fetare dhe kuranore dhe fetare në përgjithësi" (Pirraku, 1992). Ky aftësi e tij për të integruar studimin e thellë të fesë me mësimdhënien e përditshme bën që ai të

ketë një ndikim të jashtëzakonshëm në formimin e gjeneratave të reja.

Figura e Hafiz Ymerit ishte aq ndikueshme, sa që nga duart e tij dolën disa nga intelektualët më të shquar të Ferizajt. "Ai i prodhoi gjeneratën më të shkëlqyer të shqiptarëve në Ferizaj". Nëse imagjinojmë se Ferizaj nuk do të kishte figura si Hafiz Ymeri, Mulla Veseli, Haxhi Pllana apo Adem Guta, është e vështirë të mendosh si do të kishte ruajtur qyteti identitetin e tij në kohët e vështira të regjimit komunist. Falë kthjelltësisë së tyre dhe angazhimit të vazhdueshëm për të mbajtur gjallë "shqiptarinë", Ferizaj arriti të ruajë frymën e vet kombëtare dhe të qëndrojë i lidhur me vlerat e tij tradicionale deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës në vitin 1999, falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Hafiz Ymeri përfaqëson një nga ato figura të rralla që jo vetëm i kanë përkushtuar jetën e tyre fesë, por e kanë përdorur atë si një platformë për të forcuar dhe ruajtur identitetin kombëtar shqiptar. Përmes angazhimit të tij në arsim, kulturë dhe fe, ai ka lënë një trashëgimi të vyer që meriton të vlerësohet dhe të studiohet më thellë nga gjeneratat e ardhshme.

Vdekja e Hafiz Ymerit – 1945

Një ditë e ftohtë dimri, në nëntor të vitit 1944, shenjat e para të lodhjes dhe sëmundjes nisën të shfaqeshin tek Hafiz Ymeri. Ishte vetëm 49 vjeç, por koha, lufta dhe vuajtjet i kishin rënduar shpirtin dhe trupin. Një burrë që kishte përballuar dekada dhimbje, sfida e tradhti, tashmë ndiente se trupi i tij po dorëzohej. Megjithatë, ai nuk u dorëzua kurrë shpirtërisht. Zemra e tij e mbushur me dashuri për popullin dhe atdheun nuk rreshti kurrë së rrahuri për drejtësinë.

Ai e dinte që lufta për të cilën kishte dhënë gjithçka po merrte një drejtim të rrezikshëm. Fitorja e të ashtuquajturës "Luftë Nacionalçlirimtare Serbo-Shqiptare" ishte, në sytë e tij, një mashtrim i dhimbshëm. **"**Një thyerje të madhe ndjeu nga fitorja e të ashtuquajturës 'Luftë Nacionalçlirimtare serbo-shqiptare'**"** (Pirraku, 1992). Mashtrimi i "vëllazërim-bashkimit" me Serbinë ishte një plagë që i rëndonte jo vetëm trupin, por edhe shpirtin.

Dy djemtë e tij të birësuar, Faiku dhe Jusufi, gjithashtu kishin ndjekur rrugën e lirisë, duke luftuar për komb dhe për të ardhmen e shqiptarëve. Si një baba që i kishte edukuar me dashuri për atdheun dhe fenë, Hafiz Ymeri ndiente shqetësimin dhe vuajtjen për fatin e tyre. Faiku ishte plagosur në frontin e Sarajevës dhe ishte kapur rob nga gjermanët, për t'u internuar më pas në kampin e

tmerrshëm të Jasenovcit. "Faiku... ishte kapur prej gjermanëve dhe ishte internuar e izoluar... do të vdesë si invalid i rëndë në vitin 1947" (Pirraku, 1992). Ndërsa Jusufi, kishte luftuar në betejën e Ferizajt, ku kishte humbur njërin sy dhe kishte mbetur invalid përjetë. "Jusufi... u plagos në kokë dhe mbeti invalid i përjetshëm, pa njërin sy". Të dy djemtë e tij të birësuar ishin një kujtim i gjallë i sakrificave të pafundme që familja e tij kishte bërë për lirinë e Kosovës.

Vuajtja e Hafiz Ymerit, megjithatë, nuk përfundoi këtu. Duke ndjerë presionin e regjimit të ri komunist, ai u detyrua të tërhiqej nga jeta publike dhe të kalonte në ilegalitet. "Hafiz Ymeri... ishte kundërshtar i forcave partizane-komuniste, ndërsa ishte përkrahës i forcave kombëtare nacionaliste" (Yvejsi, 2010). Ai shkoi në Prishtinë dhe gjeti strehë te fëmijët e vëllezërve të tij dhe te i biri i Haxhi Pllanës, por sëmundja e tij tashmë kishte marrë përmasa të mëdha. Tuberkulozi e kishte shtrirë, ndërsa mjekimet e dr. Daut Mustafës, të cilin Hafizi e njohu si një familjar dhe mjek i përkushtuar, nuk mjaftonin më. "Me që ishte i shtruar kushteve jo normale të jetës, fitoi sëmundjen e TBC-ës" (Pirraku, 1992).

Në mars të vitit 1945, ai vendosi të kthehej në Sazli, në vendin që ai e quante shtëpi, për të kaluar ditët e fundit mes familjes dhe njerëzve të tij. Por kjo paqe nuk zgjati. Një natë të ftohtë dhe me acar, një njësi ushtarake komunistësh ndëshkues erdhi në shtëpinë e tij. Hafiz Ymeri, i sfilitur nga sëmundja, por i pathyer nga shpirti,

u detyrua të largohej nga shtëpia vetëm me këmishë e pizhame, për t'u strehuar nën një peregjare, nën barrela. "Aty qëndroi mbi 15 orë, pa lëvizur" (Pirraku, 1992). Një situatë që përkeqësoi më tej gjendjen e tij shëndetësore.

Nën ftohtësinë dhe vuajtjet e atyre orëve të fundit, Hafiz Ymeri filloi të ndiente që koha e tij në këtë botë po mbaronte. Trupi i tij po dorëzohej, por mendja dhe zemra e tij vazhdonin të mendonin për popullin e tij, për kauzën e lirisë që ai kishte mbrojtur me gjithë fuqinë e shpirtit. Ai e dinte se nuk kishte dhënë gjithçka që mund të jepte, por në fund të fundit, ai kishte dhënë më të shtrenjtën: pasurinë, familjen dhe, mbi të gjitha, jetën e tij.

Në fillim të majit të vitit 1945, në moshën pesëdhjetë vjeçare, Hafiz Ymeri ndërroi jetë. Ai iku në heshtje, larg skenës publike, në mes të vuajtjeve dhe mjerimit të një regjimi që e kishte përndjekur. Por asnjëherë nuk u largua nga kjo botë pa lënë pas një testament të fuqishëm për gjeneratat e ardhshme. Në çastet e tij të fundit, ai shqiptoi fjalët e fundit për popullin e tij: **"Lamtumirë, o populli im! Për ty dhashë atë që mund ta jepja: pasurinë, familjen, jetën. Për ty do të vijnë ditë të mira ...!"** (Pirraku, 1992).

Hafiz Ymeri u varros në varrezat e fshatit Sazli, në Ferizaj, ku prehet në paqe, por emri i tij vazhdon të jetojë në kujtesën e një populli që ai e donte më shumë se jetën e tij. Ai nuk ishte vetëm një njeri i besimit, një poet apo një mësues. Ai ishte një simbol i guximit, i sakrificës dhe

i përkushtimit për një ideal të madh – lirinë dhe dinjitetin e popullit të tij. Dhe, megjithëse koha e tij në këtë botë mbaroi, mesazhi i tij i dashurisë për atdheun dhe lirinë mbetet i përjetshëm, i gdhendur në zemrat e shqiptarëve.


VEPRAT
HAFIZ YMER SHEMSIU



''Nazim Gafurri''

(Poemë)

Nazim Gafurri

Kur na erdha e para Serbi,
Ç'na ngushton ket' zezë Shqipni
Ka tridhjetë n'batare i ka shti.
Ka tridhjetë po i shtjen n'batare,
Don Shqiptartë mej qitë fare
Kurrnji burrë s'don me lanë,
Poj plaçkitë po çka p'u gjanë.
Jau merr loptë e dhetë, e dhitë
S'don me i lanë kurrë me i çelë sytë.
Serbija s'pari k'shtu ka punue;
Don Shqiptartë me i trazue,
Edhe Kosovën me ja lirue
Përgjithmonë kta me sunue.
Po a i delke nuk p'e di,
Se për ta u ba ma zi:
Luftë i shpallën nja tri mretni.
Ky Gjermani me Austri
N'tjetrën anë kjo Bugari,
E noqën Serbinë për borë, e shi
Konka ikë n'Francë a' hi,
Po kalon besa për Shipni;
Për Shipni paska kalue,

Tri vjet n'fornte paska qinrue,
Mas tri vjetve Franca ka fitue,
Se n'Kosovë Serbinë e ka prue,
Kur na erdh për z'dyt Serbija,
Ç'na trazoje gjithë Shqipnija
Po ma fort kta kosovartë –
Se Serbinë nuk e dojke,
As hiq serbit nuk ju shtrojke.
Gjysa n'ma lpo konkan dalë
Me serbi shumë luftë po bajnë.
Po mjerisht për këta shqiptarë,
Qi s'patën mik kun as kumarë
Qi m'e folë për ta naj fjalë.
Kjo e Evropë e padrejtësi,
Dorë i dhënkan kësaj Serbi,
Mej majtë tokat e shqiptarve t'zi.
At' herë Serbija koka forcue,
Po sa fort konka tërbue:
Nji yrrfi na kanë shtrëngue,
Se n'Kosovë paska çue
Kur p'e çojnë n'Kosovë yrrfinë
Nam po e bajnë n'shqiptarë t'zi,
Po presin gra e po presin thmi

Edhe me zjarrmë po i djegun n'shpi
Tahminë – foshnje i ngulin n'singi.
Kshtu jau bajnë po ksaj Shipnisë,
Po i kallxojnë po kti Nazmisë.
Ky Nazmija konka çue,
N'Beligrad don me kallxue
Telefunin s'ja kanë lshue
Shkon çarshisë po si drangue,
Se n'Llokaq po konka shkue
Ni maqinë me ka pague:
Se n'Brezne don me shkue,
Me hypë n'pampur e me fillue
Po don n'Shkup po për me shkue
Për kit punë po me diftue,
Ni shoq i tij e ka hetue –
Se Nazminë donë m'e damtue,
Mirë Nazmisë m'I kanë kallxue:

- *Ti sot n'Brezne nuk ban me shkue*

S'e kanë menen t'gjallë me t'lshue
Se ksaj pune jam tuj frigue
Atentatat para t'i kanë çue,
E kanë menen me t'varrue.
Ky Nazmija asht kujtue,

Ni pajtan ma ka pague
Fill për xhade konka fillue,
Hypë n'pampur kush s'e ka hetue
Se n'Shkup Nazmija konka shkue
Se n'Shkup po konka zhdrypë
Frik po shkon t'u gazetaxhitë –
Shpejt gazetat me m'i shkrue
N'Krejt Evropën me diftue:

- *Se asht serbi tuj m'çfarue*

Po vret thmi e po vret grue,
Po vret gra e po vret thmi
Hem n'zjarrme po i djeg n'shpi –
''Muj gazetat me t'i shkrue,
Termi bankat duhet me pague''.
I nxjerr Nazmija paret e ja gjue
Fillojnë gazetat tuj kallxue
T'gjitha n'tefter qi i ki' pa shkrue;
Kur e marrin gazetën m'e knue:

- *Drejt Nazmi, thot me t'kallxue*

Kjo gazetë n'Evropë ka me shkue,
Po n'Beligrad duhet m'e çue,
Ty me ba po me t'hetue
Ti n'Serbi s'mundesh me rrune –

Fort Nazmija ju ka gërmue:

- *Frik gazetat me i fillue*

Se për at punë s'frigoj unë
Për atë punë, tha s'e kem dert
Detyra e ime asht sot me dekë
Jam kurban për këtë milet,
Për milet, thotë, për vllazni
Gjithë kah janë n'Jugosllavi ... –
Mirë n'gazeta ma ka diftue
N'Beligrad kur i kanë knue,
Shpejt ni letër e kanë shkrue
Se n'Prishtinë ma kanë çue:

- *Thotë yrrfinë shpejt m'e pranue*

Se dikush n'gazetë ka shkrue,
Shum zullum paski marue
Se n'evropë na paski rrxue –
Qyr Prishtina çka ka marue
Suharitë m'i kanë shtrëngue,
Yrrfisë mrapa ja ka çue
Për Gollak kah ka kërkue
Ka kanë gjetë i kanë pushkatua;
I pushkatojnë ka' gjajnë t'gjallë
Tahminë e gratë mrena i kanë kallë,

Se për Llap qat ditë janë dalë
N'Hereticë po konkan nalë
Sillën gati aty jua bajnë;
Komananti çka ka thanë:
-Na kit sillë, tha si ta hamë
Se për Llap na kem' me dalë
Mej çfarue qa t'gjajmë shqiptarë,
Edhe shpijat me jua kallë
Me gjithë thmi e me gjithë t'gjallë.
Në at fjalim ai tue fjalue
Suharitë letrën ja kanë çue:
Koman'antit ja paskan dhanë
Koman'anti letrën ma k'non,
Mirë xhanartë po m'i tubon
I merr xhanartë, n'Prishtinë shkon.
E deshtë Zoti po ket Nazminë:
-Po qaj trim na e hoq yrrfinë,
Për gjithë Evropën ma ka diftue
N'Kosovë çka asht marue
Nji komisi koka shtëngue,
Se n'Prishtinë kona shkue.
Kur po vjen komisija n'Prishtinë,
Mirë p'e lypin ket Nazminë,

Trim Nazmija konka çue,
Me komisi konka shkue;
Tana venet jau ka kallxue
Llap, Gollak i kanë kërkue
Te Govortë kur konka shkue,
Disa vore po m'i shpalojnë,
Nuk po njomen qi janë insanë
Se me zjarrme shydet i ka ba,
Be t'madhe Zhupani po ban,
Për qashtu na s'kem' zakon:
-Por na këtë urdhën s'e kem' dhanë,
Korroneli ish' tranue
Ai këtë' nam e kish mare
Na të mjerë kur e kem' hetue
Fill n'lludincë e kemi çue
Për qashtu na paskan shkrue
P'ej k'saj pune k'ta me pshtue –
Fort Nazmia na u idhnue
N'Mitrovicë ai konka shkue
Ferat Dragës i ka kallxue;
Ferat Draga n'kamë a' çue,
Kur njiu Nazminë ai tue e kallxue:
-Po thotë Draga, or Nazmi

Do t'shes toka me tapi,
Do t'shes bjeshkë edhe mulli
Do t'i shkrijë t'gjitha për vllazni;
Do të bajmë nji parti
T'gjithë shqiptartë t'i bajmë shoqni,
Do të bajmë na nji xhimjet
Venin tonë do ta sun'ojmë vet –
Me k'to kushte janë besatua,
Afër votimi ish afrue
N'Beligrad Draga ka shkue,
Me Pashiqin ka llafue
Ky Pashiqi m'I ka thanë:
-Radikall due t'i me kanë.
Farad Draga n'kam a' çue:
-T'i mu s'munesh me m'detyrue
Se me ligj jemi lejue,
Ka' të domë vet na m'e vetue –
At' here Pashiqi lutë ju ka:
-T'lutna Dragë t'I mu' me m'falë
Se s'të tham u' ty me zor,
Por po t'lutna me miq'si
Me mue me kanë ti njo parti –
Ferat Draga i paska thanë:

-Unë me ty n'desh më kanë
T'drejtat e ija me m'i dhanë –
Edhe xhimjetin ja ka prenue;
Kur erdh koha me votue
T'gjithë shqiptartë janë bashkue,
T'gjithë n'xhimjet kokrat i kanë lshue
Mirë xhimjeti paska fitue;
Njëzetetetë shqiptar janë shkue,
Nji shoqni t'madhe p'e bajnë
N'Beligrad deputetë po shkojnë,
T'parën k'shillë aty p'e bajnë.
Qysh Pashiqi çka u ka thanë:
-Për shqiptarë shum mirë m'ka ardhë,
Qi kanë votue t'gjithë t'pa damë
T'gjitha t'drejtat kam me jua dhanë,
Veç kme mue kini me kanë
Posllaniktë t'juvtë keni me i bamë
Naçallnikë pej jush me kanë
Presentik pop'lli ka e donë –
Farat Draga çka i ka thanë:
-Due shkollat zotni me m'i dhanë
N'guhë t'dërzhavës po do t'knojmë,
Dy ditë n'javtë n'guhë teme me kanë –

Ky Pashiqi çka i ka thanë:
-S'muj n'guhë tane shkollë me t'dhanë,
Unë kam vetë për hoxhallarë
Ata mue m'Kanë lajm'rue,
Se n'arabisht na domë me k'nue-
Ferat Draga konka idhnue,
Jallah bani, n'kam a' çue:
-Tha me ty s'muj me punue.
T'gjithë xhimjet po çka janë kanë
T'gjithë me Dragën ata po shkojnë
Se kryetar Dragën p'e bajnë;
Zyra n'veti po marojnë,
Xhimjeti Islam po ma emnojnë.
Paska nisë po me punue,
Ky Pashiqi kur i ka hetue
Fort k'saj pune i ka frigue;
E skupshtinën ma ka trazue
Se ushtrisë ja ka dorzue,
Poslaniktë m'i paska lshue
Lajmet mrapa jau ka çue:
-A po doni, thot me punue
Se n'Kosovë n'deshi me sun'ue
Ju ket fjalë keni m'e ngue

T'Partë e shqiptarëve çka janë qillue,
N'koftë ata për me rrune
Frikë Kosovën duhet m'e lshue.
Telegraf çojnë n'Ferizovit
Për m'e pre Ahemtin e Mulla Sulës,
Ma kanë pre po ket shqiptar,
Shoqi i tij s'ka met n'Llogovë.
Telegraf n'Mitrovicë po çojnë
Ferat Dragës si t'ja bajmë
M'e mytë krejt po s'po guxojmë
Se i mençum po qi ka kanë
Se n'shumë vene veten e sigurojnë,
Shum hetime për ta bajnë;
Po nji punë na m'e punue
Diqysh n'mujshim m'e burgue
Nja dhetë vjet nuk kem' m'e lshue,
Të gjithë shqiptarët kanë me iu largue.
Teligraf po i çojnë Prishtinës
Si t'ja bajmë k'ti Nazmijës?
Për Nazminë konkanë kujtue,
Nji kryengritje m'e marue,
T'gjithë serbët n'kamë m'u çue
Se Prishtinës mejrenë me iu gjue

T'gjithë shqiptartë, thonë me i çfarue,
Veç Nazminë mos m'e lanë me rrnue.
At' parullë, po, po na bajnë
Edhe ashtu po punojnë;
T'gjithë serbët n'kamë janë çue,
Se Prishtinën e kanë trazue
Jau nisin xhamave me i thërmue
Edhe beton me gurë tuj e gjue.
K'ti Nazmisë po m'i kallxojnë
Ferat Draga n'Prishtinë qillon
Me Nazminë po konkan dalë
Te zhupani sa shpejt po shkojnë
T'i zhupanit m'i kanë thanë
Ti këtë punë k'shtu pse p'e ban?
Ja këtë punë ti e nalon,
Ja n'gjithë Evropën do t'diftojmë.
Ky zhupani çka ka marue –
-Mirë ushtrinë e ka urdhnue
Rreth Prishtinën e ka rrethue
Serbijanë t'kauneve nuk ka lshue
Se n'Prishtinë ata me shkue
T'gjitha katunet janë shtrëngue
T'armatosun si janë qillue

Donë Prishtinës mrena me ju gjue,
Mirë ushtrija s'i ka lshue
Për katune konkan lshue
Për me vra e me plaçkitë,
Ka' kanë gjetë udhës e kanë mytë.
Ky zhupani po çka po ban,
M'su'së t'shkollave po m'i m'son;
-Thminë e shkollave ju me i m'sue
Kur t'dalin k'ta me vizitue
Me patlixhana kanë me i gjue
Ndoshta Draga s'mund me i durue,
Me allti n'koftë me i gjue,
P'ej zakonit ka m'u rxue,
Qat'herë mujmë na m'e burgue
Ferat Drraga çka po ban
Me Nazminë çue janë kanë
Sheh Mehmeti me ta po shkon,
T'u zyra e vet shehi po i çon
Kur po dalin t'ka tre zotni,
Sheh Mehemti, Draga, Nazimi,
E ulshin kryet po k'ta serpli,
U çuditshën k'ta jahudi:
-Kqyr sa trima po k'ta zotni

E kanë ba' k'ta veten fli,
Për ven' t'vet e për vllazni. –
T'u zyra e Xhemijetit kur kanë shkue,
Thmija e shkollave ju kanë l'shue,
Me patlixhana zunë me i gjue;
Ky çerkezi ish shenue
Fort Nazmija ju ka 'gërmue:
-Ah, bre v'lla, shumë ke gabue
Pse ti tahminë po me na i gjue,
A s'po din kush i ka m'sue?-
Erdh akshami na u terrue,
Ferat Draga herët a' çue,
N'Mitrovicë a' m'sy me shkue
N'Breg t'Bajrit kur ka dalë,
Aty serbët po konkan dalë,
Jau gjujnë dramën me gurë me zallë
Dramën n'udhë jua kanë nalë.
Ky çerkezi na u idhnue,
E hoq pushkën e i ka gjue
I madh ej vogël n'kam janë çue,
Mirë te kruzhi po konkan shkue:
-Ferat Draga, thonë a' tranue
S'po i len tahminë n'rrugë me lue,

Me allti po gjithë tue i gjue –
Qyre kurzhni çka ka marue
Mirë zhupanit m'i kallxue,
Ky zhupani fort ish g'uzue
Se n'fletore ma ka diftue
Ferat Dragën e kanë burgue,
Soll tri vjet na e kanë l'shue;
K'ti Nazmisë çka kanë marue
T'keq nji njeri ja kanë pague,
N'ramazan nji natë a' dalë,
Me nji kafe qi po shkon
T'u dritarja çaj njeriu u afrue
Me allti Nazminë ma ka qillue,
Fati i ti', kish pasë me rrnue
Tjertë fyshekë alltia s'ja ka punue,
Kaq Nazminë ma ka plague;
Serbijantë fort konkan g'zue:
-Thonë Nazminë e kanë plague
Nër doktorë ai tash ka me shkue
Ata kemi me e helmue –
T'gjithë shqipraëve kur u kanë kallxue
T'u Nazmiu konkan shkue,
Se dy dram m'i kanë pague,

N'Mitrovicë Namzinë e kanë çue,
Nji mjek mik ju ka qillue.
Qysh Nazmiu çka i ka thanë:
-Unë t'u ti lirisht jam ardhë
Se ngjeti s'guxoj me shkue
E kanë menen me m'helmatue =
Qaj doktor sa trim m'ish kanë:
-A po ngon Nazmi i ka thanë
Sa t'jam gjallë unë me t'mjekue,
Nuk mun' kush me t'helmatue –
Si po thotë, ashtu po ban,
Mirë Nazminë po ma mjekon,
Për pak ditë po ma çon.
Ky Nazmiu kur konka çue
Se n'Prishtinë ai konka shkue,
Pop'llit t'vet ai me i n'i'mue;
Ferat Dragën e kanë burgue,
Se n'Shkup po ma kanë çue,
Shkojshin shoktë biukë me i çue
Xhanartë mrena nuk i kanë l'shue;
Mirë jelekun ja kanë helmatues.
Shumë shqiptarë n'at burg janë kanë
T'gjithë Draga qi po i manë

T'gjithë Draga qi po i mante,
Nji pej tyne Dragës i thonte:
-Se unë gjallën due m'e shikue
N'Pastë naj senle t'um zen mue,
Me burg t'përjetshëm më kanë dënue,
E n'pastë gja t'ligë te ma zan mue
Qaty Draga nuk e ka lanë,
Nji cope mish nji mace e ka'shon,
Pesë minuta po ma nuk rrnon;
Ferat Draga çka ka marue
Zojës t'vet letër I ka çue:
-Tjetër senë m'u mos me m'çue
Veç voe t'zieme t'pa cikrrue –
At'herë zoja e ka hetue,
Qi done Dragën m'e helmatue,
N'at' shoqni zoja ka shkue,
Se I shoqi ish sugure
Për këtë punë paska kallxue;
Qajo shoqni po çka po ban,
Nji komisi Dragës ja çon;
Nji komisi Dragës ja çojnë,
Mire Serbijes po m'i kallxojnë
Se shumë Draga ka me rrnue,

E deshtë zoti q'at zoj, q'at grue
Se pej helmit Draga ka me pshtue:
-Po thot Draga lumi unë,
Masi Nazminë lirë e kam
Për vllazni dajm punon;
Sheh Mehmeti gjithë po i nimon,
Gjithë Kosovën po ma m'son
Veç'in tonë mos ta l'shojnë.
Qyr Nazmiu çka po ban,
Ni posllaniku m'i ka thanë:
-N'deshi kokrrat me jau dhanë
Për Feratin me punue
M'e qitë n'gjygje e me gjykue,
Ja t'ja presim vjet ja me e l'shue,
Qaj posllanik mirë ma ngon
N'BIligrad mirë po shkon
Për Feratin po punon,
Mirë raportet n'gjygj ja çon
Del gazeta po kallon:
-Ferat Dragën do ta l'shojnë.
Mirë Nazminë ma kanë hetue,
Prap nji njeri ja kanë pague
Edhe fort ma kanë shtrëngue;

Njiqin' vetë n'koftë me i damtue,
Katije për ty nuk ka m'u shkrue,
Veç Nazminë mos me na l'shue.
Nji natë deka kur m'i ka ardhë,
Rushit Begu aty qillon
Edhe Mustafa me ta po shko,
Ka nji kafe po m'jau çojnë.
Desa serbëtaty janë kanë,
Larg prej tyne po konkan dalë;
Vetëm nji skeji qi konkan da.
RUshit Begu e foli nji fjalë:
-Diçka asht Nazimi, bre, djalë
Qyre vetun k'ta ku janë, damë ç
Fjaltë s'vojnojnë, pushka kërset
Se e para kërkuj s'ja ngjet.
Ky Mustafa konka çue,
Nxjerr alltinë n'derë shkon
T'dytën pushkë kur jau kanë dhanë
Keq Mustafën ma plagojnë.
E treta pushkë kur kërsiti,
Keq Nazmisë n't'hollë ja ngjiti.
Na n'rroj jetë ky trim Nazmija
Me q'at ditë na diq Prishtina;

Ky Nazmija i pa mjekerr,
Qyqja nana qi s'ka tjetër
Nana e vet çka ka marue,
Gurin e vorrit ja paska shkrue
Dëshmor Nazminë me ka kallxue,
Me flori ja ka flakure:
-Se kush vdes për vllazni
I shkruhet emni n'histori,
Edhe flakohet me flori –
K'shu Nazmija na ka dakë
Perëndija e pastë deshtë,
Se shoqi e tij n'Prishtinë s'a metë,
Ai a kanë e dyti Ferat Beg.
(Rizah Strelli, Degë e këputur, faqe 58)

Atdheu i dashtun

Dola n'bahqe n'kohë t'baharit,
Sabah doket, terig i lehtë,
Drita fillon e po zbardhet,
Kanë zanë pemët me l'shu fletë.

Segjëde bante n'rremë bylbyli,
Krahtë i çelë, lutet si fëmi,
Si hyri do digjet nuri,
n'gjuhë t shpendit këndon tespi.

Shikoj bjeshktë, gjithë të blerta,
U taku ashku me sevda,
Tash fillon, po, me dal vera
La tespin xhenet n'këtë dynja.

Në emër të miskut, lulet lagshtue,
Afër duket lindja e diellit tonë,
Mora pendën hartim me shkrue,
Dashurinë e bahqes tonë.

Flakoi dielli, sa kuq nji bojë
Edhe në mes me t'zi o shkru'

Ai thue rremzit ku do t'na i lshoj,
Ne t'mjerëve me na rrezu

O bylbyl, sa mire po këndon,
Shih sa fort po më perget mu',
Natë e ditë qi po vajton,
M'u bashku me vëllazni tu.

Ke formën dhe bukurinë,
Kendo bylbyl cim-cim gjithmonë,
Se shumë emna t'Zotit i dine,
E vuejtjet tona na i difton.

Tash ka çelë lulja jorgovan,
Do t'vjen koha për ne me u gëzue,
Të gjithë arshikëve erë me u dhanë,
Për rreth saj me u bashkue.

(Rizah Strelli, Degë e këputur, faqe 21)

Ramë bre vlla ti nuk je dek!

''Haber i zi n'gazet u knu
Ky Ram Bllaca jet ka ndrrue
N'derzhav ton çka ka milet
Për to bojshin haj medet!

Shkojn shqipart n'direkci
Me lot kashin porsi thmi,
Tan talebja kta bab e din
Se bum mall ka shkri për din
S'ka lun shkokun ne skuptshin
Krejt mileti le ta din:
Me ta me nejt ni sahat
Sa ni qitp t'epke nasihat.

Tertip ka pas për kit zaman
Deputet tri herë her uu kanë
Prej hyzmetit ai kurr s'a da
Se gjithkush ai kurr s'a da
Se gjithkush hajrin ja pa
Për jet t'dunjas mos me dhan
Se pa than krahin tan.
Sefte pushka n'ta ka kris

Osman Qerimi mos paft drit!
S'fiqiroi hiç për shoqni
Asjë fije shqiptari!?

Hoxhë ka fol n'katun Sazli
Ngoni knej shok e vllazni
Para se t'dilet n'marifet
Trimat e meqem kurr s'kan kimet
Se shpent e egra qi fluturojn
Rena-rena ato gjith shkojn
T'parin e vet ato e ngojn!

Qysh u bam na deri n'kit dit?!
Vllaznillaakun hiç mos me dit.
S'dim ulixhe as nuk dim t'par
As nuk lam t'Meqem dieatar?!
Xhehaleti kto pun i bon
Terri i zi syt naj qorron
Kurr se shohim diten ton
Shoqi – shoqin gjith tuj e dhon.

Ram bre vlla ti nuk je dek
Ke lan djalin n'Univerzitet

Tana gajlet ai ty t'i hjek.
Dill e hanë sa t'jen n'ket jet
Kurr s'të harron ty ky milet
Ket nder hymqit na sja harrojmë
Veç n'kohna t'zorshme ja kallxojm!

(Pirraku, 1992)

.....

''Haber i zi n'gazetë është shkrue,
Ky Ramë Bllaca jetë ka ndrrue.
Ramë o vlla nuk je dek,
Veç prej dynjaje ke ndrru jetë.

Por e ke lan djalin n'Universitet.
Të tana gajlet ty t'i hjek
por kush e bani këtë ujdi
hoxhë ka fol n'fshatin Sazli.''

(Retkoceri dhe Marevci, 2007)

Bylbyl i vetëm

(Garib bylbyl)

''Garib bylbyl n'kafaz knon,
Ah! Knimi tina vaj kallxon.
Jesirin hiç s'e don,
N'rrem t'therrës don me kon,
Shqipnia jon 'përget n'honë
Çyfaria dill ka nxonë.
Ty temsil heqim i jet
Për to kajn me muj me vjet.
Re e zezë krah ka çelë
nurin tonë na e ka mshelë...''
''Nxomja jote ah moj honë!
Krejt Shqipnin n'ter e ka lonë.
Athu Zoti n'tagdir t'vet
T'fshefi prej nesh
-N'vransi t'zezë ...?!
Texhelia ka gjet hyqmet
N'zjerm t'hasretit me na djeg
Ylli jot me bajrak
Ja dha ni drit' qatje larg.
Texheli nasib me kon
Qajo rreze n'bahqe ton
Tarik n'guri na dojm me shkru
Shokt mas nesh mos me i harru!

Jemi ardhun

Jemi ardhun në këtë dynja
Për me dit se ka Allah
Atij me ju lutun na - La ilahe ilAllah

Ibni Shemsi e ka shkru
Zoti në xhenet e pas çu
Mësojave ilmin (diturinë) fëmijve tu - Le ilahe ilAllah

Na pa mësim nuk ban me kanë
Sa pa dillë e sa pa hanë
Paditurinë e kemi dushman - La ilahe ilAllah

Hem Allahun kush e donë
Edhe Allahu atë e donë
Me melek n'xhenet e çonë - Le ilahe ilAllah

Hem Allahu kush s'e donë
Hem Allahu atë s'e donë
Me shejtan n'xhehnem e çonë - La ilahe ilAllah

(E transkriptuar nga një video xhirim – kënduar në xhaminë e madhe në Ferizaj)

UŞŞAK İLAHİ
Jemi Ardhun

Usul: Sofyan

Yöre:Makedonya
Derleyen: Ubeydullah Sezikli-Abas Jahja



İbni shemsi e ka shkru
Zoti n'xhennet me na çu
Msoja ilmin fmive tu
La ilahe il-lallah

Hem Allahun kush se don
Dhe Allahu at se don
Me shejtan n'xhennem e çon
La ilahe il-lallah

Hem Allahun kush se don
Dhe Allahu at se don
Me melek n'xhennet e çon
La ilahe il-lallah

Jam merzitur du me dal
Me sheku n'qabe skemi mall
N'ziker daima mekan
La ilahe il-lallah

Marrë nga http://ubeydullahsezikli.com.tr

Jam mërzitun

Jam i mërzitun du me dal
Me shku në Qabe s'kemi mall
Dhikër daim na me ba
La i lahe ilAllah
Jam mërzitun du më me dal
Me shku në Qabe namaz me fal
Namaz me fal e me ba tavaf
Se atje ka shumë sevap
Jam mërzitun ditë e nat
Për me dal në Arafat
N'Arafat me ba dua
La ilahe ilAllah
Pejgamberi ka urdhuar
Hem n'Mine për me shku
N'Mine për me pre kurban
Në emër të Zotit ai ka than
Hem mërzitur na shumë herë
Për me pa atë Pejgamber
Për me pa bile një herë
Në Medine Munever

(E transkriptuar nga një video xhirim – kënduar në xhaminë e madhe në Ferizaj)

Nga ''Ani na t'i lutemi Perendisë''

Ani kur t'vjen shpirti për me dal
Sikur vorba kur mer val.
Ani kur t'na qesin n'teneshir
Dot u dokna fort i mir.
Ani me bohur do t'na timojn
Me uj t'vokt do t'na pastrojn
Ani me sapun do t'na shkumbojn
Me pamuk syt naj qorojn
Ani me qefin do t'na pshjellojn
Me tri dizga na shtregojn.
Ani kater vet do t'na trozojn
Shumë xhemati permas shkojn.
Ani n'trap te vorti do t'na lshojn
Krejt xhemati amin bojn.
Ani neve n'vor do t'na lshojn
Me shum dhe do t'na ranojn.
Ani dy melaqe na rin n'kam.
Do t'na vesin për din e iman.
Ani dy melaqe na rin n'kam.
Do t'na vesin për bab e nan,
Ani kur t'vjen shpirti për me dal

Tona azat lypin hallall.
Ani dor e kam do t'na shtrin
Akrabaja (mas) na vin.
Ani hem xhenazen do t'na knojn
Tallkinin hoxha do t'na kendon.
Ani tan xhemati n'shpi do t'shkojn
Vetem neve do t'na lon.
Ani udh e mar shok(ë) e dosllar(ë)
Po tutna qi ua do t'kaj.
Ani hallall bonma shok e djal
Kto gjynahe qysh i laj.
Ani udha e mar shok(ë) e dosllar(ë)
Thuju mue mos tum kajn
Ani kjo dynja a douran
Lutem Zotit Ja Rahman ...

(Poezia e Bejtexhinjve, faqe 457)

Mos e le fale Namzin

Gjithë n'sabah ti herët me u çu
Para se dielli me rrezu
Me Allahun ndash me u pajtu

Mos e le, fale namazin
Bile sunet edhe farzin
E mos mujsh, veç fale farzin
Mos ta hidhnojna Allahun

E i besum mbaje emrin
Mos ja zi shejtanit vendin
Se e ke mu'min emrin

Mos e le, fale namazin
Bile sunet edhe farzin
E mos mujsh, veç fale farzin
Mos ta hidhnojna Allahun

Për një sexhde është përzanë
Po ti sa namaze i ke lan
A s'frigon se je ma shejtan

'Hem jacijen kush nuk e fal,
Thot shejtani me ta s'kam fjal
Se m'ka kapërcy për disa shkall'

''Na po të t'lutemi ty Ja Gafarr,
Xheza bani gjithë zullumqar
Se kurgja nuk po na lon me mar…!

(Një pjesë e kësaj kënge është marrë nga një video këngë në internet e cila këndohet nga një Kori i Shkollës Miraxh në Nju Jork, dhe një ca vargje nga shkrimi i Muhamet Pirrakut.)

‘Ve Duha ajet ku â knu”

‘’Hallall boma ej ymmet

Nasihat se kom vasijet

Ni trup me kanen vegvuxhud

Shoqi shoqin mos me dhan

Si n’idhnim, qashtu n’gzim

Se n’birlik ka gjallërim

(Pirraku, 1992)

(Kjo peozi sipas prof. Pirrakut përmban 48 vargje. Nëse në vinë doresh dhe pjesa tjetër e poezisë, e publikojmë në ribotimet e ardhshme, apo në verisonin dixhital)
(ymmet – popull – komunitet / nasihat – këshillë/ vasijet – testament/ jegvuxhud – unitet/ birlik – bashkim)

Qyr Hafuz qi rrin në Sazli

(Rizha Srtrelli kushtuar Hafiz Ymerit)

Qyr Hafuz që rrin në Sazli
Ti qi më konke kombëtar,
Po gjithnji më rrin ndër sy,
Po ban vjerrsha me do fjalë.

Ti e vajtosh gjithë bylbylin,
Me ato kangë qi asht tu' këndue,
Se ai i mjeri p'e lyp pyellin,
N'tjetër vend nuk mund me rrnue.

Ti këndojshe mirë Kur'anin,
Edhe mirë e ke kuptue,
Se si Zoti e mësoi insanin,
Me kanë i dishëm me besue.

Udha e drejtë e Perëndisë,
Me e shenjë t'veta na ka thanë,
Nuk është tjetër veç njerzisë,
Dhe me dashtun na shoqi shojin.

Për shumë punë qi jemi udhnue,
Për punë t'mira, adhurim,
Këto urdhna na kanë mësue,
Se na duhet ne bashkim.

Gjithë sa punë i bajmë për Zotin,
E mos t'kemi na bashkim,
Po të gjitha kot na shkojnë,
Perëndisë këto gja s'i vyejnë.

T'falem nderës Hafuz i jonë,
Gjithë rinisë i ke ndihmue,
Gjithë kur folshim për gjuhë tonë,
Fjalët tona i ke forcue.

Do shokë tu, do hoxhallarë,
Shumë prej nesh na i kanë largue',
Veç qi thoshin jam shqiptar,
Për gjithë tonë na tue punu'.

Ata t'mjerë qysh s'p'e dinë,
Se si duhet me punue,

Pse s'po lypin kurrë liri!
Perëndia a s'i ka udhnue?

Fjaltë tradhtore gjithë i thonë,
Se si turku i tradhtue,
Pse s'po punojnë kurrë për gjuhë tonë,
Kombin tonë na me lirue.

Për liri ti e folë nji fjalë,
A asht nji diell po për gjithkan,
Se pa te nuk kemi t'gjallë,
Pleq e t'ri për to t'liftojmë.

Unë këtë vjerrësh qi jamë tue këndu',
Se për ty do fjalë po i tham,
Kosovartë vyen me i kujte,
Fjalë e tua se çka janë.

T'i i tregojshe fjalët e Alisë
Pop'llit t'vet ai çka i ka thanë,
Jemi t'urdhnuem prej Perëndisë,
Me i eduke na f'minë tonë.

Dhe nji fjalë ai qi e ka shkrue,
Për gjithë kombet qi ka njerëzi
Feqin e vet duhet me i mësue,
Për kohët tyre, për shoqni.

I falem nderës për këtë fjalë
Po si mirë na ka mësue,
Ashtu vyen për kosovarë,
Për komb tonë na me u munde.

Për këtë shkak, or kosovarë,
T'gjithë së bashku me punue',
T'ri e pleqë, e hoxhallarë,
Vendin m'e përparu'.

Kombet tjera, shokët tonë,
Shumë përpara na kanë shku',
A sot marre për këtë komb,
Mos me ditë jetën m'e rrnue.

Shumë mungesa na që i kemi,
Edhe mbrapa na qi jemi mbetë,
Mbasi veti s'dimë q'jem,

E jemi kanë gjithë të shkretë.

Nuk vyen tjetër për na t'ngratë,
Hiq kërkaç na me u mashtru',
Gjuhën tonë na nalt m'e majtë,
Edhe shkolla për me mësu'.

Kjo asht shenjta e lirisë,
Edhe shembull për gjithkanë,
Kjo asht ndera e njerëzisë,
Edhe kombet i dallon.

Of Hafuz, ti mu'me falë,
Për këto fjalë qi jam tue këndue,
Mbasi digjna tue kanë gjallë,
Për gjuhën time me lulzue.

Si ti duhet pra te tanë,
N'kontakte me kohë me ardhë,
Për gjuhë të vet ai që s'punon,
Ai numërohet gjithë tradhtar.

Na nuk duhet si n'kohë t'vjetër,

Nëpër terr na me shkue,
Me përdorue 'do gjuhë tjetër,
E tanën m'e pushtnue.

Ata, këtë vjershë qi kanë me ngue,
Dhe shqiptar i thjeshtë me kanë,
E dinë mirë se jam përvlue,
Për lirinë e gjuhës sonë.

(Rizah Strellci, Degë e këputur, faqe 29)
(Nji përgjigje, me falenderue nji hoxhe vjershëtar nga Sazlia, i qujteuni Hafuz Ymer Shemsi, në vitin 1938, me këtë vjerrshë'')

Ai që fliste me kohën… dhe përtej saj

Ka njerëz që jetojnë në kohën e tyre. Ka të tjerë që e sfidojnë kohën. Por janë shumë të paktë ata që ***e tejkalojnë atë****.*

Hafiz Ymer Shemsiu ishte njëri prej tyre.

Në një shekull të përzhitur nga luftëra, shtypje, burgje dhe harresë, ai zgjodhi të ndërtojë. Të mësojë. Të shërojë. Të këndojë kur të tjerët heshtnin, të flasë kur të tjerët frikësoheshin, të qëndrojë kur të tjerët largoheshin.

Nëse do ta shihnim sot Hafiz Ymerin në rrugët e qytetit tonë modern, ndoshta do dukej si njeri i vjetër, me veshje tradicionale e shikim të qetë. Por po të fliste, fjalët e tij do të qenë më moderne se ne. Sepse do të fliste për ***dijen****,* ***ndershmërinë****,* ***shërbimin ndaj tjetrit****,* ***gjuhën shqipe****,* ***fenë si dritë****, dhe* ***kombin si përgjegjësi****, jo si flamur bosh.*

Në një botë që sot shpesh matet me pasuri, pamje dhe pushtet, Hafiz Ymeri është një kujtesë e fuqishme se ***dinjiteti i njeriut matet me atë që jep për të tjerët – jo me atë që grumbullon për vete****.*

Ai na mëson se arsimimi nuk ndodh vetëm në shkolla — ndodh në shtëpi, në xhami, në fushë, në burg, në këngë, në lutje. Na mëson se patriotizmi nuk është thirrje me zë të lartë, por veprim i heshtur, i përditshëm: të mësosh një fëmijë të shkruajë; të bindësh një të ri të mos largohet; të qëndrosh i drejtë kur të tjerët përkulen.

Ky libër nuk është thjesht një udhëtim në të kaluarën. Është një ***pasqyrë*** *për të ardhmen.*

Pyetja e vërtetë nuk është: "Kush ishte Hafiz Ymeri?" Por: ***"Kush nga ne do të guxojë të jetë si ai, sot?"***

Në një kohë ku kombi ka nevojë për zëra të urtë, për mendje të formuara dhe për zemra të pastra, ***ndoshta më shumë se kurrë****, kemi nevojë për të rikthyer figurën e tij. Jo si monument. Por si model.*

Hafiz Ymeri nuk kërkoi kurrë lavdi.
Por nëse do të jetonte sot, do t'i mjaftonte të dinte se brezi që vjen e njeh dhe e ndjek.

Jo nga detyrimi.
Por nga ***mirënjohja****.*

Pasthënie!

Ky libër synon të nderojë jetën, veprën dhe trashëgiminë e njërit ndër figurat më të ndritura të historisë shqiptare, Hafiz Ymer Shemsiu. Duke përshkruar përkushtimin e tij të pashembullt ndaj fesë, kulturës dhe çështjes kombëtare, ky libër sjell në dritë rolin jetik të Hafiz Ymerit në formimin e brezave të ardhshëm të shqiptarëve, si dhe në ndërtimin e një ndjenje të fuqishme të identitetit dhe dinjitetit kombëtar.

Hafiz Ymeri ishte shumë më tepër sesa një hoxhë dhe një mësues. Ai ishte një vizionar që pa më larg se bashkëkohësit e tij, duke kuptuar thellësisht rëndësinë e edukimit fetar, kulturor dhe kombëtar. Si imam, mësimdhënës dhe poet, ai dha kontributin e tij të paçmueshëm për të mbajtur gjallë ndjenjën e atdhedashurisë dhe për t'u përballur me padrejtësitë që kishin mbërthyer popullin shqiptar. Ai nuk jetoi vetëm për veten e tij, por për një ideal të lartë, për një të ardhme më të ndritur të kombit shqiptar.

Duke qenë imam i xhamisë së fshatit Sazli, vendi ku Hafiz Ymeri i zhvilloi pjesën më të madhe të veprimtarisë së tij (Cit. Muhamed Muharremi – autori), i motivuar pikërisht nga rrëfimet për jetën dhe veprën e Hafiz Ymerit për të nisur këtë studim. Së bashku me kolegun, Gentian Jetishi, ndërmorëm këtë iniciativë të rëndësishme për të sjellë në pah figurën e këtij teologu

dhe patriot të madh, duke ofruar një panoramë të plotë të veprimtarisë dhe ndikimit të tij.

Gjatë procesit të punës, kontributi i shumë historianëve, familjarëve dhe bashkëpunëtorëve ishte thelbësor për të siguruar një përmbledhje sa më të saktë dhe të thellë të jetës dhe veprës së Hafiz Ymerit. Një falënderim i veçantë shkon për historianët Dr. Liman Rushiti (i ndjerë), Dr. Jusuf Osmani dhe Dr. Fahrush Rexhepi, prof. Skender Lutfiu për ndihmën dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshme në këtë projekt.

Gjithashtu, falenderimet shkojnë për familjarët e Hafiz Ymerit dhe për të gjithë ata që kontribuan në sjelljen e këtij libri në jetë. Hasan Shemsedini, djali i Jusufit (biri i adoptuar i Hafiz Ymerit), Mahmut Mahmuti, familjar i Haxhi Pllanës, Skender Hashani nip i Hafiz Ymerit, Orhan Rushiti (Straja) nip i Haxhi Pllanës, dhe Rexhep Rexhepi, banor i fshatit Sazli, dhanë një kontribut të vyer në ndriçimin e fakteve historike dhe trashëgimisë së familjes së Hafiz Ymerit. Po ashtu, një falënderim i veçantë shkon për Avni Sadikun, ish-bibliotekistin e Bibliotekës 'Sadik Tafarshiku' në Ferizaj, për ndihmën e tij të vazhdueshme në gjetjen e burimeve të rëndësishme për këtë studim. Faleminderit edhe kolegëve Ibrahim Halili, Ilir Maliqi, Burhan Haxha dhe Mubekir Shaqiri për mbështetje gjatë gjithë procesit të shkrimit të këtij libri.

Në fund, shpresojmë që ky libër të mbetet një udhërrëfyes për të gjithë ata që duan të kuptojnë më thellë figurën e Hafiz Ymerit dhe ndikimin e tij të pashoq në historinë dhe kulturën shqiptare. Veprat e tij nuk duhet të harrohen, por të jetojnë përherë në zemrat e shqiptarëve, si një frymëzim për brezat e ardhshëm. Hafiz Ymeri nuk jetoi kot; ai e sakrifikoi jetën e tij për të lënë pas një trashëgimi të ndritur, e cila do të ndriçojë rrugën e kombit tonë për shumë vite që do të vijnë.



Poeti Hafiz Ymeri kaloi jetën e
një patrioti, pati fatin tragjik të
të gjithë personaliteteve his-

torike të medha, vepra e tij letrare
ishte fund e krye në shërbim të
kombit, të ekzistencës kombëtare.

Figura 25: Dorëshkrim nga krijimtaria letare e Hafiz Ymerit (Pirraku, 1992)

Lista e imazheve!

Figura 1 - Harta e Prokupjes dhe vija drejt Ferizajt 18
Figura 2: Trungu familjar Hafiz Ymeri Shemsiut 22
Figura 3: Esma Ymeri - Statovci (motra e Hafiz Ymerti) me bashkëshortin e saj Hafiz Mulla Sejdi Vesel Statovci! 24
Figura 4: Haxhi Ahmet (Bajram) Pllana 25
Figura 5: Xhami e madhe dhe mejtepi i xhamisë së madhe mbi të cilin mejtep do ndërtohet më vonë Kisha Ortodokse Serbe. Kjo është fotografi e vitit 1903 e bërë nga Baron Franz Nopcsa 28
Figura 6: Fotografi e vitit 1930, sa kohë që Kisha Ortodokse Serbe ende po ndërtohej në oborrin e xhamisë së madhe (mbi themelet e mejtepit te xhamisë), ku ndodhet edhe sot! 30
Figura 7: Ferizaj, viti 1920 32
Figura 8: : Ferizaj, viti 1920 32
Figura 9: Prishtina, viti 1900 33
Figura 10: Shkupi, viti 1900 34
Figura 11: Ferizaj, viti 1900 35
Figura 12: Xhamia e vogël 'Xhamia e Boshnjakut' - Ferizaj (S'ka njohuri për vitin e fotografisë) 36
Figura 13: Mulla Vesel Guta - forografi e marrë nga libri i tij 'Perëndia më frymëzoi' 44
Figura 14: Gazeta Besa - Bashkim e botuar në gjuhën shqipe në vitin 1908 në Stamboll - Turqi! 66
Figura 15: Abetarja e Hafiz Ali Korçës e botuar në vitin 1910 69
Figura 16: Xhamia e Madhe dhe Mejtepi i Ferizajt, tani në themelit e të cilit gjendet objektet e Kishës Ortodokse Serbe! 85
Figura 17: Objekti i shkollës së pare shqipe në Ferizaj 86
Figura 18: : Prof. Shaban Vata me një grup nxënës të Shkollës Ismajl Qemajli', fotografi e vitit 22.05.1941) 89

Figura 19: Nga libri i Robert Elsie The Currents of Moslem and Bektashi Writing in Albania (1850-1950). 93
Figura 20: Aty ku ka ekzistuar shkolla shqipe - mejtpi i Hafiz Ymerit, tani është xhami e fshatit Sazli. Në fotografi shihet emërtimi i kësaj rruge me emrin e Hafiz Ymerit! 95
Figura 21: Flamuri i Kosovës i paraqitur nga Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës viti 1918 159
Figura 22: Xhamia në Talinoc të Muhaxhirëve ku ishte vendosur Komiteti Qarkor i Feirzaj i Lidhjes II të Prizreni 166
Figura 23: Interieri i Xhamisë së vjetër në fshatin Talinoc i Muhaxhirëve 178
Figura24: Takimi me Haxhi Nazim Maliku ish nxënësi Hafiz Ymerit 186
Figura 24: Dorëshkrim nga krijimtaria letare e Hafiz Ymerit (Pirraku, 1992) 242

Literatura

Elsie, R. (1994). *The Currents of Moslem and Bektashi Writing in Albania (1850-1950)*. Elsie. http://www.elsie.de/pdf/articles/A1994Current.pdf

Hashani, S. (1998). *Ferizaj dhe rrethina (1873 - 1941)* (1st ed.). Dinograf.

Retkoceri, Q., & Marevci, R. (2007). *Shkollat në Komunën e Ferizajt (Monografi)* (1st ed.). Intergraf.

Baftiaj, I. (2017). *Autor nga Rajoni i Ferizajt (1893 - 2016)* (1st ed.). Zgjimi.

Hyseni (Goga), I. (2014). *Ferizaj 1873-1944*. Private.

Kraja, M. (1993). *"Mësuesit Për Kombin Shqiptar", Toena, 1993, f. 369- 371, dhe 456.* (pp. 369–371, 456.). Teona.

Musliu, A. (2016). *Ditar (1941 - 1945)*. Intergraf.

https://www.radiokosovaelire.com/avzi-mustafa-mejtepet-shkollat-e-para-shqipe-2/

Norris, H. (1993). *Islam in the Balkans : religion and society between Europe and the Arab world* (p. 190). University Of South Carolina Press.

Pirraku, M. (1974). *Lëvizja e Rinisë Komuniste midis dy luftrave botërore*. Rilindja.

Pirraku, M. (1989). *Kultura Kombëtare Shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit* (p. 384). IA.

Pirraku, M. (1992). "'Hafiz Ymeri - Bardi i Kosovës së viteve '20 e '30-ta.'" *Dituria Islame*, *45*, 15–20.

Ajavzi Mjaku, T. (2025). ''Përndjekja politike ndaj kuadrit arsimor shqiptar gjatë viteve 1945 – 1999 në trevën e Ferizajt.''; SAS, SAS, Ferizaj, faqe 20 – 22

Pirraku, M. (2002). Lidhja e Dytë e Prizrenit sipas shkrimeve autentike të pjesëmarrësve. *Edukata Islame*, *67*(XXXI), 192–224. https://dituriaislame.com/wp-content/uploads/2022/01/edukata67.pdf

Pirraku, M. (2011, January 11). *Roli i Nazim Gafurrit në ndërkombëtarizimin e masakrës së Bozhiqit 1921 – Epoka e Re*. Www.epokaere.com. https://www.epokaere.com/roli-i-nazim-gafurrit-ne-nderkombetarizimin-e-masakres-se-bozhiqit-1921/

Pirraku, M. (2017). *"'Mulla Idris Gjilani dhe Mbrojtja Kombëtare e Kosovës Lindore 1941 - 1951'"* (2nd ed.). Dituria Islame. (Original work published 1995)

Pirraku, M. (2022, September 27). *Roli i Nazim Gafurrit në ndërkombëtarizimin e masakrës së Bozhiqit 1921 – Epoka e Re*. Www.epokaere.com. https://www.epokaere.com/roli-i-nazim-gafurrit-ne-nderkombetarizimin-e-masakres-se-bozhiqit-1921/

Koliqi, H. (2002). *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar* (p. 53). Universiteti i Prishtinës & Libri shkollor.

Strellci, R. (1995). *Degë e këptur* (1st ed.). Botim Privat.

Zekaj, R. (2012). *Zhvillimi i kulturës islame gjatë shekullit XX* (2nd ed.). AIITC.

Buxhovi, J. (2015). *Kosova: 1912-1945*. Faik Konica.

Drançolli, J. (1995). Universiteti i Durrësit (Shek. XV). *Buletin I Fakultetit Filozofik*, *XIII*, 108.

Hetemi, R., & Mustafi, J. (n.d.). *Historiku i xhamive të Ferizajt me rrethinë*.

"Veteranët e Klerit Mysliman." (1937). *Zani I Naltë*, *11*, 330.

111 vjetori i Kongresit të Manastirit dhe ndihma e madhe e sulltan Abdulhamitit II për këtë ngjarje | Gazeta e Re. (2019, November 15). Gazetaere.com. https://gazetaere.com/111-vjetori-i-kongresit-te-manastirit-dhe-ndihma-e-madhe-e-sulltan-abdulhamitit-ii-per-kete-ngjarje/

Arifi, S. (2021, May 14). *Gjenocidi serb i bërë ndaj shqiptarëve nëpër kohë të argumentohet nga Kosova në GJND*. Bota Sot. https://www.botasot.info/opinione/1583764/gjenocidi-serb-i-bere-ndaj-shqiptareve-neper-kohe-te-argumentohet-

nga-kosova-ne-gjnd/

Azizi, I. (2019a, February 7). *100 vite nga themelimi i Xhemijetit, roli i Dragajve dhe Blytës në veprimtarinë e tij! | Kosova për Sanxhakun*. Kosovapersanxhakun.org. https://kosovapersanxhakun.org/?p=7005&lang=sq

Azizi, I. (2019b, April 22). *"Golgotha Shqiptare" Serbët vranë 500 000 shqiptarë*. Kosovapersanxhakun.org. https://kosovapersanxhakun.org/?p=7287&lang=sq

Dauti, F. (2012, September 19). *Mbajtjen e Kongresit të Manastirit e financoi Sulltani - Zeri Islam.com*. www.zeriislam.com. https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2438

Dobruna, A. (2020, February 6). *Kontributi i dijetarëve myslimanë në Lidhjen e Dytë të Prizrenit*. Zani I Naltë. https://www.zaninalte.al/2020/02/kontributi-i-dijetareve-myslimane-ne-lidhjen-e-dyte-te-prizrenit/#_ftnref2

Hysa, M. (2000). *Alamiada Shqiptare II - Studime dhe recensione* (1st ed.). Logos-A.

Hyseni, S. (2012, October 13). *Histori e shkurtër e arsimit shqip*. Forumi Shqiptar. https://fv.al/t/histori-e-shkurter-e-arsimit-shqip.40591/

Islami, H. (1997). *Dimensioni demografik i çështjes së Kosovës* (p. 159). Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës.

Izeti, M. (2017). *Dyzet net III* (1st ed.). Logos-A. https://logos-a.com/online/book/100/read

KADRIU, M. (2018, January 17). *Vepër me vlerë të rëndësishme*. Bota Sot. https://www.botasot.info/libra-sporti/821404/veper-me-vlere-te-rendesishme/

Keçmezi - Basha, S. (2019, February 11). Një dokument i rëndësishëm për likuidimin e Mulla Idriz Gjilanit. *Epoka E Re*. 16. https://www.epokaere.com/wp-content/uploads/2019/02/Epoka-11-shkurt-2019.pdf

Kraja, Dr. M. (2016, February 22). *Hafiz Ymer Shemsedini – mësues i gjuhës shqipe, i Islamit dhe i atdhetarizmit në Kosovë e*

më gjerë. Zani I Naltë. https://www.zaninalte.al/2016/02/hafiz-ymer-shemsedini-mesues-i-gjuhes-shqipe-i-islamit-dhe-i-atdhetarizmit-ne-kosove-e-me-gjere/

Krasniqi, N. (2017). *Zhvillimi i kulturës shqiptare me ndikime orientale prej shekullit XVIII deri në fillimet e Rilindjes Kombëtare* (p. 231). IA.

KultPlus. (2019, February 14). *"Golgotha Shqiptare", si u gjet libri i holokaustit ku tregohet që serbët vranë 500 000 shqiptarë*. KultPlus. https://www.kultplus.com/libri/golgotha-shqiptare-si-u-gjet-libri-i-holokaustit-ku-tregohet-qe-serbet-vrane-500-000-shqiptare/

Mahmud Hysa. (2000). *Alamiada shqiptare: Studime dhe recensione*. Logos-A.

Mehmetaj, L., & Haxhiu, J. (2022, February 15). *Pjesa 2/ Raporti i CIA-s, 1953: Edhe vetë serbët u çuditën çfarë u bënin shqiptarët komunistë kosovarëve – "komunizmi në Kosovë s'ka lidhje me ideologji, është thjesht produkt i urrejtjes së serbëve për shqiptarët."* Albanian Post. https://albanianpost.com/pjesa-2-raporti-i-cia-s-1953-edhe-vete-serbet-u-cuditen-cfare-u-benin-shqiptaret-komuniste-kosovareve-komunizmi-ne-kosove-ska-lidhje-me-ideologji-eshte-thjesht-produkt/

Mehmeti, S. (2018). Medresetë në Kosovë gjatë periudhës osmane. *Konferenca E Parë Ndërkombëtare Në Studimet Islame - Challenges of Muslims in 21st Century Society Sfidat E Myslimanëve Në Shoqërinë E Shekullit XXI*. Challenges of Muslims in 21st Century Society Sfidat e myslimanëve në shoqërinë e shekullit XXI, Tiranë.

Mehmeti, S. (2022, May 25). *Medresetë në Kosovë gjatë periudhës osmane*. Zani I Naltë. https://www.zaninalte.al/2022/05/medresete-ne-kosove-gjate-periudhes-osmane/

Morina, Q. (2010). *Glosari i Nocionave Fetare (islame, ortodokse, katolike dhe çifute)* (1st ed., p. 77). Fakulteti i Studimeve Islame.

Mustafa, A. (2020, August 26). *Avzi Mustafa: Mejtepet, shkollat e para shqipe*. Radio Kosova E Lirë.

Rexhepi, F. (2013). Roli i ulemasë shqiptare në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. *Dituria Islame*, *26*(270), 23–26. https://dituriaislame.com/wp-content/uploads/2022/01/dituria270.pdf

Rexhepi, S. (2021, January 21). *Masakrat serbe në fshatrat e Llapit dhe Gollapit në "Bozhiqin" vitit 1921*. Bota Sot. https://www.botasot.info/kultura/1481572/masakrat-serbe-ne-fshatrat-e-llapit-dhe-gollapit-ne-bozhiqin-vitit-1921/

Selmani, A. (2017, October 10). *Lufta e Gjilanit dhe masakrat ndaj popullsisë shqiptare në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945 – Nga Mr. Aliriza SELMANI*. VOAL - Voice of Albanians. https://www.voal.ch/lufta-e-gjilanit-dhe-masakrat-ndaj-popullsise-shqiptare-ne-fund-te-vitit-1944-dhe-ne-fillim-te-vitit-1945-nga-mr-aliriza-selmani/multimedia/dossier/

Shatri, M. (2016, January 29). *Përpjekjet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit për jetësimin e aspiratave jetike të kombit shqiptar*. Balli Kombëtar Në Mërgim. https://www.ballikombetar.info/perpjekjet-e-lidhjes-se-dyte-te-prizrenit-per-jetesimin-e-aspiratave-jetike-te-kombit-shqiptar/

Sheradin Berisha. (2016, May 8). *Ripushtimi i kosovës, dhe mobilizimi i shqiptarëve nga UNÇJ (1944-1945) (I)*. Pashtriku. https://pashtriku.org/sheradin-berisha-ripushtimi-i-kosoves-dhe-mobilizimi-i-shqiptareve-nga-uncj-1944-1945-i/

Shkodra, R. (2014, October 11). *Roli i imamëve dhe i ulemasë në lëvizjen nacional-demokratike shqiptare - Zeri Islam.com*.

Www.zeriislam.com. https://www.zeriislam.com/artikulli.php?id=2960

Sulejman Mehazi. (2015, July 5). *Poezia shqipe me alfabet arab dhe rrugëtimi i saj poetik - Sulejman Mehazi*. Myftinia Tetovë. https://myftiniatetove.com/poezia-shqipe-me-alfabet-arab-dhe-rrugetimi-i-saj-poetik-sulejman-mehazi/?lang=en

Sultana, R. G. (2002). *Teacher Education in the Euro-Mediterranean Region*. Peter Lang Pub Incorporated.

Suma, R. (2012). Hoxhallarët figura të shquara të kombit. *Dituria Islame*, *26*(269), 7–10. https://dituriaislame.com/wp-content/uploads/2022/01/dituria269.pdf

Telegrafi. (2017, June 24). *Kurti kujton hoxhallarët e imamët që punuan për kombin*. Telegrafi. https://telegrafi.com/kurti-kujton-hoxhallaret-e-imamet-qe-punuan-per-kombin/

Yvejsi, M. (2010). Hafiz Ymer Shemsiu (1985 - 1945). *Etika*, *V*(31), 26–27. https://www.yumpu.com/xx/document/read/6233523/etika-31

OPYRIGHT © 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet, shpërndahet ose transmetohet në çfarëdo forme ose mjeti, duke përshirë fotokopjimin, regjistrimin ose mjetet e tjera elektronike ose mekanike, pa lejen paraprake me shkrim të autorit, përveç rasteve kur citimet e shkurtra përdoren në recensime kritike ose qëllime jo-komerciale të lejueshme nga ligji.

Formati A5 14.8 cm x 21 cm

Shtëpia Botuese 'Intergraf' – Ferizaj

Botimin e këtij libri e mbështetën nga grupi biznesmenëve lokal.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

929(496.51-21)Ymeri, Hafiz
821.18(092)

Muharremi, Muhamed
Njëshi i Ferizajt "Hafiz Ymeri Shemsiu" / Muhamed Muharremi, Gentian Jetishi. - Ferizaj : Intergraf, 2025. - 251 f. ; 21 cm.

1. Jetishi, Gentian

ISBN 978-9951-835-48-0